

Habil Rama

TESTAMENTI
2
ATDHEDASHURISË

BOTUES "NACIONAL" - 2014

HALIL RAMA

TESTAMENTI
I
ATDHEDASHURISË

Refleksione, profile, kritikë letrare

SHTËPIA BOTUESE NACIONAL

Titulli i librit: **Testamenti i atdhedashurisë**. *Refleksione, profile, kritikë letrare.*

Autor: **Halil Rama**

Redaktor: **Sakip Cami**

Recensent: **Dr. Fejzulla Gjabri**

Arti Grafik: **Dritan Lleshi**

© 2014 Halil Rama. Të gjitha të drejtat të rezervuara.

Asnjë pjesë e këtij botimi, mbrojtur nga ligji nr. 9380, dt. 28.04.2005 i Shtetit Shqiptar “Për të drejtat e autorit dhe të drejta të tjera lidhur me të”, nuk mund të riprodhohet, ruhet, transmetohet a përdoret me asnjë formë a mjet grafik, elektronik apo mekanik, përfshirë por jo kufizuar fotokopje, skanime, dixhitalizim, rrjet online apo sisteme të tjerë, pa lejen me shkrim të autorit.

International Standard Book Number (ISBN): 978-9995-689-36-0


HALIL RAMA

TESTAMENTI
I
ATDHEDASHURISË

Refleksione, profile, kritikë letrare



JO VETËM TESTAMENT.....



Gazetari dhe shkrimtari i njohur Halil Rama vjen me një përmbledhje artikujsh, që bien erë Shqipërie. Shqipëri ngado ta shohësh: nga tema, nga frazeologjia, nga njerëzit – personazhe, ngaNgado ta kthesh, gjen atdhedashurinë. Në shkrimet e tij nuk ka urrejtje, nuk ka frikë, nuk ka as teprime. Sigurisht, që jo gjithçka i pëlqen, por di ta shfaqë pakënaqësinë. Pra, di të bëjë kritikën. Ndonjë vlerësim i tij arrin të japë shumë, sa një shkrimtari i jep mundësinë të bëjë një monografi, siç është shkrimi për Xhemal Berishën. *“Kudo dhe në çdo rrethanë reflektonte vlera, për të cilat ishte e etur shoqëria jonë. Qe një njeri me nivel të lartë në të gjitha ditjet, një filozof dhe psikolog, mësues dhe edukator shembullor, që, gjithkujt i duhet në ditë të vështira.*

Xhemal Berisha, njëri nga veteranët më të vjetër të kulturës dhe arsimit kombëtar u nda nga jeta me 15 nëntor 2012, në moshën 84-vjeçare”.

Në këtë koncizitet marrim shumë, shumë njohuri për këtë

njeri të përkushtuar. Dhe, si për të vërtetuar vazhdimin e këtij shkrimi, thotë: “Tregimi i plotë për Xhemal Berishën nuk ezaurohet, ndoshta, as dhe me një monografi të tërë, ndërsa në këtë libër po bëjmë vetëm një paraqitje të shkurtër, për të krijuar një përshtypje rreth tij tek të gjithë ata që nuk e kanë njohur nga afër. Megjithëse jetim...”.

Kështu janë disa shkrime në këtë vëllim. Në këto vite kthese e ridimensionimi si në sferën e kritikës ashtu në atë të krijimtarisë letrare, kanë spikatur emra që me veprën e tyre kanë sjellë risi në fushën e artit të shkruar. Autori vjen nga gazetaria, por jo thjeshtë gazetar.

Pasuria letrare shqipe ka disa libra të tij, ndër të cilët spikasin monografia për Gjeneral Parllakun, që e cilëson si “Një legjendë në kufirin e dy kohëve”, me portretin e tij në disa dimensione. Gjithashtu përmendim edhe librin publicistikopolitik “Fundi i rrugës vetme”, monografi për Dine Hoxhën, Muharrem Xhedikun etj. Pra, jo thjeshtë gazetar, publicist. Megjithatë, gazetaria sundon në krijimtarinë e tij.

Me këtë vëllim, mendoj se prozës shqipe tashmë i shtohet edhe një vëllim me autorin Halil Rama, i cili vazhdon me dinjitet në lëmin e saj.

Tematika e këtij vëllimi me tregime është e mbrujtur me lëndë jetësore nga e cila buron një letërsi e mirëflitë, e ndryshme nga krijimtaria eksperimentale, herë-herë e tejmbushur me frazeologji boshe. Kur lexon tregimet e këtij autori të mbërthen ideja e ndodhjes krejt rastësisht përballë një realiteti të njohur, por të paraqitur ndryshe, që të bën të ndjehesh

mirë. Ndjehesh mirë kur bën një historik të shkurtër shkolle, që gjithsesi shumë vetë e kanë përjetuar fillimin e arsimit shqip në vendin tonë. Kështu, në *“Momente kthese dhe reflektimi për zhvillimin e arsimit në rajonin e Dibrës”*, (*Nga historiku i shkollës shqipe të Muhurrit*), kemi një paraqitje reale që më të rinjve, atyre që nuk e kanë jetuar atë kohë, u duket groteske.

Halil Rama nuk jep histori, por ngjarje. Bujanin historik e përshkruan ndjeshëm, me atë që i dha historisë. Në një farë mënyre, ai jep mesazh: Ja, kush asht Bujani, të tjerat le t'i thotë historiani, veçse dijeni se këtu u vendos ‘vetëvendosja’. Jep heronj, të njohur e më pak të njohur, siç është Heroi Kombëtar Azem Hajdari, me titull “Pesha e dhimbjes”. Nëpërmes së mëvonshmes gjen pikën e hershme: *‘Ai tashmë është i veshur me pavdekësi...’*

Në 12 shtator 1998, vrasësit u shfaqën në formën e djallit dhe e goditën pa mëshirë....”

Kemi dhe një tregim të bukur për një “hero” pak të njohur, që në gusht të 1949-ës, mori komandën në mbrojtje të kufijve. Më qartë: është historia e centralistit që urdhëroi hapjen e zjarrit ndaj monarkofashistëve grekë më 2 gusht 1949. E ka një lidhje me të mëvonshmen, që si grenzat vijnë e ngacmojnë në ‘plagë’, se ai kufi i marrë padrejtësisht, ku shqiptarët kufizohen me shqiptarë, mbeti plagë. Pikërisht përsëritja e disahershme më vonë, pas 2 gushtit 1949, e çon autorin në përkujtim të këtij centralisti ‘hero’.

Sakrificat janë edhe në ditët e sotme, të cilat i jep nëpër disa tregime, siç është “Rekuem për ish-gardistin shembullor Arben

Zhuzhi”, e që duken se subjektet bashkëjetojnë natyrshëm.

Nëpër vëllim nuk mungojë vlerësime të autorve të tjerë, se fundja, autori ka marrë pjesë në promovimet e tyre, ka dëgjuar edhe të tjerët për to, njih shumë krijues, se detyra e ka mësuar. Të tilla janë: Monografia historiko-ushtarake “Ushtria Çlirimtare Kombëtare” e Gjeneral Gëzim Ostrenit - Një vepër unikale me vlera mbarëkombëtare etj.

Autori u mëshon në këto tregime (më së shumti publicistike), problemeve shoqërore. Atij i dhimbsen së pari njerëzit, ata që kërkojnë ndihmë. Prandaj pasqyron në dy tregime Ambrën që do të jetojë), thirrjen e saj për ndihmë.

I dhimbsen edhe pyjet që shkatërrohen, prandaj pëlqen e shkruan për librin e Selman Mëziut “Revolucioni i gjelbërt”; i dhimbsen njerëzit e dijes e të punës, prandaj shkruan për Xhemal e Naim Berishën, apo për Shefki Karadakun, si shkrimtar i harruar.

Së fundi analizon alegoritë e sjella nga Sakip Cami. Si për të vazhduar e inkurajuar, autori shkruan: “Aty gjejmë Mesele dibrane, Histori, Rite, zakone dhe traditë; Tregime brenda dhomës dibrane... gjejmë historinë e Dibrës nëpërmjet këngëve të vjetra popullore, por dhe nëpërmjet dokumentave. I kompozuar kështu “Dibra nëpërmjet këngëve dhe tregimeve të popullit”, është një sinetëzë e mençurisë, urtësisë dhe filozofisë dibrane”.


Përmbledhja me tregime publicistike është një shtesë në bibliotekat tona, që vjen me aromën e atdheut, duke menduar se nuk është vëllimi fundit, por që presim vëllime të tjera.

Dr. Fejzulla Gjabri



**NË BUJAN, KU U PROJEKTUA
“VETËVENDOSJA”**





Bujani i Krasniqes, me shumë bëma në historinë tonë kombëtare, hijerëndë dhe kreshnik në prehrin e Malësisë së Gjakovës, mbi të gjitha njihet për kuvendin e tij historik, nga ku më 31 Dhjetor 1943 dhe 1 e 2 Janar 1944 u ideua e drejta e vetëvendosjes së kosovarëve për të ardhmen e Kosovës.

Pikërisht në 70 vjetorin e Konferencës së Bujanit, pallati i kulturës “Dardania” në qytetin e Bajram Currit mbledhi në një akademi solemne pasardhësit e atyre burrave trima e të mençur, që 70 vjet më parë, shpallën shprehjen e vullnetit të shqiptarëve për bashkim kombëtar, dhe me rezolutë, edhe njohjen Kosovës të së drejtës për vetëvendosje deri në shkëputje nga ish-Jugosllavia. Akademikë nga Prishtina e Tirana, deputetë të Kuvendeve të Shqipërisë e Kosovës, pinjollë të protagonistëve të atij kuvendi legjendar ndjejnë një kënaqësi të veçantë, një krenari legjitime, për Bujanin e Malësisë së Gjakovës, për Bujanin e Krasniqes, për Bujanin, në hullitë jetësore të të cilit ecën koha e cila nuk jeton dot pa historinë e saj.

Dhe për këtë, sikur duan të flasin të gjithë, edhe kullat, edhe kalatë, edhe këngët e vallet epike, të interpretuara me mjeshtri të rrallë nga djem e vajza shtatlarta të truallit të Dardanisë.

Burim frymëzimi për brezat që do të vijnë, përshëndetja e Heroit të Popullit shqiptar, Nderit të Kombit, 95-vjeçarit Rrahman Parllaku, që me përkushtim të rrallë drejton Organizatën e Bashkuar të Veteranëve të LANÇ të popullit shqiptar.

Si një testament atdhedashurie, konkluzionet e dëshmitarit okular të ngjarjeve madhore historike të këtyre shtatë dekadave të fundit për “sakrifica të mëdha të tre brezave, për të arritur këtu ku jemi sot: Kosova e lirë – shtet sovran e demokratik, populli shqiptar kudo që jeton në trojet e veta etnike i ka fituar të drejtat nacionale e po shkon drejt konsolidimit të tyre”.

Në moshën 95-vjeçare, kreu i OBVL-së, Parllaku dhe brezi i veteranëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, ndjehen krenarë e të privilegjuar që arritën ta shohim kombin tonë të lirë e të ringjallur në Ballkan; faktor paqejë e stabiliteti në rajon.

Parë në të njejtën optikë, kreu i komunës, Bujar Hasanpaj, vlerëson Bujanin si një prej fshatrave më me zë të fisit të Krasniqes e më gjerë, të vendosur afër qytezave ilire të Rosujes, të cilat sipas gërmimeve arkeologjike dëshmojnë për vazhdimësi jete tremijë vjeçare, me një besim e kulturë të hershme, që dëshmohet me xhaminë e ndërtuar këtu që në vitin 1786, e cila kishte edhe mejtepin, shkollën e ulët fetare ku mësohej shkrim e matematikë, e më vonë hapjen e të parës shkolle laike në gjuhën shqipe në Malësinë e Gjakovës, në shtëpinë e Ali Jakupit në Dojan me 17 tetor 1922.

KUVENDI I IDEALEVE TONA KOMBËTARE

Krahas shumë ngjarjeve kulmore historike të kësaj krahine, kryekomunari Hasanpapaj, evidenton kontributin e veçantë të Bujanit dhe Malesisë së Gjakovës për vënien në jetë të vendimeve të Konferencës historike që u mbajt më 31 Dhjetor 1943 dhe më 1 e 2 Janar 1944 në kullën e patriotit Sali Mani.

Po ashtu dhe Brigadën e 25 Sulmuese të drejtuar nga Veli Nimani me 900 forca, (700 nga Tropoja e 200 nga Hasi) dhe katër batalione që drejtoheshin nga Idriz Rexhep Mulosmani, Ali Brahim Mustafaj, Mehmet Bajram Mulosmani dhe Ismail Poga, që së bashku me brigadat kosovare çliruan teritoret nga Kosova deri në Sanxhak të Bosnjes.

Në këtë akademi solemne spikati veçanërisht mendimi teorik e shkencor i Prof. Dr. Jusuf Bajraktarit, duke e konsideruar Konferencën e Bujanit si kuvendin e idealeve tona kombëtare. Për faktin se Malësia e Gjakovës ka qenë pjesë e pandashme e Gjakovës si qendër urbane, prof. Bajraktari argumenton se ato historikisht janë ndihmuar e kanë vepruar së bashku në përpjekjet dhe luftërat e tyre për liri e pavarësi.

“Qyteti i Gjakovës s’bënte asgjë pa Malësinë e tij, sikurse edhe ajo do t’i shërbejë si mbështetja kryesore sa herë kërcënohej Gjakova dhe mbarë Kosova nga zullumet e të huajve”. Kështu ndodhi edhe në Luftën e Dytë Botërore, kështu do të ndodhë edhe në vitet e përpjekjeve të mëdha siç është rasti me Luftën Çlirimtare të Kosovës në vitet 1998-1999.

Nisur nga këto premisa, akademiku nga Prishtina argumenton

se Konferenca e Bujanit zë një vend të veçantë në historinë e re shqiptare, si një afirmim i fuqishëm i identitetit politik të Kosovës dhe i vullnetit të popullit të saj për bashkim kombëtar.

VIZITË MBRESËLËNËSE NË KULLËN E PATRIOTIT SALI MANI

Më mbresëlënësja e asaj dite të paharruar do të ishte vizita në kullën e patriotit Sali Mani, në Bujan të Krasniqes, ku 70 vjet më parë (me 31 Dhjetor 1943 e deri më 2 janar 1944) zhvilloi punimet me sukses të plotë Konferenca Themeluese e Këshillit Nacionalçlirimtar për Kosovën e Rrafshin e Dukagjinit.

Në podin karakteristik të kësaj kulle, në analet e historisë sonë të lavdishme, foto dhe fakte nga jeta e 49 delegatëve përfaqësues të viseve të Kosovës, prej të cilëve 43 ishin shqiptarë dhe 6 serbë e malazezë.

Pikërisht në ato tre ditë e netë të zjarrta të atij dimri të furishëm, në këtë kullë u bënë diskutime e debate të vlefshme si dhe u miratuan dokumente të rëndësishme për punën e mëtejshme si: Proklamata drejtuar popullit të Kosovës, Rezoluta, detyrat prej 18 pikash për KNÇ-të si dhe telegramet përshëndetëse.

Pa dyshim se pjesa më e rëndësishme e Rezolutës së Konferencës është ajo që bën fjalë për të drejtën e patjetërsueshme të popullit të Kosovës për vetëvendosje. Aty pa ekuivoke thuhej: “Kosova e Rrafshi i Dukagjinit asht një krahinë e banueme me shumicë nga populli shqiptar, i cili si gjithmonë, ashtu edhe



sot, dëshiron me u bashkue me Shqipni...” Në konferencë u shtruan për zgjidhje dy çështje fundamentale: e para formimi i Këshillit Nacionalçlirimtar të Kosovës, i cili do të identifikohet me individualitetin e subjektivitetit politik-shtetëror të Kosovës dhe e dyta, do të ishte zgjidhja e çështjes kombëtare për të ardhmen e shqiptarëve.

PËRMENDORE E HISTORISË SONË KOMBËTARE

70 vjet më pas, Bujani shpaloset me tërë madhështinë e tij, i shtrenjtë, i bukur, përmendore e historisë sonë kombëtare!

Bujani është i privilegjuar nga vetë natyra, me një pozitë gjeografike mjaft të favorshme, duke filluar nga brigjet e

lumit Valbona, vijon gjatë përroit të Gradazhnicës, që e ndan me fshatin Gri, vazhdon drejt Lozhës, në Bogishë, Depsyden, rreth Morajës, kalon në Cukal, sillet andej nga Liqeni i Ponarëve e në vijim drejt Qafës së Lugut të Thive, Lugut të Kaut, dirgjet nga kodra e Gojfilave në Bishevë, ku fillojnë kufijtë më Margegajt...”. Kjo zonë ka njohur e po njeh një zhvillim intensiv në tërë infrastrukturën e saj socialkulturore.

Pikërisht, edhe për këtë fakt bujanasit ndjehen më të plotësuar e më krenarë se kurrë. Ndaj, dhe gjeneral Parllaku, si një enciklopedi e gjallë rrëfen me detaje kontaktet e shumta me patriotë të kësaj zone në vitet e zjarra të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, dhe më pas si kuadër i lartë i ushtrisë, e shpreh fare qartë këtë në bashkëbisedimin e ngrohtë e miqësor me deputeten e Kosovës, zonjën e nderuar Flora Brovina, e njohur si një aktiviste e hershme në fushën e të drejtave të njeriut dhe që vazhdimisht ka luftuar në emër të popullit të saj.

Brovina, mjeke e shquar, poete e njohur, patriote e flaktë që përballoi me stoicizëm burgjet dhe dhunën barbare serbe, falenderon nga zemra zotin Parllaku për gjithshka ka bërë ai për Kosovën e për popullin e vet.

Udhëtimi me të, nga Tirana në Gjakovë dhe më pas në Bajram Curri, Bujan e Has do të mbetet i paharruar në kujtesën tonë. Bashkëudhëtarët tanë, nipërit e nderuar të gjeneralit, “Hero i Popullit”, Mazllum e Hazbi Parllaku, ndjehen të privilegjuar tek i shërbejnë xhaxhait, nga i cili kanë përfituar krenari legjitime, por edhe kanë vuajtur kalvarin e internim-dëbimeve gjatë viteve të burgjeve të diktaturës. Nga xhaxhai i njohur si



udhëheqës i talentuar i LANÇ dhe si legjenda e qëndresës në burgjet e Burrelit e Tiranës, por edhe nga të parët e fisit të tyre me emër e zë në Kukës e në gjithë Shqipërinë, kanë trashëguar dhe ruajnë me fanatizëm testamentin e atdhedashurisë.


Më 24 janar 2014, nga tribuna e sesionit jubilar që u mbajt në sallën e Akademisë së Shkencave në Tiranë, kryetari i Kuvendit të Shqipërisë, Ilir Meta do të vlerësonte se Rezoluta e Konferencës së Bujanit ishte platformë dhe fitore e madhe e LANÇ, e cila nuk mund të tjetërsohet, as të shlyhet me kurrfarë mjjetesh institucionale, as jashtë institucionale, edhe për faktin se është arritur në Luftën e Dytë Botërore. Kreu i legjislavit shqiptar vlerëson ata gra e burra, komunistë e nacionalistë, atdhetarë e demokratë, përfaqësues të forcave të armatosura dhe të rinj antifashistë, që shënuan një gur themeli në të nesërmen dhe vizionin për të ardhmen e çështjes shqiptare.

Edhe në Akademinë solemne në qytetin e Bajram Currit, autoritetet vendore të qarkut të Kukësit e komunës së Bujanit, por dhe historianë e akademikë nga Kosova e Tirana i shprehën mirënjohjen e thellë kryeparlamentarit shqiptar, Ilir Meta për nisma të tilla për të kremtuar përvjetorët jubilarë të ngjarjeve historike të kombit tonë.



**NJË LEGJENDË NË KUFIRIN
E DY KOHËVE**





Një ndër figurat që sfidoi diktaturën, Gjeneral Lejtnant Rrahman Parllaku vlerësohet me dekoratën e lartë “Nderi i Kombit” nga Presidenti i Republikës, Bujar Nishani. Në nder të tij u organizua edhe një ceremoni festive në ditelindjen e 95-të. Në ceremoninë e dekorimit që u zhvillua në Presidencë ishte e pranishme edhe Ministria e Mbrojtjes Mimi Kodheli, veteranë të LANÇ si dhe familjarë të z.Parllaku. Në fjalën e rastit, Presidenti Nishani vlerësoi Gjeneral Parllakun si i një figurë shumëdimensionale që i mbijetoi Luftës së Dytë Botërore dhe terrorit komunist.

Në 95-vjetorin e ditëlindjes u mbajt një mbledhje solemne në nderim të Heroit të Popullit dhe Nderit të Kombit Rrahman Parllaku. Merrnin pjesë Ministria e Arsimit dhe Sporteve, Lindita Nikolla, Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA të RSH, Gjen.Maj. Jeronim Baze, deputetë të Kuvendit të Shqipërisë etj. Ndodhej edhe një delegacion i Shoqatës së Veteranëve të LANÇ të Kosovës i kryesuar nga Akademik Pajazit Nushi, nënkryetar i kësaj shoqate.


Për jetën dhe veprën e tij folën Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA të RSH, Gjeneral Major Jeronim Baze si dhe bashkëluftëtarët e Heroit, Skënder Malindi e Edip Ohri,



përkatësisht nënkryetari e sekretari i Përgjithshëm i OBVL, Prof. Dr. Shefqet Hoxha, etj.

Po këtë ditë u promovua edhe libri “Një legjendë në kufirin e dy kohëve” i bashkëautorëve Halil Rama dhe Sakip Cami. Për vlerat e këtij libri foli Dr.Fejzulla Gjabri.

Një dhuratë e çmuar për njeriun që bëri epokë ishte edhe letra që i dërgoi Kryetari i Partisë Demokratike, z.Lulzim Basha, si dhe një tufë me lule nga kryebashkiaku i kryeqytetit. Ndërkohë qindra pjesëmarrës në këtë takim festiv që u mbajt në sallën e Muzeut Historik Kombëtar ndoqën me vemendje filmin dokumentar të RTSH “Një legjendë në kufirin e dy kohëve”, realizuar sipas skenarit të bashkëautorëve Halil Rama e



Sakip Cami nga regjizori Xhelil Aliu.

Gjeneral Rahman Parllaku është i vetmi “Hero i Popullit” i gjallë, që i mbijetoi Luftës së II-të Botërore dhe terrorit komunist. Dekorata “Nderi i Kombit” vjen pikërisht kur u mbushën 95 vjet nga dita kur në Novosej të Kukësit do të lindte një fëmijë që do të bënte dallim nga të tjerët për zgjuarsinë dhe guximin e tij. Ai ishte Rahman Latif Parllaku, i cili lindi, u rrit dhe mbeti patriot.

Lufta Antifashiste, mbrojtja e vendit, “lufta e brrylave”, qëndrimi në qeli, Lufta e Kosovës më 1999, krijimtaria

publicistike e aktiviteti intensiv në mbështetje të proceseve demokratike e të shtetit ligjor, e forcuan karakterin e tij.

Nëntëdhjetë e pesë vjet është një kuotë shumë e lartë. Gjeneral Rrahman Parllaku ka meritën se e ka rritur këtë kuotë të lartë, megjithëse i është dashur të përballojë shumë furtuna gjatë jetës dhe çështë më kryesorja e ka arritur jo i drobitur, por në formë të shkëlqyer fizike dhe mendore, një formë që do ta kishin zili edhe të rinjtë.

Edhe shumë vite të tjera, kështu siç je, vital dhe aktiv!

Etapat e jetës së Gjeneral Parllakut lidhen me zhvillime të rëndësishme të Luftës Nacionalçlirimtare, të Ushtrisë dhe të vendit. Vetë fakti që z.Parllaku e filloi luftën si komandant i njësiteve guerrile në Vlorë dhe e përfundoi si komandant divizioni në Kosovë, është shumë domethënës. Ai kontribuoi në Luftën Antifashiste dhe pas çlirimit. Në saj të punës dhe përpjekjeve arriti të bëhet një nga drejtuesit e lartë të ushtrisë sonë.

Në Ministrinë e Mbrojtjes dhe në Shtabin e Përgjithshëm të Ushtrisë, Parllaku u ndesh me skenarët e projugosllavëve për bashkimin e shtetit dhe të ushtrisë shqiptare me Jugosllavinë dhe luftoi për shkatërrimin e tyre. Kjo do t'i sillte një kosto që do të reflektohej më vonë në karrierën dhe në jetën e tij.

Parllaku do të ndeshet edhe me ushtarakët dhe udhëheqësit sovjetikë që pas mbledhjes së 81 partive komuniste dhe punëtorë të Europës dhe daljes së Shqipërisë nga Traktati i Varshavës u përpoqën t'ja rrëmbenin Shqipërisë nëndetëset nga Baza e Pashalimanit.

Më së fundi ky gjeneral i famshëm i Ushtrisë

Nacionalçlirimtare dhe i Ushtrisë Shqiptare do të shërbente si kokë turku në luftën për pushtet të Enver Hoxhës, për eliminimin e kundërshtarëve të tij politikë në ushtri dhe në qeveri e në parti. Atë e dënojnë me 25 vjet burg si pjesë e të ashtuquajturit “grupi puçist në ushtri”, së bashku me Beqir Ballukun, Petrit Dumen dhe Hito Çakon...

Provoi trajtimin e keq në burgun e Burrelit, si shumë ushtarakë të asaj kohe, nuk u ligështua dhe pasi doli nga burgu, me fillimin e proceseve demokratike u përfshi për të dhënë ndihmesën e tij nëpërmjet organizatës së veteranëve në interes të atdheut.

Pas daljes nga burgu, pas 17 vjetësh, në vitin 1991, Parlaku vihet në krye të Organizatës së Bashkuar të Veteranëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare.

Në vitin 1999 Parllakun do ta gjejmë në Kosovë, ndonëse në moshë të thyer, për të dhënë kontributin e tij në luftën për Kosovën e lirë dhe demokratike...

Duke nderuar Gjeneral Parllakun ne nderojmë të gjithë brezin që bëri luftën antifashiste dhe dërgojmë një mesazh të rëndësishëm dhe të qartë, mesazhin se shteti demokratik vlerëson luftën e drejtë të rinisë dhe të popullit shqiptar kundër pushtuesve nazifashistë gjatë Luftës së II Botërore, luftë që shprehte një kontribut shumë të madh në raport me popullsinë në Aleancën Antifashiste, që e renditi vendin tonë në krahun e fitimtarëve.

Sot ne kemi përpara një hero të gjallë, një komandant divizioni të kësaj lufte, komandantin e Divizionit të V Sulmues



që luftoi edhe për çlirimin e Kosovës dhe të viseve shqiptare në Ish Jugosllavi.

Sot kemi përpara një gjeneral që u ndesh me gjeneralët e Traktatit të Varshavës për mbrojtjen e Shqipërisë dhe të Bazës Detare të Pashalimanit.

Sot kemi përpara një gjeneral, që ndonëse në moshë të thyer shkoi në Kosovë në mbështetje të UÇK dhe të veprimeve të NATO-s në Kosovë.

Sot ne kemi përpara njeriun kurajoz që në momente të rëndësishme ka mbrojtur me mënçuri e trimëri çështjen tonë kombëtare. Ai me forcë e ngre dhe e argumenton luftën e drejtë të UÇK-së dhe çështjen e të drejtave të shqiptarëve në Kosovë dhe në Maqedoni në bisedë me ministrin e jashtëm anglez Lordin Robertson...

Ja pra ky është Gjen. Rrahman Parllaku, kryetari ynë i



OBVL, Organizatës së Bashkuar e Veteranëve të Luftës Anti-fashiste të Popullit Shqiptar.

Rahmani është 95 vjeç, por kujtimet i ka si 95 ditë më parë. Ai i gëzohet gjithashtu familjes solide që gëzon respektin e të gjithëve. Në këtë përvjetor të 95-të të gjeneralit nuk ka si të mos kujtojmë bashkëshorten e tij Fitretin, këtë grua fisnike që rriti me dashuri dhe përkushtim të jashtëzakonshëm tre vajzat e saj, në kushtet kur Rahmani vuante në burgun famëkeq të Burrelit...

Rahmani nuk do të gëzonte këtë shëndet që gëzon sot në moshën 95 vjeçare, pa kujdesin e tre vajzave të tij të

mrekullueshme, Lirikës, Tatjanës dhe Shpresës që e mbajtën ashtu siç thotë populli “në pëllëmbë të dorës” babain e tyre, që arritën ta shohin dhe ta kenë midis tyre pas 17 vjetësh burgim. Djalë përmbi djalë ju bë Rrahmanit, nipi i tij, djali i vëllait, Hazbiu, që u kujdes për të më shumë se për babain e tij. Jo më pak janë kujdesur edhe Mazllumi dhe Tekiu dy nipërit e tjerë që e kanë Rrahmanin përmendore të gjallë të traditës dhe të virtytit të tyre familjar të trashëguar ndër shekuj, amanetin e të atit, Selimit. (Selimin dhe Rrahmanin do t’i gjeje kudo bashkë në punë dhe në aksionet guerile të Vlorës). Gjeneral Rrahmani ja doli mbi të gjitha furtunat e jetës, doli fitimtar nga lufta antifashiste, doli gjallë nga burgu komunist, doli fitimtar në luftën për pavarësinë e Kosovës dhe sot është gjenerali më i vjetër, por me mendje të re, që mbështeti anëtarësimin e Shqipërisë dhe të ushtrisë shqiptare në NATO.

Këshilli i Bashkisë Shijak dhe ai i Komunës Kurvelesh e kanë nderuar gjeneralin me titullin “Qytetar Nderi i Shijakut” dhe “Nderi i Komunës” Kurvelesh”. Sigurisht për një njeri që është memoria historike e kombit, lavdia e tij, nderi dhe krenaria e kombit, mund të shkruhet shumë, mund të bëhen filma e dokumentarë pa mbarim.

Një surprizë e këndshme për gjeneral Parllakun dhe për gjithë ata që e kanë njohur dhe nderojnë atë është edhe libri “Një legjendë në kufirin e dy kohëve”, i bashkëautorëve H.Rama e S.Cami që u botua pikërisht në 95-vjetorin e ditëlindjes së tij.

Në kohën tonë moderne të globalizmit nuk bëhet fjalë për legjenda. Megjithatë, ato egzistojnë, pavarësisht heshtjes dhe

indiferencës së opinionit publik. Një protagonist me një jetë të jashtëzakonshme, sjell para lexuesit edhe ky libër.

Shkrimtari i mirënjohur Teodor Laço do të shkruante në parathënie e tij se: “Nuk është thjesht një biografi tërheqëse, që për një shkrimtar do të qe një grishje për fantazinë. Është më shumë se kaq. Është një dëshmi për kohën që kemi lënë pas, për një kohë tepër të gjatë, si dhe jeta e heroit të librit, që na vjen midis nesh me bar-rën e 95 viteve të tij, që si rrallëkush, i mbart me freskinë fizike, me mprehtësinë e gjykimit, me fjalën që nuk bie përdhe, me gjallërinë dhe energjinë e një burri shteti në gjysmën e moshës që ka ai. Qofsh edhe për shumë vite të tjera siç të njohim e të shohim sot, miku ynë Rrahman Parllaku!

Nga jeta e një Matuzalemi si ti, na ulet këmbëkryq historia. Nga lufta dhe përkushtimi yt atdhetar na vjen një model për tu ndjekur.”

U takofshim në jubileun e 100 vjetorit të këtij njeriu që bëri epokë!



**GJENERAL GËZIM OSTRENI,
HEROI I DY LUFTËRAVE NË
KOSOVË DHE MAQEDONI,
LIBËR PËR LUFTËN DHE
PAQEN NË SHKUP**



MONOGRAFIA HISTORIKO-USHTARAKE “USHTRIA ÇLIRIMTARE KOMBËTARE” E GJENERAL GËZIM OSTRENIT, NJË VEPËR UNIKALE ME VLERA MBARËKOMBËTARE

Pak fjalë për autorin

Kush është Gjen.Gëzim Ostreni?

Gjeneral major Gëzim Ostreni është lindur në qytetin e Dibrës, më 1 nëntor 1942. Pas mbarimit të shkollës normale, mbaron edhe shkollën e oficerëve të rezervës si dhe disa kurse në Akademinë Ushtarake. Diplomohet në Fakultetin Filozofi dhe Sociologji në Prishtinë. Në lëmin ushtarak ka kryer detyrën e komandantit të mbrojtjes territoriale në Dibër. Ka marrë pjesë në luftën e UÇK, në fillim në detyrën e shefit të shtabit të Zonës së III, më pas komandant i Zonës së III Operative të Trupave të Mbrojtjes së Kosovës me gradën Gjeneral Brigade. Në vitin 2000 gradohet Gjeneral Major dhe ngrihet në detyrën e Shefit të Shtabit të TMK. Në vitin 2001 me fillimin e konfliktit në Maqedoni merr detyrën e Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare, ushtri që u

krijua nga shqiptarët e Maqedonisë në mbrojtje të të drejtave të tyre legjitime. Së bashku me Ali Ahmetin, komandant dhe drejtues politik i kësaj ushtrie e detyruan faktorin ndërkombëtar dhe qeverinë, Parlamentin dhe Presidentin e Maqedonisë të nënshkruanin Marrëveshjen e Ohrit për të drejtat e shqiptarëve të Maqedonisë, marrëveshje që tashmë është pasqyruar edhe në Kushtetutën e Maqedonisë. Nga 3 tetori i vitit 2002 është deputet i Kuvendit të Maqedonisë. Në vitin 2004 ka qenë kandidat për President i shtetit të Maqedonisë dhe nga viti 2002 deri në vitin 2006, nënkryetar i Kuvendit të Maqedonisë. Në nëntor të vitit 2007 deponon në Gjykatën e Hagës për 19 ditë dhe argumenton me fakte dhe dokumente se lufta e Ushtrisë Çlirimtare të shqiptarëve të Maqedonisë ka qenë një luftë e drejtë, për të drejtat themelore të shqiptarëve dhe që s'ka të bëjë aspak me veprimet terroriste. Mban gradën Doktor i shkencave dhe ka botuar një sërë librash dhe studimesh për historinë dhe luftën e popullit shqiptar për liri, pavarësi dhe të drejtat e tij veçanërisht për shqiptarët jashtë trungut amë, duke dhënë një përgjigje të merituar shkencore profesorëve serbë dhe maqedonas që duan të hedhin baltë mbi gjenezën dhe traditën historike të shqiptarëve.

Studim shkencor që përmbledh dokumente shtetërore dhe arkivore. Libri “Ushtria Çlirimtare Kombëtare” është një studim voluminoz prej 1150 faqesh, i shoqëruar me një CD dhe me një grup hartash luftarake. Ky libër është një kontribut i jashtëzakonshëm shkencor, ushtarak, dhe historik për historinë

e shqiptarëve kudo që janë.

Ndonëse është i shoqëruar që në titull me okelion “Shkaqet, lufta dhe paqja në Maqedoni në vitin 2001, ky libër është një studim shkencor që përmbledh dokumente shtetërore dhe arkivore që nga Lidhja Shqiptare e Prizrenit dhe Kongresi i Berlinit, që nga viti 1878 e deri në ditët e sotme.

Libri si rrallë ndonjëherë, është shkruar nga një protagonist kryesor, nga shefi i shtabit të kësaj ushtrie dhe ka për recensent ish Komandantin e Luftës së shqiptarëve në Maqedoni, sot kryetar i Partisë për Drejtësi dhe Integrim BDI, Ali Ahmeti, i cili e quan atë një dëshmi eklantante për një luftë të drejtë të UCK-së.

“E kaluara historike e shqiptarëve në Maqedoni, që nga viti 1912, thekson Ali Ahmeti, është e lidhur ngushtë me zhvillimet në Gadishullin e Ballkanit, me luftërat që zhvillojnë fqinjët e tyre për të gllabëruar trojet shqiptare në emër të çlirimit nga Perandoria Osmane dhe me përpjekjet e tyre gjatë luftërave botërore për të ruajtur qenien e tyre në Maqedoni e në trojet e tjera në Ballkan. Shqiptarët të ndodhur nën okupimin serbo-jugosllav u gjetën nën presionin e forcës së genocidit të organizuar nga shteti deri në fund të shekullit XX, i cili tentonte t’i zhdukë dhe t’i shpërngulte nga trojet e veta.

Durimi i shqiptarëve mbaroi sepse edhe në fillim të shekullit të XXI, fill pas mbarimit të Luftës së Kosovës në vitin 1999, ku u angazhua plotësisht NATO dhe SHBA, politikanët dritëshkurtër dhe qeveritarët maqedonas, jo vetëm nuk po ua



jepnin të drejtat shqiptarëve të Maqedonisë, por po i shtypnin edhe më shumë ata duke ua hequr edhe të drejtat e fituara. Kjo çoi në luftën e UÇK së shqiptarëve të Maqedonisë. Duke analizuar veprën e Gjen.Gëzim Ostrenit, vepër që pasqyron pothuajse plotësisht këtë luftë, Ali Ahmeti, drejtues politik dhe komandant, thekson se në vorbullën e ngjarjeve të provokuara nga reagimi i shqiptarëve me kryengritje ndaj shkeljes së lirive dhe të drejtave të tyre, kryengritje kjo, që shpejt u transformua në Ushtri Çlirimtare Kombëtare të popullit shqiptar në Maqedoni, u bë shkak, i cili kishte për pasojë angazhimin e KS të OKB-së, SHBA, BE, OSCE dhe NATO-s. Në këtë drejtim,

me tërë kapacitetin e tyre u angazhuan edhe organet diplomatike të akredituara në Maqedoni, për të gjetur zgjidhje për përfundimin e luftës që kishte shpërthyer. Prof. Dr. Mahmud Hysa në recensën e tij, ndër të tjera shkruan: “Nëse del nga kujtesa historike dhe e përfshin “pluhuri i harresës”, nëse pseudostudies do ta injorojnë ose minimizojnë këtë luftë grandioze, mjafton të lexohet vepra e Gjen. Gëzim Ostrenin, të cilin e shquan mbi të gjitha objektiviteti shkencor, të gjitha të shkrihen si fluska sapuni si të pavërteta e paradoksale. Dr. Gëzim Ostreni me këtë vepër e ka ngritur në pedestal më të lartë luftën dhe heronjtë e saj, të gjallë dhe të vdekur. Është kjo një vepër shumëdimensionale dhe e rrallë për kah arrijtjet shkencore. Prof.Dr. Gëzim Mustafaj, Dekan i Fakultetit të Sigurisë dhe Mbrojtjes në Akademinë e Mbrojtjes, Tiranë e ka analizuar këtë vepër në aspektin ushtarak, në aspektin e drejtimit dhe të komandimit të trupave duke vënë theksin në mos politizimin e institucioneve të sigurisë së një shteti, të mos uzurpimit të tyre, gjë që çon në moskryerjen e funksioneve të këtyre institucioneve dhe të mospasjes siguri në një shtet demokratik.

INSTITUCIONET E SIGURISË SË SHTETIT JANË THEMELI I INTEGRITETIT DHE IDENTITETIT TË VETË SHTETIT

“Libri i Z. Gëzim Ostreni, nënvizon Prof. Mustafaj, është një mesazh për të gjithë, duke theksuar se institucionet e sigurisë së shtetit janë të dimensioneve të ndryshme, por në të

njëjtën kohë ato janë themeli i integritetit dhe identitetit të vetë shtetit, kjo sepse sa herë ka pasur uzurpime të institucioneve të sigurisë së shtetit, duke i shndërruar në vegla të ushtrimit të forcës, asnjëherë shteti nuk u ka shërbyer shtetasve e qytetarëve të tij, përkundrazi natyra e shtetit ka humbur dimensionin e tij, duke u shndërruar me ose pa dashje në vegël të urryer për vetë popullin.

Dr. Shpëtim Cami, ekspert dhe pedagog i menaxhimit të krizave, thekson se ky libër është një mësim i mirë për liderшипin ballkanik që ka prodhuar dhe prodhon çdo ditë konflikte që prej më shumë se 100 vjetësh.

“Libri është një kontribut shkencor në fushën e studimeve për menaxhimin e krizave. Ai është një monument që zvogëlon rrezikun e deformimit apo të mohimit të historisë. Ky libër është një kontribut me vlerë në identitetin kombëtar shqiptar, që do t’u shërbejë edhe popujve të tjerë që të dinë të jetojnë në një botë shumë etnike në paqe dhe në shërbim të njëri tjetrit”.

Befasohesh kur lexon këtë studim voluminoz, këtë monografi historike, ushtarake, politike, shoqërore, me vlera për sot dhe për nesër, për brezat që do të vijnë. Propaganda komuniste këtej dhe matanë kufirit ka bërë punën e saj për ta bërë bashkim vëllazërimin në kurriz të shqiptarëve dhe për t’i trajtuar ata si qytetarë të dorës së dytë.

Ky libër na njeh me dokumente autentikë për trajtimin

çnjërzor deri në shpërngulje e zhdukje të shqiptarëve me banim në trojet e tyre në Jugosllavi, Maqedoni, Kosovë, Preshevë, Mal të Zi, për të arritur në vitin 2001 tek lufta për të drejtat e shqiptarëve në Maqedoni, luftë që u përpoq të shtypej nga autoritetet maqedonase, por që u njoh dhe u përkrah nga autoritetet ndërkombëtare, nga SHBA, BE, NATO etj. Mbarimi i kësaj lufte çoi në Marrëveshjen e Ohrit dhe në ndryshimet kushtetuese për njohjen e të drejtave të shqiptarëve.

BALLKANI ËSHTË CILËSUAR FUÇI BARUTI DHE ËSHTË KARAKTERIZUAR NGA LUFTËRA PËR PUSHTIMIN E TOKAVE TË NJËRI TJETRIT.

Shqiptarët, jo se janë pak, jo se janë komb i vogël, por sepse janë europianë të vërtetë, janë paqësorë dhe të përparuar, kurrë nuk i kanë rënë në qafë të tjerëve. Përkundrazi të tjerët i kanë pushtuar trojet shqiptare. Libri i Gjen. Gëzim Ostrenit fillon me Lidhjen Shqiptare të Prizrenit dhe me Kongresin e Berlinit. Është fakt që kanë qenë katër vilajete shqiptare me qendër në Shkup, Shkodër, Manastir dhe Janinë. Është fakt që Shkupi ka qenë kryeqendra e Vilajetit të Kosovës dhe që ka patur në shekullin IX mbi 50 mijë banorë. Strategjitë shfarosëse të strategëve sllavë dhe serbë të Cubrilovicëve e deri tek Millosheviçi, dështuan. Sot kemi Shqipërinë anëtare e NATO-s, kemi Kosovën me perspektivë europiane dhe euroatlantike, kemi shqiptarët e Maqedonisë me të drejta më të mëdha se kurrë

më parë. Vetëm për të hapur Universitetin e Tetovës u bë luftë politike dhe deri protesta. Sot kemi universitete dhe shkolla shqipe në të gjithë trojet shqiptare. Por në çdo hap që hedhim duhet të nderojmë martirët dhe luftëtarët e kombit. Ata sakrifikuan jetën e tyre për të ardhmen e fëmijëve tanë sot. Autori i librit është një ushtarak profesionist, një sociolog dhe politikan, por mbi të gjitha është një luftëtar dhe atdhetar i madh. Ai mori pjesë në luftën e Kosovës në vitin 1999 dhe fill pas fitores në Kosovë së bashku me shumë gjeneralë të Kosovës, erdhën dhe luftuan e fituan për të drejtat e shqiptarëve të Maqedonisë, sepse këto të drejta shkeleshin me këmbë nga pushtetarët e verbër maqedonas.

Në aspektin ushtarak, çdo ushtarak që lexon këtë libër kujton konfliktet ndëretnike në Bosnjë, Gjeorgji, Armeni, Azerbaxhan, Nagorni Karabak, Ukrainë, etj si dhe periudhat pas konfliktit. Në këtë studim ushtarakët nuk do të gjejnë strategjinë dhe taktikat e luftës frontale, e luftës klasike, por strategjinë, veprimet operative-taktike të luftës midis palëve në konflikt. Do të gjejnë bashkëveprimin me organizmat dhe organizatat ndërkombëtare, me Kryqin e Kuq Ndërkombëtar, me UNHCR, me UNICEF, me shtetin shqiptar, me qarqet diplomatike dhe mbi të gjitha do të gjejnë kujdesin ndaj njerëzve në konflikt, që të mos vdesë asnjë njeri i pafajshëm.

Pas mbarimit të periudhës së Luftës së Ftohtë në Ish Bashkimin Sovjetik, në Ish Jugosllavi dhe në shumë vende federative

me bazë komuniste dhe jo me baza të shëndosha demokratike, ndodhën shpërbërjet e tyre dhe kthimi në shtetet me bazë etnike. Kjo u shoqërua me luftëra dhe konflikte ndëretnike, si ai i Bosnjës ku u derdh shumë gjak dhe u desh Marrëveshja ndërkombëtare e Dejtonit që të krijohet shteti multietnik i Bosnjës. Por politikanët e Europës dhe të Ballkanit nuk nxorën mësim nga konflikti i Bosnjës në vitin 1995-1996. Në vitin 1999 ndodhi konflikti i Kosovës ku u desh ndërhyrja e NATO-s.

Përsëri politikanët e Ballkanit, dhe veçanërisht ata maqedonas nuk nxorën mësim dhe keqtrajtuan qytetarët shqiptarë në Maqedoni. Dhe ndodhi që në vitin 2001 qytetarët shqiptarë të Maqedonisë të formonin ushtrinë e tyre për të frenuar shtypjen dhe trajtimin çnjerëzor që u bëhej nga qeveritarët maqedonas. Kjo ushtri dhe kjo luftë u drejtua politikisht nga Ali Ahmeti dhe ushtarakisht nga Gjen. Gëzim Ostreni, që vinte nga përvoja e luftës së Kosovës në vitin 1999. Zgjidhja e këtyre konflikteve nuk duhet ketë si opsion të fundit, luftën. Politikanët dhe pushtetarët e vërtetë dhe të zotë e kanë më të lehtë tu japin të drejtat qytetarëve të vet se sa ti shtypin me dhunë. Dhuna sjell vetëm dhunë. Mbi të gjitha këto mesazhe duhet t'i lexojnë qartë politikanët e rajonit të Ballkanit, ku shqiptarët janë shumicë, politikanët e Shqipërisë, Kosovës dhe të shqiptarëve të Maqedonisë, për të qenë të bashkuar dhe me mendje të kthjellët, për të qenë europianë në mendim dhe veprim. Bota është në prag të Luftës së III Botërore sepse vatrat


e luftës dhe të konflikteve në fakt janë më të gjëra se sa vetë territori i një lufte botërore. Shtresa e të pasurve, bankierë, biznesmenë etj do të bënte mirë që të plotësonin kërkesat e punëtorëve të vet se sa të thellonte hendekun e varfërisë dhe të padurimit. Mesazhet që vijnë nga ky libër janë të shumta. Ata janë mesazhe paqeje, tolerance dhe bashkëpunimi.

(Shkruar me bashkëautor Sakip Camin)



TESTAMENTI I ATDHEDASHURISË





Shprehja e përbotshme “Atdheu fillon te familja” është referencë e qindra kuvendeve, takimeve tryezave, sesioneve e konferencave shkencore, është refren i ditës.

100 vjet më parë, (më 1913) qyteti i Dibrës dhe Gjakovës ishin koncesionet e fundit që iu bënë monarkive të shteteve fqinje, që kishin pushtuar me forcën e armëve viset shqiptare gjatë Luftërave Ballkanike. Kjo padrejtësi historike u vendos në Konferencën e Londrës (1912-’13), ku u caktuan kufijtë e shtetit shqiptar. Pikërisht kur po caktoheshin dhe kufijtë, u ndanë dhe dy Dibrat, ndërsa dibranët përjetuan genocidin e pashembullt serb. E për rrjedhojë edhe eksodin e parë masiv, ku 80 mijë dibranë u detyruan të shpërnguleshin nga trojet e tyre në Dibër për t’u vendosur në Tiranë. Lanë një pjesë të vatanit, por sërish me familjet e tyre gjetën strehë në një pjesë tjetër të atdheut.

Pikërisht, 100-vjetori i rezistencës së dibranëve kundër serbëve dhe i eksodit të tyre drejt Tiranës u përkujtuan gjatë një konference shkencore që u mbajt në Muzeun Historik Kombëtar në Tiranë.

E nisëm me atdheun, për të evidentuar pikërisht ata që e kanë më të zjarrtë se askush tjetër ndjenjën e atdhedashurisë, si organizatorët kryesorë të këtij tubimi përkujtimorë. Dhjetra

personalitete të shquara të diaporës shqiptare në SHBA, me origjinë nga Dibra, qenë jo vetëm nismëtarë, por dhe organizatorë, sponsorë e referues në këtë event të rëndësishëm.

Një përshëndetje mjaft emocionuese në emër të komunitetit dibran, nga Musa Paçuku – kryetari i shoqatës “Dibra” me seli në të ashtuquajturin “Ishulli i Dibranëve” Staten Island – Nju Jork, ishte mjaft mbresëlënëse për qindra pjesëmarrësit në këtë konferencë shkencore. Në organizimin e kësaj konference shkencore një kontribut të vecantë dha gjithashtu Unioni i Krijuesve dhe Gazetareve Dibranë me president z.Fatos Daci.

Ylber Pilku, një tjetër personalitet i njohur i diasporës shqiptare në SHBA, do të evidentojë jo vetëm si pjesëmarrës aktiv, por edhe si organizator e sponsor kryesor i këtij aktiviteti. Billy (si e njohin të gjithë Ylber Pilkun) ndjehet më krenar se kurrë që mbështet financiarisht aktivitetin e Shoqatave “Dibra” (SHBA) dhe “Bashkësia Dibrane” (Tiranë), si vazhdimësi historike të Klubit atdhetar “Bashkimi Dibran”, të themeluar në Dibër më 26 dhjetor të vitit 1908, me qellim zgjimin e ndjenjave kombëtare dhe mbrojtjen e gjuhës dhe kulturës Shqiptare si rezistencë ndaj pushtimit. Kjo shoqatë i ka rrënjët e saj në lëvizjet patriotike dhe kombëtare, të cilat filluan të organizoheshin para shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë, ku Klubi atdhetar “Bashkimi Dibran” nga ku dhe shoqatat “Dibra” (SHBA) dhe “Bashkësia Dibrane” (Tiranë) kanë marrë këtë emërtesë, patën rol kryesor në rizgjimin e krenarisë kombëtare, patriotike, për të mbrojtur vendin e tyre kundër pushtuesit, duke i shërbyer çështjes kombëtare dhe përhapjes së gjuhës shqipe.

Pikërisht këtij qëllimi madhor i shërben edhe kontributi i Musa Paçukut e Ylber Pilkut, që u evidentuan dukshëm në 100 – vjetorin e kryengritjeve dibrane kundër shovinistëve serbë, së bashku me veprimtarin e dalluar të këtij komuniteti zotin Rrape Ruci – i cili njëherësh është edhe president i Insitutit Amerikano-Shqiptar “Gjergj Kastrioti Skënderbeu” me seli në State Island. Mbresëlënës ishte edhe interpretimi i një poezie të potetit tonë të madh, Lashgush Poradeci, nga aktori shqiptar nga Chicago, Pajazit Murtishi.

Dibra dhe dibranët janë të hershëm në histori si emër dhe si princa. Ja edhe dibranët e Amerikës vijnë si princa në atdheun e tyre me ndjenja të bukura, të frymëzuara dhe interesante! Vijnë më të mbushur së kurrë më ndjenja atdhetare dhe meditative që burojnë nga zjarri i zemrës së një shpirti të trazuar. Kulti i mërgimtarit është respekti ndaj kombit. Përjetimet, përkushtimet dhe krijimet janë të mbrujtura me ndjenjat fisnike të atdhe-dashurisë. Ëndrra e tyre është Shqipëria historike, me Çamërinë në Jug, me trungun e atdheut në zemër, dhe me Kosovën në Veri.

Së bashku, ata përcollën denjësisht testamentin e atdhe-dashurisë. Këtë testament tejet të vlefshëm që e ruajnë me fanatizëm në SHBA ku ata punojnë e jetojnë prej dekadash. Jo vetëm me fjalë, por me vepra konkrete ata dëshmojnë se atdheu i tyre fillon tek vetja, familja, shoqëria e kombi.

Atdhe abstrakt e hyjnor nuk ka e nuk ekziston. Këtë sentencë e shtjelluan më së miri në kumtesat e tyre Prof. Dr.Valentina Duka, historianët e mirënjohur Gazmend Shpuza e Bajram Xhafa si dhe Presidenti i Unionit të Krijuesve

Dibranë Fatos Daci. Ata nxorrën në pah para të pranishmëve heroizmin, vendosmërinë dhe rezistencën e dibranëve për të mbrojtur vendin e tyre nga çdokush që synon të cënojë të drejtat dhe kufinj të tyre gjeografikë. Për të qenë sa më bindës ata sollën në kujtesë edhe një raport të hollësishëm të një diplomati të huaj, ambasador i një shteti perëndimor, për mizoritë e ushtrisë serbe në Dibër, Strugë, Kërçovë, gjatë operacionit për shtypjen e kryengritjes antiserbe të vitit 1913, kur kryengritësit shqiptarë të Dibrës, Strugës, Ohrit, Kërçovës, Gostivarit arritën t'i dëbonin trupat serbe deri në malet e Manastirit. Rrallë ndonjëherë mund të gjendet një material me të dhëna aq të sakta e të hollësishme, jo vetëm për vrasjet dhe masakrimin e njerëzve, por edhe për grabitjen e pronës dhe të pasurisë.

Dibra ka nxjerrë burra të rrallë, që u shndërruan në personalitete të shquara të vendit tonë si: Vehbi Dibra, Haki Sharofi, Isuf Elezi, Iljaz Dibra, Dine Hoxha etj. Ata u përkujtuan me respekt dhe nderim të veçantë në këtë konferencë shkencore.

Një të njëjtën linjë ishte edhe përshëndetja e zjarrtë e kryetarit të Shoqatës “Bashkësia Dibrane”, Dr. Faruk Borova i cili ndër të tjera nxorri në pah vlerat më të larta të dibranëve, si dhe bujarinë dhe mikpritjen e tiranasve, të cilët u hapën portat e shtëpive dhe zemrave të tyre dibranëve, pikërisht në atë kohë kur ata kishin më së tepërmi nevojë. Ai gjithashtu përmendi faktin se si dibranët emigruan drejt Tiranës dhe jo drejt një qyteti tjetër, mos ndoshta me parandjenjen se Tirana do të kishte këtë zhvillim që ka tani dhe do të bëhej kryeqendra e Shqipërisë.


Ai falënderoi në mënyrë të veçantë të gjithë ato familje

tiranase të asaj kohe që mikpritën me shumë dashuri dhe bujari dibranët, të cilët të detyruar nga shovinizmi dhe reprezaljet serbe morën rrugën e mërgimit, pa e ditur se ku do të përfundojnë. Dr.Borova përmendi dëmet e shumta të agresionit serb, si: me mijëra njëjërëz të vrarë, burra, gra, pleq e fëmijë, me mijëra shtëpi, xhami e teqe të djegura e të shkatërruara. Pikërisht këto ishin ndër shkaqet më kryesore që detyruan më shumë se 20.000 dibranë të emigrojnë drejt qyteteve të tjera të Shqipërisë, por edhe jashtë saj, por kryesisht në Tiranë, e cila në atë kohë përbëhej nga 8000 banorë.

Ndoshta edhe për këto fakte pjesëmarrësit vlerësuan prarinë në këtë konferencë të rëndësishme të kryetarit të Shoqatës “Tirana”, Z.Arben Tafaj.


Në këtë aktivitet morën pjesë anëtarë të familjeve të vjetra dibrane, personalitetet të shquara, veprimtarë dhe aktivistë dibranë që prej vitesh jetojnë në Shqipëri, kryeqytetin e shqiptarëve Tiranën. Ndërkohë, që një grup (30 veta) intelektualësh dibranë, veteranë të arsimit, profesorë dhe arsimtarë, me ndihmën financiare të veprimtarit dhe biznesmenit të suskeshëm dibran në SHBA, Ylber Pilku nga kompania “Pilku-Construction” në Nju Jork, udhëtoi drejt Tiranës, për të marrë pjesë në këtë konferencë, kushtuar 100-vjetorit të Kryengritjes së Përgjithshme të Dibrës dhe eksodit të parë masiv dibran, në Tiranë dhe Elbasan.

Sëbashku ata përcollën me dinjitet testamentin e atdashedashurisë.



**NË PEZË, PA PROTAGONISTËT
E KONFERENCËS SË PEZËS**





Për herë të parë gjatë këtyre dy dekadave pluralizëm, veteranët e OBVL nuk ftohen për të marrë pjesë në veprimtaritë përkujtimore kushtuar Kuvendit të parë pluralist. Në Pezë, për të përkujtuar 72-vjetorin e Konferencës së Pezës (më 16 shtator 2014) ishin përfaqësues të lartë të qeverisë e mazhorancës, por jo protagonistët dhe mbështetësit e vërtetë të asaj konference historike.

Nëse Konferenca e Pezës njihet si përpjekja e parë madhore për unifikimin e faktorit shqiptar, 72 vjet më vonë organizatorët e veprimtarive në përkujtim të saj shfaqen dukshëm si faktor përçarës. E njëjta strategji si dhe në Komisionin e posaçëm qeveritar të 70-vjetorit të çlirimit të atdheut, ku ftohen vetëm përfaqësues të Komitetit Kombëtar të Veteranëve të LANÇ, që drejtohet nga pasardhës veteranësh dhe mënjanohen qëllimisht veteranët e OBVL që drejtohen nga gjeneral-lejtnant Rrahman Parllaku, i vetmi “Hero i Popullit” i gjallë, që i mbijetoi Luftës së II-të Botërore dhe terrorit komunist.

Nëse Dr. Ymer Dishnica, një nga personalitetet kryesore të Konferencës së Pezës, por edhe organizator kryesor i Konferencës së Mukjes, e cila realisht hodhi themelet e një Shqipërie të ardhme pluraliste, demokratike, por edhe të një bashkimi

të pashmangshëm të trojeve shqiptare, para 20 vitesh do të themelonte OBVL-në, me synimin për t'i bashkuar veteranët e LANÇ në një organizatë të vetme, krerët e mazhorancës së majtë rikthehen tek ish-Komiteti, levë e PPSH, duke lënë në harresë mbështetësit e këtij personaliteti që ka firmën në ato akte që shndrisin dhe do të shndrisin gjithmonë në historinë tonë kombëtare.

Nëse mesazhet e Konferencës së Pezës janë gjithnjë aktuale dhe frymëzuese për faktin se kjo konferencë njihet si përpjekja e parë madhore për unifikimin e faktorit shqiptar, duke e renditur vendin përkrah koalicionit botëror antifashist, përpjekjet e krerëve të mazhorancës së majtë për t'i përçarë veteranët e LANÇ janë sa qesharake, aq edhe absurde.

Shtatëdhjetedy vjet më parë, platforma kryesore e konferencës ishte bashkimi i shqiptarëve pa dallim feje, krahine dhe ideje në frontin nacionalçlirimtar. Pikërisht kjo frymë është përçarur edhe në 20 vitet e shkuara, kur veprimtaritë përkujtimore kushtuar kësaj ngjarjeje kulmore të historisë sonë kombëtare, sipas protokollit qeveritar organizoheshin nga Bashkia e Tiranës dhe Komuna e Pezës.

Ndryshimi ndodhi vetëm në 2014, kur organizimi u la në dorë të z. Erion Veliaj, ministër i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë. Ky ndryshim ka qartazi sfond politik. Veliaj, i shumëkuzuar për afëra korruptive (edhe në rastin e Pezës) nuk mund të ftonte kursesi në këtë përvjetor pasardhësit e Dr. Ymer Dishnicës, njeriut që zë vendin e merituar në panteonin e nderit të kombit shqiptar, siç është Rrahman Parllaku, një nga figurat më

simpatike, më të mençura, më fisnike dhe një nga udhëheqësit kryesorë të LANÇ-it. Atij i mjaftojnë të ketë në sfond pasardhës veteranësh të asaj organizate levë e PPSH (PS) që edhe sot mbron me fanatizëm ish-kreun e diktaturës komuniste. Krerët e kësaj mazhorance ishin në Pezë vetëm me ata që më 24 Maj 2014 demonstuan me portretet e Enverit në Përmet e Berat.

Më 16 shtator 2014 nuk u ftua për në Pezë kreu i OBVL, Rrahman Parllaku, që si gjeneral i tri epokave, është memoria historike e kombit, ndërsa në krah të krerëve të qeverisë ishin pinjollë të diktatorit që predikojnë edhe sot “mësimet e tij të vyera”.

Zv/kryeministri Peleshi dhe ministrja e Mbrojtjes, Kodheli, u shprehën në unison për domosdoshmërinë e përcjelljes së vlerave të luftës te brezi i ri. Por kjo është dukshëm demagogji, sa kohë vetë ata mënjanojnë qëllimisht protagonistët e kësaj lufte në veprimtari të tilla. Kreu i OBVL, Rrahman Parllaku, si një personalitet me virtyte të larta njerëzore, këtë qëndrim ua ka bërë të qartë si zyrtarisht dhe në takimet që ka pasur me kryetarin e Kuvendit, Ilir Merta, zv/kryeministrin Peleshi e ministren e Mbrojtjes Kodheli. Parllaku ka reaguar edhe për planifikim fondesh qeveritare në mënyrë disproporcionale për 70-vjetorin e çlirimit të atdheut, (duke dhënë qindra milionë për koncertet e OJQ-ve të ministrit Veliaj dhe fonde minimale për mirëmbajtjen e monumenteve e varrezave të dëshmorëve). Por, sugjerime të tilla të vlefshme kanë rënë në veshët e shurdhët të zyrtarëve të lartë, sa kohë denigrohet qëllimisht OBVL, e cila në 20 vjet veprimtari intensive u dëshmua para



shqiptarëve si organizata që vlerëson lart kontributin e shquar të popullit shqiptar në Luftën e Dytë Botërore, që dënon krimet e komunizmit, që mbështeti fort luftën e drejtë të UÇK-së dhe në tërësi çështjen mbarëkombëtare shqiptare.

Organizata e Bashkuar e Veteranëve të LANÇ të popullit shqiptar, (OBVL) anëtare e Federatës Europiane e Botërore të veteranëve u krijua para 20 vitesh me nismën e një grupi prej 64 personalitetesh, gjeneralësh dhe luftëtarësh, figura politike të respektuara, por fatkeqësisht të dënuar nga regjimi komunist. Në këtë grup bënin pjesë figura politike të respektuara, që kishin qenë drejtues të reparteve partizane e ministra, siç ishin: Dr.Ymer Dishnica, gjeneral. Rrahman Parllaku, Kiço Ngjela, Manol Konomi, Fadil Paçami, Maqo Çomo, Sadik Bekteshi

(gjenral lejtant-Hero i Popullit), Muhamet Prodani (general lejtant-Hero i Popullit), gjeneral-majorët: Nexhip Vinçani, Skënder Malindi dhe Ernest Jakova; luftëtarët e shquara, drejtuese në luftë e aktiviste të OBVL: Selfixhe Broja (Ciu), Ze-nepe Golemi (Ashiku), Liri Belishova, Vera Ngjela (Pojani) e disa të tjera, por fatkeqësisht të dënuara nga regjimi diktatorial i Enver Hoxhës.


Pikërisht këto personalitete apo dhe pasardhësit e tyre nuk u ftuan të merrnin pjesë në veprimtaritë përkujtimore të 72-vjetorit të Konferencës së Pezës. Dhe gjasat janë që ndasi të tilla të promovohen edhe në veprimtaritë tjera në kuadrin e 70-vjetorit të çlirimit, duke nxitur kështu frymën e urrejtjes e përçarjes edhe mes dy organizatave të veteranëve të LANÇ.

(Botuar më 17 shtator 2014 në “Gazeta Shqiptare” dhe “TELEGRAF”



PESHA E DHIMBJES PËR AZEMIN





Ndonëse autoritetet shtetërore dhe gjithë demokratët e vërtetë i bënë nderimin e merituar duke varrosur eshtrat tek “Dëshmorët e Kombit”, motra e Azemit, Nuria është e pushtuar nga një dhimbje e thellë. U bënë disa vjet pa dhe me Azemin! Pa njeriun më të dashur të zemrës, që 12 shtatorin e kobshëm të vitit të mbrapshtë 1998 u ekzekutua nga dora vrastare e bishës gjakatare.

Ndërkohë, pranë tij për çdo javë, çdo përvjetor ditëlindje e ditëvdekjeje, Nuria, djemtë e vajzat, nipërit e mbesat, me kurora e tufa me lule, me lotë të pashtershëm pranë varrit të Azemit. Madje ajo ngrehinë varrmihëse në Sharrë mund të konsiderohej si “shtëpiza” e dytë e Nurijsë Hajdarit.

Nuk ka dashuri më të madhe se sa ajo e motrës për të vëllanë. Por tek Nurijsë kjo është shumëfish më e madhe, sa dhe pesha e dhimbjes. Sepse e ka rritur si vëllanë më të vogël, është kujdesur për të kur ka shkuar në klasën e parë duke i mbështjellë librat....e ka përcjellë e pritur kur shkonte e vinte nga shkolla në Tiranë.....E ka mbështetur dhe inkurajuar si askush tjetër në atë dhjetor të furishëm të '90-tës kur doli si uragan kundër sistemit më të egër. Kur u përball me të dhe e

rrëzoi. Për të gjitha këto, motra, Nurija ndjehet krenare për Azemin.

Nurija ishte vetëm 7 vjeçe atë 11 mars të vitit 1963 kur do të lindte Azemi. Me nostalgji ajo sjell në kujtesë çastin e vendosjes së emrit të njeriut që do të bënte epokë të ndritur në historinë e Shqipërisë. “Në shtëpinë tonë përdhese, kur lindi Azemi, babai ynë ndjesë pastë, erdhi e na tha se a keni menduar për emrin?!...Dhe kur u ndesh me heshtjen tonë, tha se familja jonë përfaqëson dhe trashëgon patriotizmin e shqiptarëve ndër shekuj. Ndaj dhe do ta pagëzojmë me emrin e një heroi të dëgjuar siç ka qenë Azem Galica”.

Po përse ndjehet sot më e trishtuar se kurrë? Jo se nuk krenohet me nderimet që i bëhen nga bashkëluftëtarët, dhjetoristët e '90-tës, nga gjithë shqiptarët demokratë të vërtetë, por sepse ishte mësuar ta merrte çdo tre ditë rrugën nga Lapraka për në Sharrë...dhe i duket disi i “vështirë” ndryshimi i kahjes së këtyre udhëtimeve për në Sauk tek varrezat e “Dëshmorëve të Kombit”, pranë Monumentit “Nënë Shqipëri” ku tashmë prehet i qetë tribuni i nacionalizmit shqiptar. Këtë dhimbje e shpreh fytyra e saj e vrerosur, e shprehin lotët pambarim që s’po i shterojnë... Por edhe kështu e përlotur ajo di ta bëjë vlerësimin për ata që përmbushën më së miri amanetin e Azemit. “I jemi borxhli për jetë Lulzim Bashës, që edhe në këtë rast është projeksioni ynë. Kryebashkiaku që ishte ndër kryesorët në nismën për vendosjen e monumentit në Qendër të Qytetit “Studenti” nga ku Azemi nisi betejën për shembjen e komunizmit, në përvjetorin e 15-të të

ekzekutimit të tij, me përgjegjësinë e kryetarit të PD realizoi rivarrimin e eshtrave të Liderit të Dhjetorit tek Varrezat e Dëshmorëve të Kombit”, shprehet Nurija. Është ky treguesi më sinjifikativ i vlerësimit për vëllanë tim, vëllanë e gjithë dhjetoristëve të ’90-tës, frymëzues i brezave të të rinjve demokratë që aspirojnë demokracinë e vërtetë.

Azemi tashmë është më pranë fëmijëve e bashkëshortes së tij shembullore, Fatmirës, që për vite e vite mban hapur derën për të gjithë ata që vijnë e nderojnë Azemin, më pranë shtatores së tij në Qytetin “Studenti” dhe fare pranë Monumentit “Nënë Shqipëri” që ai aq shumë e deshi... Po ti vështrosh me vëmendje këto tre skaljone janë pothuajse në një vijë drejtvizore. Edhe për këtë gjetje Nurija është krenare.

Nderim të veçantë shpreh motra e Dëshmorit të Atdheut, Heroit të Demokracisë, Liderit të Dhjetorit, për ata që nderojnë Azemin. Ai tashmë është i veshur me pavdekësi...

Në 12 shtator 1998, vrasësit u shfaqën në formën e djallit dhe e goditën pa mëshirë. Ata ia kishin menduar vdekjen prej kohësh. Vdekja i erdhi e vrazhdë. I ishte afruar kushedi sa herë, por pa e frikësuar. Atë natë të 12 shtatorit 1998, erdhi me mot të keq. Duhej të binte shiu dhe të fikeshin dritat. Edhe në errësirë, Azemi mendonte për dritën. Ai ishte në betejë me lirinë e kufizuar. Dhe vdekja thonë se është e ëmbël dhe e ndershme kur vdes për liri, ndaj Azem Hajdari ishte një dhuratë e madhe për mbarë shqiptarët dhe në mënyrë të veçantë për demokratët anëmbanë vendit, të cilët me 12 shtator të 1998-ës, e qanë si një hero dhe sot e kujtojnë si

një martir të demokracisë. Çastet e jetës së shkurtër i bëri të përjetshme. Familja e tij sot ngre kokën lart dhe kujton një të vërtetë: Azemi vazhdon të zotërojë... Thjesht, vetëm iku. Fëmijën e vogël e la në barkun e bashkëshortes. Azemi i vogël s'ë njohu dot të atin. Rudinën e pengoi e ëma ta shihte të vdekur. Ajo duhej ta mbante mend vetëm të gjallë. Kiri e pa të rrëzuar me shpresën se do të ngrihej, ashtu shtatlartë siç kishte ndodhur edhe në atentatet e tjera. Kurse Fatmira, s'ë la dhembjen që t'i mundë, por kujtoi buzëqeshjen e Azemit që trembte çdo lot dhe frikë, kur i përcolli nga selia e PD-së drejt shtëpisë.

Azem Hajdari u shqua për vetitë e tij, që në fillimin e Lëvizjes Studentore të vitit 1990 për të vazhduar më pas me veprimtarinë e tij politike, duke mbetur në kujtesën historike si një udhëheqës me vlera të rralla demokratike e patriotike, për të cilat atij i është dhënë, pas vdekjes, edhe Urdhri i lartë "Gjergj Kastrioti Skënderbeu" nga Presidenti i Republikës. Azem Hajdari do të mbahet mend si kalorës i lirisë dhe do të mbetet modeli i politikanit të ri për të guxuar e për të mbrojtur vlerat që ai beson.

Figura e Azem Hajdarit mbetet në memorien e gjithsecilit si një njeri i veçantë e i papërsëritshëm, vetitë e të cilit i përkasin një heroi kombëtar. Natyrisht që vitet kalojnë shumë shpejt, por Azemi mbetet në memorien e gjithsecilit, sidomos të miqve dhe të shokëve të tij. Një njeri shumë i veçantë, me një karakter të fortë, gati-gati të papërsëritshëm. Kjo është arsyeja që ne e kujtojmë Azemin jo vetëm

në përvjetorët e rënies së tij, por në çdo moment tjetër kur flitet për heronj.


Nëse në shtator 2013 lideri historik i Dhjetorit u rikthye aty ku 23 vite më parë u priu studentëve në një lëvizje që do të merrte përmasa mbarëkombëtare për shembjen e një prej diktaturave më të egra që kishte njohur historia e njerëzimit, në 15-vjetorin e vdekjes erdhi pranë monumentit “Nënë Shqipëri” me ëndërrën e tij të realizuar: Shqipërinë anëtare të NATO-s dhe me bashkimin e shqiptarëve në BE.



*Adem Hoxha,
Ventotene,
qershor 1940*

**HISTORIA E CENTRALISTIT QË
URDHËROI HAPJEN E ZJARRIT
NDAJ MONARKOFASHISTËVE
GREKË MË 2 GUSHT 1949**





Më 2 gusht 1949, do të ishte një centralist i thjeshtë nga Çidhna e Dibres urdhëruesi i hapjes së zjarrit ndaj provokatorëve monarkofashistë grekë në kufirin shqiptar të Kapshticës.

Adem Hoxha, çentralist i postës kufitare në Kapshticë të Devollit, kishte radhën e shërbimit të gatishmërisë luftarake në natën e datës 1 (një) gusht duke u gdhirë 2 (dy) gusht i vitit 1949, kur rreth orës 02:00 të mëngjesit të datës 2 gusht 1949, ra zilja e telefonit. Mori receptorin dhe nga ana tjetër, personi që i fliste, u prezantua se ishte komandanti i Postës kufitare të Vidohovës.

Për momentin emri i tij nuk më kujtohet, - tregonte Ademi, - por mbaj mend se ai ishte një djalë i ri rreth të njëzet e dy-tre vjetëve, të cilit, sapo kishin filluar t'i dirsën mustaqet. (Sipas bashkëkohësve, ai duhet të ketë qenë Memo Nexhipi Bejko, - pak çaste para se të binte dëshmor, i cili më pas është shpallur “Hero i Popullit”).

Kur Komandanti i postës së Vidohovës, z.Memo Nexhipi Bejko i ka kërkuar centralistit Hoxha që ta lidhte me komandantin e regjimentit, Ademi, iu përgjigj se “Komandanti i regjimentit në këtë orë është në shtrat, duke fjetur në shtëpinë

e tij, në Korçë. Ai nuk ka telefon në shtëpi.”

Më pas Komandant Memoja i ka kërkuar kufitarit nga Dibra që ta lidhte me Ministrinë e Mbrojtjes, por sërish ka marrë përgjigje refuzuese! “Përderisa nuk mundem me të lidhur me Korçën, si mundem me të lidhur me Ministrinë në Tiranë?! Ne nuk kemi lidhje me radio, por vetëm një central të thjeshtë, me tel !”, -i është përgjigjur Adem Hoxha. Dhe në kushtet kur forcat greke kishin shkelur 500 metra në territorin tonë kufitar, komandant Memoja, i zënë ngushtë i ka kërkuar një mendje centralistit nga Dibra se si duhej të vepronte.

-Zjarr!, - i është përgjigjur Ademi.

-Si të hap zjarr?! Me urdhër të kujt të hap zjarr?!, - i tha komandanti i postës së Vidohohëvs.

-Me urdhërin tim! – i është përgjigjur rrufeshëm kufitar Ademi.

-Si me urdhërin tënd?! – ka vijuar komandanti?!!

-Po të them: Me urdhërin tim! Kur forcat greke do të vijnë te posta, ti a do t’u japësh cigare e duhan dhe t’ua nderësh me shkrepse me dorë në zemër?! Zjarr mbi agresorët, se vetëm kështu mbrohet Atdheu!

Vetëm këto ishin fjalët e fundit që këmbyen komandant Memoja dhe centralisti Adem Hoxha ndërmjet tyre, në mëngjesin e 2 gushtit 1949, para se të fillonte lufta mbrojtëse në Vidohovë kundër agresionit të monarkofashistëve grekë të 2 gushtit 1949.

Pra, e thënë ndryshe, urdhërin luftarak për fillimin e zjarrit të parë, të pushkëve të para në Vidohovë me 2 gusht 1949

e ka dhënë, me inisiativën e vet, një ushtar i thjeshtë dibran, Adem Islam Hoxha, ish-centralist i postës kufitare të Kapshiticë -Vishocicë-s. Më saktë, me atë arsyetim logjik të pjekur, tepër bindës, në ato rrethana të jashtëzakonshme bindi me të drejtë komandantin e Postës së Vidohovës për të hapur zjarr mbrojtës kundër agresionit të monarkofashistëve grekë, më 2 gusht 1949, në atë situatë të nxehtë luftarake.

Një arsyetim i tillë, si ai i Adem Hoxhës, është tepër bindës dhe i drejtë edhe tani, pas më shumë se gjashtë dekadash, në kohë paqeje dhe në një situatë tjetër marrëdhëniesh krejt të ndryshme nga ajo e asaj kohe. Nuk mund të kishte asnjë zgjidhje tjetër, përveç asaj të Adem Hoxhës, të mëngjesit të 2 gushtit 1949: për të hapur zjarr mbi agresorin.

Kjo është një e vërtetë historike, ndonëse e pashkruar ndokund, ashtu si shumë të vërteta të tjera të pashkruara të historisë së popullit shqiptar, e rrëfyer qartë nga protagonistin e kësaj ngjarjeje në vitin 1993, kur ishte në moshën 76 vjeçare.

Po kush ishte ky ushtari, Adem Hoxha, që mori një nisativë të tillë për të dhënë një urdhër luftarak të tillë, për fillimin e një lufte frontale si ajo e 2 gushtit 1949?! Çfarë përgatitje ideo-politike e ushtarake kishte ai person që paska marrë një inisiativë të tillë për të dhënë një urdhër luftarak të tillë si ai, për të hapur zjarr kundër provokacioneve të një ushtrie të një shteti tjetër, si Greqia?

Adem Hoxha, i biri i Islamit dhe i Lihes (1917-1993), nga Çidhna, Dibër, veterani i Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar, i internuar në kampin e përqëndrimit

nazifashist në Ventotene, Itali, në periudhën janar 1940 - dhjetor 1941 dhe luftëtari i vijës së parë të frontit të luftimeve për mbrojtjen e kufijve të Atdheut tonë nga provokacionet e monarkofashistëve grekë në gusht të vitit 1949, ishte tepër modest, ndaj nuk ka lënë kujtime të shkruara, por vetëm këto rrëfime gojore që nuk na shqiten lehtë nga kujtesa.

KUFITARI QË VINTE NGA KAMPI NAZIFASHIST NË VENTOTENE TË ITALISË

Adem Hoxha, i biri i Islamit dhe i Lihes, lindi në Çidhën, Dibër, më 9 janar 1917 dhe vdiq më 2 mars 1993. Babai dhe nëna i vdiqën nga epidemia e tifos e vitit 1917, duke e lënë jetim, qysh 6 muajsh. Atë e rriti dhe e edukoi gjyshi i tij, Abdurrahmani (Hoxhë Kuta), i njohur me titullin “Hoxha i 12 mijëve” në Shehër të Thatë, njëri ndër udhëheqësit popullor për organizimin e rezistencës të krahinës të Çidhnës e të mbarë Dibrës kundër pushtuesve serbo-sllavë në fillim të shekullit XX (gjatë viteve 1912-1920). Edukimin e parë atdhetar me dashurinë për atdhe dhe urrejtjen kundër armiqve pushtues e mori qysh në moshën 3-vjeçare, në vitin 1920, në kohën e pushtimit serb për të shpëtuar nga masakrat e pushtueseve, kur për tre muaj rresht u strehua në një shpellë në Gjalica të Çidhnës, në një kohë që pjesa tjetër e popullsisë së Dibrës u shpërngul drejt Tiranës, ashtu si në vitin 1913. Që nga ajo kohë, dhe sot e kësaj ditë, ajo quhet “Shpella e Hoxhës”.

Në vitin 1940 për veprimtari atdhetare antifashiste, u burgos nga pushtuesit italianë dhe u internua më pas në kampin e përqendrimit nazifashist në Ventotene të Italisë ku u dënua me 2 vjet dhe qëndroi nga janari 1940 deri në dhjetor 1941. Ky fakt vërtetohet edhe nga regjistri që gjendet pranë Komitetit Kombëtar të Veteranëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të Popullit Shqiptar, Tiranë në faqen nr.3 të të cilit me nr.rendor 21, z.Adem Hoxha (atëherë Kuta) figuron të ketë qenë i internuar prej nazifashistëve në kampin e përqendrimit në Ventotene, Itali, prej datës 11.02.1940 deri në dhjetor 1941, duke mos u përfshirë këtu koha e paraburgimit në Peshkopi, para transferimit në Itali dhe ajo e qëndrimit prej 24 ditësh të tjera në burgun e Barit në Itali.

Në kampin nazifashist të Ventotenes Ademi u njoh dhe u miqësua me atdhetarë të tillë, udhëheqës të rezistencës shqiptare kundër pushtuesve nazifashistë, si Nazim Rushiti, Sadik Bekteshi, Ibrahim Dervishi, Abdyl Këllezi, Zef Mala etj. apo dhe me nacionalistët Safet Butka, Abas Ermeni, Prof.Isuf Luzaj etj. Shoqëria dhe miqësia e tij me figura të tilla, ia rriti Ademit eksperiencën dhe pjekurinë politike.

Në dhjetor 1947 kur i kishte kaluar 30 vjeç, u mobilizua për të kryer shërbimin ushtarak të detyruar në Qarkun e Korcës, (gjatë viteve 1947-1950), prej të cilëve, dy vjetët e fundit në kufi, në Bilisht. Pra, në kohën kur dha urdhërin luftarak për të hapur zjarr mbi forcat agresive të monarkofashistëve grekë, Ademi i kishte të gjitha cilësitë dhe aftësitë si dhe ngritjen ideo politike dhe përgatitjen ushtarake për të komanduar e për të



Adem Hoxha, Kapshticë, gusht 1949

dhënë një urdhër luftarak me peshë të tillë që ishte vendimtar për fatet e atdheut.

Për aktin heroik ish centralisti dibran i postës kufitare “Guri” në Kapshticë të Devollit, Adem Hoxha është dekoruar me “Medaljen e Trimërisë”. Kjo vërtetohet me çertifikatën e lëshuar nga ish Presidiumi i Kuvendit Popullor të RSH me nr.6749 dhe nr.i Dekretit 911, datë 23 gusht 1949 që mban nënshkrimin e ish-Presidentit Dr.Omer Nishani dhe të ish-Sekretarit Sami Baholli. Në këtë Medalje është shënuar ky motivacion: “Gjatë luftimeve për mbrojtjen e kufijve t’Atdheut

në sektorin e Trestenikut nga agresioni i monarko-fashistave grekë, është dalluar për trimëri, vendosmëri e besnikëri”. Kjo certifikatë është një argument tjetër më shumë që vërteton katërcipërisht se Adem Hoxha ka qenë i saktë në rrëfimet e tij të para dy dekadave. Përpos kësaj, autoriteti i tij i padiskutueshëm në jetën civile, kur ka shërbyer mbi 60 vjet si imam, drejtues fetar dhe shoqëror, nuk lë asnjë shteg për asnjë fije dyshimi mbi të vërtetën e tregimeve të tij për organizimin e rezistencës ndaj provokacioneve të monarkofashistëve grekë të 2 gushtit 1949.

Si bashkëbisedues i para dy dekadave ruaj në memorien episode të rëfyera mjeshhtërisht nga Adermi për Provokacionet e 2 gushtit 1949. Shpesh herë ai thoshte se jetën në atë luftë ia ka shpëtuar ish- Komandanti i Regjimentit, z.Baki Starja. “Gjatë luftimeve unë kisha detyrë që të mbaja ndërlidhjen me central fushor, të lëvizshëm, atje ku zhvilloheshin luftimet. Pozicioni i centralit nuk mund të ndryshohej pa urdhërin e komandantit. Në një moment të caktuar, gjatë luftimeve ra një predhë murtajë e armikut vetëm disa metra larg, ngjitur me pozicionin ku unë kisha vendosur centralin. Pranë meje ndodhej edhe z.Baki Starja, më vonë gjeneral. Fill pas atij momenti, komandant Bakiu më urdhëroi: Adem, shpejt spostoje centralin mu në gropën që hapi predha e murtajës së armikut. Sapo unë instalova aparaturën e telefonit në vendin e caktuar, vetëm disa sekonda më pas, ra predha e murtajës së armikut, pikërisht në vendin ku unë pata më parë pozicionin e centralit. Po të mos kisha ndërruar pozicionin e instalimit të centralit, unë

do të isha vrarë në atë luftë,” - tregonte Ademi, duke shprehur njëherësh edhe respektin dhe mirënjohjen për Gjeneral Baki Staren që ka qenë oficer madhor në Provokacionet e gushtit 1949. Gjatë një takimi të rastësishëm, gjenerali në pension, Baki Starja, jo vetëm ma konfirmoi plotësisht atë çka treguam më sipër, lidhur me spostimin e centralit fushor, por pasi më shprehu edhe konsideratën e lartë dhe kujtimet që ruante për ish-ushtarin e tij 32-vjeçar, nga Dibra, bashkëmoshatarin Adem Hoxhën, më tregoi edhe arsyen e dhënies së atij urdhëri, d.m.th. eksperiencën e tij luftarake.

NGA RRËFIMI I GJENERAL BAKI STARJES

Gjeneral Baki Starja që kishte kryer shërbimin e detyruar ushtarak në kohën e luftës Italo-Greke, kujton gjithashtu kohën kur ka qenë i mobilizuar në repartin e ushtrisë shqiptare dhe shoqërinë me bashkëushtarin Vesel Bushi (Spata) nga Bllaçja e Peshkopisë nga. Nga përvoja e asaj lufte ata kishin mësuar se ushtria greke, artilierët i kishte ushtarë të karrierës me rrogë dhe jo rekrutë të shërbimit të zakonshëm të detyruar. “Artilierët grekë, si profesionistë të kualifikuar, predhat e artillerisë nuk i shpërdoronin, prandaj ata nuk shenjonin me gjuajtje dy herë në të njëjtin vend, por për çdo qitje e lëviznin gradimin e shenjimit, për të mos rënë dy predha radhazi në të njëjtin vend. Duke ditur këtë eksperiencë, unë e urdhërova Ademin që menjëherë të spostonte instalimin e aparaturës së centralit



Adem Hoxha dhe Arif Pitarka – gusht 1949

pikërisht në vendin kur ra predha e mëparshme, pasi e dija se aty ishim të sigurtë nga goditjet e armikut”,-tregon gjeneral Starja. Ndërsa centralisti Adem Hoxha, me krenari pohonte faktin që të gjithë ushtarët dibranë që morën pjesë në luftimet kundër provokacioneve të gushtit, shkëlqyen, duke u dalluar ndër të tjerët. Kjo sipas tij edhe për faktin se asnjë ushtar dibran nuk u largua nga pozicioni i luftimeve, ku e kishte caktuar

komanda, por të gjithë ata, në përfundim të luftimeve u gjetën në vijën e parë të frontit. Kjo, ndoshta, u bë shkak që më pas dibranët të shiheshin me një sy tjetër më të mirë, nga komanda, ndryshe nga më parë, pasi deri para provës që dhanë në luftime, ata shiheshim si të dyshimtë, për shkak të luftës që qe bërë në Fushaliev të Dibrës, në korrik të vitit 1944. E thënë ndryshe, luftimet e provokacioneve të gushtit 1949 u bënë shkak që të rehabilitoheshin dibranët. Në këtë aspekt, ndër më të dalluarit, përveç oficerëve Bajram Hysen Kovaci e Isuf Daci, nga Grykë-Noka, ai kujtonte edhe Arfi Pitarkën po nga Grykë-Noka, që shërbente në postën e Vidohovës, si dhe të tjerët nga reparte të tjera si Fali Konozi nga Grykë-Noka, i plagosur, Sulë Daci po nga Grykë-Noka, Sali Pana nga Kodër-Leshej që ra dëshmor; të gjithë të dekoruar me “Medaljen e Trimërisë” etj.


Ndër shokët dhe kuadrot drejtues të rezistencës kun dër agresionit të provokacioneve greke të 2 gushtit '49, Ademi ruante respekt të veçantë për kolonel Skënder Malindin që jeton edhe sot. Kjo edhe për faktin se kolonel Malindi, i sapo kthyer nga Akademia Ushtarake e Bashkimit Sovjetik, në vitin 1947, e konsideronte Ademin jo si ushtar të thjeshtë, por si shok, të barabartë me të.

Ndaj dhe organizatorët dhe pjesëmarrësit e asaj rezistence të pashembullt ndaj agresionit të monorkofashistëve grekë, meritojnë nderim të veçantë.



**REKUIEM PËR
ISH GARDISTIN SHEMBULLOR
ARBEN ZHUZHI**





Më 14 shtator 2012, ish punonjësi i Gardës së Republikës, Arben Zhuzhi humbi jetën në një aksident në krye të detyrës, si drejtues i mjetit të Sigurisë të Presidentit të Republikës. Në çdo 14 shtator atë e përkujtojnë me nderim të veçantë familja dhe të afërmit si dhe ish kolegët e tij të shërbimit të Gardës.

Një çertifikatë mirënjohjeje për të ndjerin Arben Zhuzhi nga ish-kryegardisti Artan Hoxha flet shumë për vlerësimin që shteti iu bën “rojtarëve” të sigurisë të autoriteteve të tij.

Një dokumentar i publicistit të mirënjohur Defrim Methasani ndiqet me vëmendje të veçantë nga qindra e mijëra qytetarë që nderojnë ish punonjësin e Gardës së Republikës të rënë në krye të detyrës.

Njeriu që flet me mungesen e tij “ringjallet” nëpërmjet këtij dokumentari ku jepen gjer në perfeksion detaje nga jeta dhe akti heroik i djaloshit dibran.

Për herë të parë, një vit pas rënies në krye të detyrës, skenaristi, kronikani dhe operatori i talentuar D.Methasani, sëbashku me njerëzit e familjes Zhuzhi kanë udhëtuar pa Benin, tashmë drejt vendlindjes së tij, Dibrës. Stacioni i tyre i parë, fshati Dovolani, një fshat i madh e i bukur, plot gjelbërim, ku lindi Arbeni, me 30 qershor të vitit 1964. Prindërit Ganiu

dhe Fatmira, bëhen me fletë për këtë dhuratë të Zotit dhe më pas familja shkon në Peshkopi ku jeton për vite e vite me radhë. Qyteti i blirëve ku vazhdon edhe studimet në të gjitha ciklet ishte vendi më i bukur për Benin.

Dokumentari paraqet më pas gjimnazin e qytetit, njëri prej auditoreve më të mira në Shqipëri. “Pikërisht në këtë klasë dhe në këtë bankë ulej djaloshi simpatik që shndriste krahas shumë të tjerëve, duke fshehur si asi nën mëngë, aftësitë dhe idetë e tij, për të qenë njeriu i makinave. Më poshtë qendrës, ndodhet lagjia, ku jetonte Beni. Duke u rritur moshë, rritej edhe dëshira e tij, për të patur njeriun e ëndrrave e cila ishte një vajzë që përveçse bukurisë fizike, kishte edhe themelet e forta, ato të familjes Ndreu, që i përkiste sojtit të Elez Isufit. Te ai pallat dhe ato stola, fërshellimat e tij, do të linin pa gjumë Luljeten e cila u tundua shumë prej dashurisë së Benit. Vajza e Rexhep dhe Naxhije Ndreut, që vijonte studimet në univeristetin e Tiranës, do të pranonte të ishte nusja e tij dhe në vitet 88-89, vjen edhe kurorëzimi i të rinjve, me fejesën e tyre. Pas kaq vitesh, ajo kujton me nostalgji dhe mallëngjim njëherësh këtë njohje të parë...”.

Ndërsa në ekran jepen grimca nga jeta dhe vepra e Arben Zhuzhit, të cilën më shumë se kushdo po e lartëson sot familja e tij, bashkëshortja e nderuar Leta dhe fëmijët, qindra të afërmit dhe miqtë e shokët e tij derdhen lotë dhimbjeje. T’i imponon lotët kronika e asaj dite të zezë, që njoftonte një lajm të kobshëm. Është edhe ky dokumentar një rekuem për ish gardistin shembullor Arben Zhuzhi.

E pabesueshme, por ai që prej të gjithëve njihej si pilot, kish ndërruar jetë.

“Bashkëshortja, Leta e konsideronte një dhimbje të dyfishtë ikjen e tij, ndaj në këtë udhëtim në qytetin e Peshkopisë, ajo ndalesën e shpirtit e ka te varri i vjehrrit, Ganiut (ish oficer me emër e zë), bashkë me fëmijët e saj. Një lule, më shumë se një kujtesë, një respekt vlerash për të atin e shpirtit binjak të saj, Arbenit.

Në Peshkopi lindi Briselda, me 14 shtator të vitit 1991, gëzimi dhe hareja e parë e çiftit, që ndryshoi gjithçka në jetën e tyre. Ndërsa tre vjet më pas, me 4 qershor të vitit 1994, vjen në jetë vajza e dyte, Esmeralda. “Yjet e babit”, siç i quante Beni, ndrisnin shtëpinë dhe e mbushnin plot gezim.

Në vitin 1995, ai familjarisht la qytetin e Peshkopisë dhe erdhi të banonte në një pallat, në Laprakë në Tiranë. Këtu erdhën shumë gjëra të mira, por kryesorja, ishte lindja e djalit të vetem të tij, siç e quajti ai që nga dita e lindjes me 12 prill të vitit 2001, kampion. Ky ishte Arbëri, që pafundësisht e donte dhe çmendej pas tij...”.

Ndërsa dokumentari flet hollësisht për familjen e ish gardistit shembullor, bashkëqytetarët shprehin vlerësime maksimale për bashkëshorten Letën, dy vajzat Briselda e Esmeralda dhe për djalin, Arbërin, që lartësojnë aq shumë emrin e Arben Zhuzhit, duke e veshur me pavdekësi.

Arbeni ishte i miri i të gjithëve, gojëëmbël e hokatar. Humbja e tij, kalonte kufijtë e normales, për bashkshorten dhe tre yjet. Plagë në zemër është edhe për nënën e shtrenjtë të tij, që

e zeza nuk i ndahet, për motrën e dy vellezërit e tij, që e deshën aq shumë dhe nuk vinin askend mbi Benin.

Në Gardën e Republikes, në këtë institucion të mbrojtjes së vlerave institucionale dhe personaliteteve të shtetit, u personifikua personaliteti dhe vlera e Arben Zhuzhit. Që nga 1 maji i vitit 2001, në ditën e parë të punës e deri në ditën e ikjes nga kjo jetë, ai ishte shoferi dhe njeriu perfekt, që e deshën të gjithë. Siç shprehet Methasani, realizuesi i këtij dokumentari shumë origjinal, “ëndrra e tij, ishte të drejtonte mjetin e sigurisë së lartë të Presidentit të Republikes dhe këtë e bëri realitet”. Dy njerëz, kanë merita tek ëndrra e tij: Arben Çuko që firmosi futjen e tij në gardë dhe Artan Hoxha që mundësoi kalimin e tij, në grupin e shoqërimit të Presidentit Nishani, në shtator të vitit 2012.

Pas një rruge në Kosovë, ku la shume kujtime dhe mbresa, në nisjen e tij të dytë drejt Ohrit, vjen fati i zi, kur humbi jetën në një aksident në krye të detyrës, si drejtues i mjetit të Sigurisë së Presidentit të Republikës.


Arben Zhuzhi iu përket atyre njerëzve që falë sakrificës së tyre hyjnë në histori të veshur me pavdekësi. Së bashku me bashkëshorten e nderuar, Letën (edhe kjo intelektuale e mirëfilltë e përkushtuar ndaj vlerave të demokracisë) krijuan një familje dinjitoze, një vatër të ngrohtë, respekti dhe mikpritje. Ai ishte sintheza e cilësive fisnike. Gjatë gjithë jetës së tij, ka qenë njeri i thjeshtë, i ndershëm, i respektuar, gojëmbël, i papërtuar, njeri i mikpritjes, i dashur me të gjithë miqtë e bashkëpunëtorët. Si i tillë ai njihet nga të gjithë.



**PROF. DR. PETRIT BARA,
NDERI DHE KRENARIA E
DIBRËS DHE TETOVËS**

*(Intelektualë të njohur nga të gjitha trevat e
vendit nderojnë një nga personalitetët më në
zë të kardiologjisë shqiptare)*





“Vlerat njerëzore çmohen nga njerëzit e mençur”. Kjo sentencë, bashkëudhëtare e historisë së njerëzimit, gjen mishërim të plotë në vlerësimin që këshillat bashkiakë dhe komunalë të Peshkopisë, Bulqizës, Dibrës së Madhe dhe Tetovës i kanë bërë Prof. Dr. Petrit Barës, duke i dhënë titullin “Qytetar Nderi” të njësisë vendore respektive. Ky titull sinjifikativ është kurorëzuar në ceremoni mbresëlënëse të organizuara nga kryebashkiakët e Peshkopisë, Ilir Krosi, të Bulqizës, Roland Keta dhe i Dibrës së Madhe, Argëtim Fida, anëtarët e këshillit bashkiak, inlektualë dibranë të të gjitha trevave, (mes të cilëve edhe mjeshtri i madh Bujar Kapexhiu), të cilët kanë nderuar dekanin e Fakultetit të Infermierisë të UT, Petrit Bara, që demonstroi një model të ri sjelljeje dhe përkushtimi ndaj bashkëqytetarëve të vet.

Petrit Bara lindi më 11.01.1952 në Peshkopi. Përveç diplomimit si mjek në Universitetin e Tiranës më 1977, me rezultate të shkëlqyera, kreu specializimet jashtë shtetit për terapi intensive koronare dhe ekokardiografi në Turqi (Ankara), Trafik Hastanesi, 6 muaj (korrik – dhjetor 1992); emergjenca kardiovaskulare, terapi intensive, ekzaminime joinvazive (Holter, Ekokardiografi, Provë ushtrimore) në - Itali (Bari), Policlinico di Bari (Përgjegjës – Prof. Ritzon) 3 muaj (korrik

- tetor 2001) dhe sërish - Itali (Romë), Ospedale Sandro Pertini, shtator 2004.

Si njohës i tre gjuhëve të huaja (anglisht, gjermanisht dhe rusisht), Prof.Dr.Petrit Bara, do të udhëheqë ndër vite titujt e projekteve: Hipertensioni arterial dhe komplikacionet e tij – më 1998, si dhe Infarkti akut i miokardit dhe rehabilitimi i tij më 2001.

Ai njihet në rrethet akademike e shkencore si botues i disa teksteve me vlera të pallogaritshme shkencore, si: “Trajtimi farmakologjik i urgjencave kardiovaskulare”, “Sëmundjet e brendshme”, “Trajtimi i urgjencave hipertensive” (monografi), Statistika – tekst për shkollat e larta të infermierisë, Shëndeti Publik – Manual për shkollat e larta të Infermierisë, “Sëmundjet e brendshme”, “Fakulteti i Infermierisë dhe Fiziologjia patologjike.

Po ashtu Prof.Dr.Petrit Bara, si një nga personalitetët më në zë të kardiologjisë, njihet si kryeredaktor i revistës “Infermiera dhe mjekësia bashkëkohore” dhe si pedagog pranë Fakultetit të Shkencave të Mjekësisë në Universitetin Shtetëror të Tetovës, që nga viti 2003 për lëndën e fizio-patologjisë. Në këtë profil punoi me devotshmëri e përkushtim si mjek kardiolog, shef i pavionit të kardiologjisë në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza” të Tiranës, si pedagog dhe dekan i Fakultetit të Infermierisë.

Personaliteti dhe karakteri i tij në asnjë rast nuk devijoi, por u shpalos dinjitoz për më shumë se dy dekada në funksion të zhvillimit dhe modernizimit të shkencave mjekësore. Ishte

nga të parët që i fali shpirtin dhe zemrën ëndrrës së dëshiruar në vite. Në këtë përditshmëri mbetet një nga figurat më interesante si përfaqësues i elitës intelektuale shqiptare.

Dhe jo vetëm kaq, si intelektual bashkëkohor, demokracinë e konsideronte sfidë ndaj sistemit që u shemb; sfidë në dinjitet, në vlerë, në përpjekje, në arritje. Thelbi i mendimit dhe veprimit të tij ishte vetëm konkurrenca në vlera. Ai besoi dhe dëshmoi se njeriun në jetë e mban vetëm dija. Një miqësi me dijen nuk ka moshë, por mbetet e përjetshme. I qetë, i pjekur, shumë i kulturuar, nuk pajtohej me asnjë devijim nga parimet e virtytshme dhe njerëzore, por mbante qëndrim. Shpërthyes dhe autoritar në ndëshkimin e tij individual, sepse përherë qëndronte në vendin e nderit, sinqeritetit dhe dinjitetit. Kuptohet, ai ishte individ dhe jo institucion, por idetë dhe praktika e tij mund t'i shërbenin shumë një institucioni, një misioni. Këto cilësi i manifestoi dukshëm si drejtues i disa bordeve në QSUT, Fakultetin e Mjekësisë dhe si dekan i Fakultetit të Infermierisë.

Këto merita të intelektualit, demokratit dhe kuadrit shembullor Petrit Bara i kanë evidentuar më së miri në fjalët përshëndetëse gjatë ceremonive të dhënies së titullit “Qytetar Nderi i Peshkopisë”, deputeti i rrethit të Dibrës, Sherefedin Shehu, kryebashkiaku i Peshkopisë Ilir Krosi si dhe nga moderatorit të ceremonive, gazetari i mirënjohur Defrim Methasani.

Fakulteti i Infermierisë të UT që Z.Barra e drejton në dy mandate është më i riu në korpusin e Universitetit të Tiranës, i cili i hapi auditorët e tij në vitin 2002. Në 6 degët e këtij fakulteti janë rreth 2500 studentë. Në shërbim të tyre është



një trupë pedagogjike me nivele të ndryshme kualifikimi prej 220 pedagogësh. Kërkesat bashkëkohore, Karta e Bolonjës etj, kërkonin që diplomat e nivelit bazë, Bachelor, apo studimet e avancuara master e doktoraturë të paraqiteshin nga një trupë e zgjedhur profesorësh. Kjo bëri që stafi pedagogjik të orientohej për të adaptuar përvoja nga kurrikulat e institucioneve universitare të vendeve të ndryshme europiane, si nga Gjermania, Zvicra, Belgjika, Italia etj.

Në këtë kuadër kanë një partneritet ndërkombëtar bashkëpunimin disavjeçar me partnerët nga Gjermania, duke siguruar edhe një marrëdhënie shumë të frytshme kooperimi me Universitetin Halle-Uittenberg-ut. Ky universitet me një histori më shumë se 5 shekujllore, është zgjedhur si model për disa nga nëndegët e infermierisë dhe shërbimeve sociale shëndetësore që ofrohen për komunitetin. Duke përballuar sfidat e Reformës Arsimore, në Fakultetin e Infermierisë, janë të ndjeshme

efektet e procesit të Bolonjës. Në këtë kuadër përmirësimi i kurrikulave dhe pasurimi i tyre me përvoja të reja, me arritjet më të fundit të shkencës e të teknologjisë mbetet nga detyrat parësore të stafit pedagogjik, i cili po i realizon ato dita-ditës.

Tashmë nën drejtimin me kompetencë e profesionalizëm të lartë nga Prof.Dr.Bara, fakulteti Infermierisë e ka formuar fizionominë e tij të plotë, solide, si një fakultet me struktura e synime të qarta për plotësimin e detyrave të sistemit të shëndetësisë me gjashtë lloj diplomash.

PETRIT BARA, “QYTETAR NDERI” EDHE I TETOVËS E DIBRËS SË MADHE

Në vitin 2011, në një atmosferë festive ku ishin të pranishëm shumë profesorë nga Maqedonia dhe Shqipëria, drejtorë të Ndërmarrjeve Publike, këshilltarë të kuvendit komunal të Tetovës, drejtorë të shkollave fillore dhe të mesme, nën patronatin e kryetarit të komunës së Tetovës, Prof. Dr. Sadi Bexheti, është shpallur Qytetar Nderi i Tetovës Prof. Dr. Petrit Bara, për kontributin e çmuar dhe fisnik në progresin e diturive shkencore në lëmin e mjekësisë.

Kryetari i komunës së Tetovës, Prof. Dr. Sadi Bexheti pasi përshëndeti të pranishmit u shpreh se themelet e vërteta të shëndetësisë shqiptare i kanë vënë profesionistët e vërtetë të kësaj fushe të cilët me punë, vendosmëri e përkushtim të madh kanë kapur ritmet e shëndetësisë bashkëkohore.

“E tillë është figura e Zotit Petrit Bara, i cili përkundër punës së tij të palodhshme në fushën e kardiologjisë, me përkushtim ka kryer misionin e shenjtë të arsimimit të gjeneratave të reja. Si Dekan i Fakultetit të Infermierisë në Universitetin e Tiranës, Zoti Bara ka dhënë kontributin e tij të çmuar për arsimimin e shumë gjeneratave, duke udhëhequr një numër të madh të diplomave universitare, master dhe diplomave të doktoraturës”, tha Bexheti.

Një vlerësim të tillë do të bënte për Prof.Dr.Petrit Bara edhe këshilli komunal i Dibrës së Madhe duke i dhënë atij titullin “Qytetar Nderi” të kësaj komune. Ish kreu i kësaj komune Argëtim Fida do të shprehej se “për shumë mjek të rinj nga vende të ndryshme, Petrit Bara ka kultivuar format më të reja të mjekësisë. “Për shumë gjenerata ai ka kultivuar frymën e zhvillimit dhe për shumë individë ai ka përcaktuar destinacionin e duhur. Duke i dhënë titullin “Qytetar Nderi të Dibrës së Madhe” kryekomunari Fida dha se Prof.Dr.Petrit Bara vlerësohet për kontributin e çmuar dhe fisnik në progresin e diturive shkencore në lëminë e mjekësisë”.

TITULLI “QYTETAR NDERI”, I PAKRAHASUESHËM ME ÇFARËDO NDERIMI TJETËR

Prof. Dr. Petrit Bara ndjehet tejet i nderuar si “Qytetar Nderi” i katër qyteteve të njohura në hapësirën mbarëshqiptare: Peshkopisë që është dhe vendlindja e tij, Bulqizës, Tetovës

dhe Dibrës së Madhe. Nderimin që i kanë bërë këshillat bashkiakë e komunalë të këtyre katër qyteteve e quan të pakrahasueshëm me çfarëdo nderimi tjetër. “Fjalët më mungojnë për të shprehur gjithë mirënjohjen time për këtë. Prej më shumë se një dekadë jeta ime u lidh fort me këto qytete, me universitetin e Tiranës e Tetovës, me formimin e edukimin, me spitalet e klinikat, me jetën e qytetarëve”, tha Bara.

Sipas tij, të jesh “Qytetar Nderi” i Peshkopisë, Bulqizës, Tetovës e Dibrës së Madhe do të thotë të dish të nderosh vlerat më të rëndësishme të këtyre qyteteve të bukur, të mbushur me shqiptari dhe me arsimdashje, të orientuar saktë drejt së resë dhe progresit.




**Ambra Meda,
vajza qe kerkon
ndihmen tone!**

AMBRA DO (N) TE JETOJË

*-Historia e vajzës 17 – vjeçare
që lufton me vdekjen-*





Ambra do(n) të jetojë. Ajo e do jetën... Këtë mesazh përcollën nga Dibra e Madhe, artistët më në zë të hapësirës mbarëshqiptare, në Koncertin Humanitar “Një Këngë , Një Jetë”, dedikuar Ambra Medës për shërimin e saj. Ishte vërtetë një natë e veçantë për artdashësit e dy Dibrave, por edhe për të tjerë nga Tirana e Kosova që mbushën kinoteatrin e Qendrës Kulturore të Dibrës së Madhe..Mesazhet e tyre kanë një emërues të përbashkët: “Ambra, shpirt i vogël! Mos u mërzit, ti nuk je vetëm. Në betejën tënde kundër metastazës në thellësinë e trupit tënd, është e gjithë Dibra, janë nënat dhe baballarët, djemtë dhe vajzat më të mira të këtij qyteti me tradita të lashta kulturore e patriotike, të cilët thonë me një zë: Ambra, ne jemi aty me ty, deri në fund, ndaj mos u dorëzo, por rend, lufto për jetën...”.

Ndërsa moderatori i këtij aktiviteti krejt të veçantë, Valmir Lleshi, përcjell ndjenjat e dhimbjes njerëzore për nxënësen e shkëlqyer të gjimnazit “Sami Frashëri”, (e cila në vigjilje te vitit të ri shkollor 2013 u gjend e prekur nga një sëmundje e rëndë), për këtë meteor që shndrrit me bukurinë e saj mahnitëse në monitorin e madh që zë fasadën e skenës gjigande të kinoteatrit të Dibrës së Madhe, qytetari i parë i saj, magjistër Rruzhd

Lata shpreh bindjen se Ambra do të jetë nesër më e mira lule që do shpërndajë ndjenjat e humanizmit.. Kryekomunari i Dibërës së Madhe, në fillim të fjalës së tij, qëllimisht do të perfrazonte të madhin Mit'hat Frashëri : “shqiptarë të vërtetë janë ata që u dhimbset çdo shqiptar, kudo që të jetë”. Kjo thënie proverbiale e shqiptarit të madh që e bazonte alternativën e tij, mbi humanizmin dhe rritjen e standardeve të jetesës, mendoj se është në koherencë të plotë me alternativën e liderëve të mazhorancës së re qeverisëse që pretendojnë një rilindje të dytë të Shqipërisë dhe të shqiptarëve. E nëse mendojnë e punojnë vërtetë për këtë, apeli i mijëra humanistëve për kryeministrin Edi Rama, dhe ministrat Beqaj e Veliaj është që të demonstrojnë dhe ata humanizmin e tyre për vazhdimësinë e jetës së një 17 vjeçareje. Është koha që ata ta vazhdojnë “rilindjen” pikërisht me rilindjen e Ambrës, duke financuar shumë që duhet për operimin dhe kimioterapinë e saj.... Kjo sepse Ambra do (n) të jetojë....Pikërisht për këtë, mirënjohja e parë e protagonistëve të koncertit humanitar “Një këngë për një jetë” u shkon kampionëve të botës në Tai e Kik Boks, vëllezërve Ismail e Xhetan Keta. Jo vetëm pse financuan shumë e parë për shtrimin e Ambrës në një nga spitalet më të mira në Mynih të Gjermanisë, por edhe për kujdesin e çdoçastshëm që ata treguan pranë shtratit të saj...

Ndërsa evidentohet ky humanizëm i pashpoq, vëllai i tyre më i vogël, Ajeti, që ndjek i përplotur koncertin humanitar këtu në Dibër të Madhe thotë se Ambra është tashmë pjesë vitale e familjes Keta. Ky mision fisnik, jo vetëm i vëllezërve Keta, por

edhe i mikut të tyre Valon Markja, sponsor dhe organizator i Koncertit humanitar “Një këngë për një jetë” për të ndihmuar Ambra Medën tregon parasëgjithash njerëzillëkun e tyre.

Edhe zërat melodiozë të më të vegjëlve: Bena Kërluku, Agon Cice, Bora Tomini, Klea Cutra e të “Mega Band Group” janë lutje për vazhdimësinë e jetës së Ambrës.

Në këtë aksion humanitar s’kish si të mungonte artistja e merituar Liri Rasha, që së bashku me të bijën, Ingritin, “push-tuan” zemrat e ardashësve të shumtë që iu lutën Zotit t’i zgjasë jetën Ambrës. Sa e madhe zemra e një nëne si Liri Rasha! Ajo i këndoi si asnjëherë tjetër zgjatjes së jetës së Ambrës. Për këtë kumbuan edhe këngët e interpretuara mjeshtërisht nga Dritan Jashari, Hysi Hasani, Fitore Berisha, Evzi Kaja (Xiu), Argjend Marku, Lundrim Paçuku, Daja Do dhe shumë të tjerë, këngëtarë nga Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia.

Sëmundja e rëndë që ka prekur Ambra Medën, 17-vjeçar-en që në vend që të ulej në bankat e gjimnazit “Sami Frashëri” në Tiranë, ishte e detyruar të qëndronte e shtrirë në një shtrat të spitalit të Mynih në Gjermani, ku po vendosej fati i saj me jetën, na mblodhi të gjithëve së bashku për tu bërë pjesë e kurimit të saj. Historia e saj nuk është si gjithë të tjerat. Sëmundja e saj, tepër e rrallë e ka detyruar atë që prej disa muajsh t’i nënshtrohet kujdesit të rreptë të mjekëve të huaj.

Ambra vuan nga një diagnozë që prek 130 njerëz në të gjithë botën. E gjithë kjo ndodhi vetëm pak kohë përpara se të fillonte shkolla, kur Ambra po bënte përgatitjet e fundit për t’u ulur në bankat e gjimnazit “Sami Frashëri” në kryeqytet. Me

sëmundjen që kishte, Ambrës i dhanë mundësi shpëtimi, por me një kosto shumë të lartë, të papërballeshme për familjen e saj. Shuma që i kërkuan për kurim kalonte shifrën e 180 mijë eurove.

Për të kontribuar sadopak në garantimin e kësaj shume, Qendra Kulturore e Dibrës së Madhe, në bashkëpunim me Studio “Magnum” organizuan Koncertin Humanitar “Një Këngë , Një Jetë”, dedikuar Ambra Medës për shërimin e saj. Dhe vërtetë jehona e këtij koncerti u ndje jo vetëm te dibranët e Dibrës së Madhe që hapën zemrën e tyre të madhe për Ambrën 17 vjeçare, por gjer larg të shqiptarët e dasporës tonë në SHBA. I ndodhur rastësisht në qytetin e tij të lindjes, Ylber Pilku, i njohur për kontributin në ndihmë të bashkëatdhetarëve tanë që punojnë e jetojnë në Nju Jork, edhe në këtë rast demonstroi dukshëm humanizmin e tij. Të njejtën ndjenjë humanizmi demonstroi edhe pronari i Llixhave Mexhit Capa, bashkëatdhetari ynë nga SHBA, Ibrahim Kolari, si edhe djemtë e mirë te Dibrës, Valon Marke, Evzi Kaja (Xiu), Bajram Klllobçishta, Valmir Lleshi, Dritan Lleshi, të ndjekur në të njejtën linjë edhe nga Ajet e Ferit Keta, Fehmi Lleshi, Bujar Karoshi, Hysen Uka, Agron Hoti, Artur Kurti, si dhe vëllezërit Bujar e Flamur Makishti, që kishin ardhur nga Tirana, së bashku me pjesëtarë të familjeve të tyre, për t’u bashkuar këtij aksioni humanitar.

Ambra do(n) të jetojë. Mirënjohje dhe falenderime të përzemërta për kontributorët në funksion të zgjatjes së jetës së saj, në emër të familjes, u shprehën përzemërisht nga daja i saj, kolegu ynë i talentuar Defrim Methasani. Edhe ato “Medalje


Mirënjohjeje” për kryekomunarin e Dibrës së Madhe Rruzhdi Lata, Milaim Krasniqin nga Prishtina, gazetari dhe komentatori i mirënjohur në Kosovë, bashkë me bashkshorten, këngëtares po kaq të njohur Fitore Berisha, artistin e skenës dhe shpirtit human, Hysi Hasani, po nga Prishtina, si dhe për të gjitha organizatorët e protagonistët e këtij koncerti humanitar kanë efektin e tyre për të rritur ndjenjën e humanizmit ndër shqiptarët e ndershëm kudo që ndodhen.

Cdo kush, me aq sa ka mundësi duhet t’i bashkohet këngëtares me zemër të madhe Aurela Gaçe e cila, ashtu si edhe Liri Rasha, Dritan Jashari, e të tjerët në kinoteatrin e Dibrës së Madhe, ka derdhur në “Calvin” në Tiranë, gjithë arsenalin e saj, duke kënduar live plot dhimbje dhe shpresë, për një vajzë shqiptare, që quhet Ambra Meda. Ajo tashmë është nënë dhe e kupton rolin e saj dhe dhimbjen për një fëmijë. Ndaj dhe e meriton mirënjohjen kjo labe me shpirt dhe zemër të madhe, ashtu si edhe Perlat Musta, një emër legjendë i portës së “Partizani”-t dhe ekipit tonë kombëtar, që bëri një gjest tejet njerëzor, duke ndihmuar Ambrën. Mirënjohje kollosit të futbollit, vlonjatit që ndjehet më i lehtësuar se kurrë, pasi ka dhënë shpirtin e tij, si shumë sportistë dhe artistë të tjerë, për këtë vajzë që lufton me vdekjen në kërkim të jetës së saj.. Ambra Meda do të jetojë....Ajo ka mbështetjen e gjithë shqiptarëve që e duan jetën.



KIMIOTERAPIA "AMBRA"





Shteti gjerman mori përsipër subvencionimin e shumës që duhej për kimioterapinë dhe operacionin e 17-vjeçares Ambra Meda. Ishte një lajm mjaftë i gëzueshem ky, për gjithë shqiptarët që për më shumë se një muaj u përfshinë në aksionin humanitar në ndihmë të vazhdimësisë së jetës së Ambrës.

Sëmundja e rëndë që preku Ambra Medën, 17-vjeçaren që në vend që të ulej në bankat e gjimnazit “Sami Frashëri” në Tiranë ishte e detyruar të qëndronte e shtrirë në një shtrat të spitalit të Mynihut në Gjermani, ku po vendosej fati i saj me jetën, ishte shqetësim i dhjetra mijëra shqiptarëve të ndershëm e me shpirt human për t’u bërë pjesë e kurimit të saj. Kjo për faktin se historia e Ambrës nuk është si gjithë të tjerat. Sëmundja e saj tepër e rrallë e ka detyruar atë që prej disa muajsh t’i nënshtrohet kujdesit të rreptë të mjekëve të huaj.

Ambra vuan nga një diagnozë që prek 130 njerëz në të gjithë botën. Pikërisht pse është një rast specifik, spitali ku ajo po kurohet në Mynih e ka cilësuar kimioterapinë që i është nënshtruar ajo me emërtimin sinjifikativ “Kimioterapia Ambra”. Sëmundja e saj e rëndë u zbulua vetëm pak kohë përpara se të fillonte shkolla,(shtator 2013) kur Ambra po bënte përgatitjet e fundit për t’u ulur në bankat e gjimnazit “Sami



Frashëri” në kryeqytet. Me sëmundjen që kishte, Ambrës i dhanë mundësi shpëtimi, por me një kosto shumë të lartë, që ishte disi e papërballueshme për familjen e saj. Shuma kërkohet për kurim kalon shifrën e 180 mijë eurove. Padyshim, kontributin më të madh për mbledhjen e kësaj shume e dhanë vëllezërit Ismail e Gjetan Keta, kampionët e njohur të botës në Kik dhe Taibok. Ndërkohë, lajmin e gëzueshëm që mori nga Mynihu, pikërisht në ditën e një udhëtimi mirnjohjeje në Shkodër, e shpërndau me shpejtësi kolegu ynë shembullor Defrim Methasani, një intelektual i shquar me dhunti te rralla. Ai shkruan në statusin e tij në facebook se “Zyrtarisht shteti gjerman, pasi pa sensibilizimin e shqiptarëve, mediave dhe solidaritetin e një kombi për një vajzë të tyre, vendosi që pjesën tjetër të shpezimeve për kurimin dhe operacionin e saj, ti mbulojnë ata. Një lajm i jashtzakonshëm, që natyrisht gëzon



jo vetëm familjen, të afërmit, por të gjithë shqiptarët që dhanë shpirtin, lutjet dhe xhepin e tyre, për jetën e Ambrës. Mirënjohje pa kufi për të gjithë ju, njerëz, të njohur dhe të panjohur brenda dhe jashtë Shqipërisë. Mirënjohje vëllezërve Keta dhe të gjithë atyre që u bënë pjesë e problemit tonë të madh me Ambrën. Mirënjohje shtetit gjerman, që ndihmon një jetë të një vajze shqiptare. Qofshi të nderuar dhe vlerësuar gjithë jetën tuaj!...” . Mirënjohje e veçantë pa dyshim i takon kampionit botëror Gjetan Keta, boksierit shqiptar që ka fituar sfidën e së shtunës 12 tetor 2013, në mbrëmje me gjashtë runde ndaj gjermanit, Florian Uildenhof, me vendim unanim të arbitrave - një fitore kjo që iu dedikua totalisht Ambra Medes, duke i kaluar të gjitha të ardhurat e fituara nga kjo ndeshje për shërimin e saj. Kjo edhe për faktin se vëllezërit Ismail e Gjetan Keta i paraprinë “Kimioterapisë Ambra”, jo vetëm me kontributin vetjak në të holla e duke i qëndruar pranë në spital, por edhe




duke bindur autoritetet gjermane që të ta trajtonin atë si rast të veçantë. Dhe vërtetë, siç shprehet D.Methasani “Tashmë ajo që është në dorë të njeriut po bëhet, ndërsa lutim Zotin të na e dhurojë këtë engjell, që mezi pret rikthimin e saj në atdhe, familje, shkollë dhe shoqëri... Ky është vërtetë një lajm shumë i gëzueshëm për gjithë shqiptarët. Gjermania, aleati ynë strategjik që ka mbështetur në vijimësi zhvillimin ekonomik dhe progresin e Shqipërisë, bëhet shembull edhe në rastin e shërimit të 17-vjeçares Ambra Meda nga Shqipëria. Padyshim, këtu kanë meritën e tyre të padiskutueshme vëllezërit Ismail e Gjetan Keta, por dhe shqiptari me zemër të madhe Valon Marke, që në një shtet të fuqishëm si Gjermania ku ushtrojnë aktivitetin e tyre si kampionë të botës, bëhen zëdhënësit më të mirë të shpëtimit të një jete. Mirënjohje për jetë të gjithë atyre që kontribuan për Ambrën e të gjithëve. Familjet Meda e Methasani organizuan dhjetra ceremoni ku u dhanë medalje




“mirënjohjeje” atyre që kotribuan për Ambrën. Një medalje të tillë ata ia dhanë edhe stafit të gazetave “Metropol” e “Republika” te cilat u bënë propomotore të aksionit humanitar në ndihmë të vazhdimësisë së jetës së Ambrës dhe për sensibilizimin e opinionit rreth sëmundjes së rëndë që ka prekur këtë engjell. Familjet Meda dhe Methasani (dajat e Ambrës), por dhe gjithë miqtë dhe të afërmit, kontributorët e shumë nga hapësira mbarëshqiptare (në Shqipëri, SHBA, Maqedoni, Kosovë, Gjermani, Angli, Greqi etj) i shprehin mirënjohje të thellë stafit të “METROPOL” që për më shumë se një muaj mbajti të hapura faqet e saj për Ambrën e të gjithëve.

Shërim sa më të shpejtë kësaj vajze me zemër të madhe që i duhet Familjes, të afërmeve, shoqërisë dhe kombit tonë vital, në embrionin e të cilit qendron jeta e çdo shqiptari...



**XHEMAL BERISHA,
DISHEPULL I DIJES, SIMBOL
I URTËSISË DIBRANE**





Xhemal Berisha njihet si një nga korifejtë e vërtetë të kulturës dhe arsimit kombëtar në Dibër. Personaliteti i tij, kudo dhe në çdo rrethanë reflektonte vlera, për të cilat ishte e etur shoqëria jonë. Qe një njeri me nivel të lartë në të gjitha dijet, një filozof dhe psikolog, mësues dhe edukator shembullor, që, gjithkujt i duhet në ditë të vështira

Xhemal Berisha, njëri nga veteranët më të vjetër të kulturës dhe arsimit kombëtar, u nda nga jeta me 15 nëntor 2012, në moshën 84-vjeçare.

Tregimi i plotë për Xhemal Berishën nuk ezaurohet, ndoshta, as dhe me një monografi të tërë, ndërsa në këtë libër po bëj vetëm një paraqitje të shkurtër, për të krijuar një përshkrim rreth tij tek të gjithë ata që nuk e kanë njohur nga afër.

Megjithëse jetim, për nënë, qysh në moshën foshnjore, me gjithë vështirësitë e panumërta ekonomike të familjes, tek ai spikati që në fëmijëri zelli dhe vullneti i madh për shkollën, për librat dhe dituritë.

Shokët e tij të shkollës së fillores, (në Thanxë, Fushë – Muhurr) e tregojnë atë si një fenomen, që i kalonte shkëlqyeshëm dy klasa ose, më saktë, dy vite për një vit, (atëhere lejohej). Si kreu klasat më të larta, ai vazhdon të mesmen pedagogjike,



Normalen e Elbasanit, të cilën e përfundon shkëlqyeshem, me të gjitha pesa, sepse pesa ishte nota maksimale.

Pas disa roleve të ndryshme si nëpunës, vrik dolën dukshëm në pah tek ai, aftësitë drejtuese në fushën e kulturës dhe të arsimit.

Në vitet pesëdhjetë Xhemal Berishën e shohim si drejtorin e parë të shtëpisë së kulturës “Haki Stermilli” në qytetin e Peshkopisë për qarkun Dibër e Mat.

Në vitin 1957 mbaron shkëlqyeshëm shkollën e lartë ushtarake, të Bashkuar në Tiranë, ku ish i vetmi kursant që u diplomua “nëntoger”, kur gjithë të tjerët diplomoheshin si aspirantë. Edhe këtë, përveç diplomës e dëshmojnë dhe sot e kësaj dite ish-bashkëstudentë, bashkëfshatarë të tij, si Rushit Çiku, e tjerë. Por Xhemal Berishës iu desh të ankohej deri te ministri i mbrojtjes për ta braktisur ushtrinë dhe për t’iu vënë seriozisht studimeve të tjera. Kështu, në vitin 1959 Xhemal Berisha vazhdon studimet filologjike në degën e historisë në Universitetin Shtetëror të Tiranës.

Në vitin 1963 përfundon studimet me rezultatet maksimale, shkëlqyeshëm, ku në librezën e tij të notave, gjithkush mund të shohësh edhe sot, se nuk figuron as edhe një notë më poshtë, përveçse të gjitha notave maksimale.

Rrallë dëgjojmë për ndonjë intelektual të njohur se ka mbaruar me të gjitha notat maksimale dhe nuk e vemë aspak në dyshim, por të jemi të sinqertë, me të degjuara i kemi, ndërsa për njeriun në fjalë, për të gjitha rezultatet e tij dhe në të gjitha shkollat, për aq sa thamë më lart, ne jemi dëshmitarë dhe flasim me përgjegjësi, sepse të gjitha dokumentet e tij ne i kemi parë me sytë tanë, madje jo vetëm një herë.

Me të mbaruar Universitetin, shkolla dhe institucione të tjera në kryeqytet i ofruan menjëhere vende pune, por as ai vetë dhe as rrethi, nuk pranuan.

Në Dibër emërohet kryeinspektor i arsimit dhe kulturës, ku u shqua për një punë model, për një figurë dhe sjellje shembullore. Mirëpo më të aftët, pothuajse si kudo në botë, bëjnë shpejt reaksion tek karrieristët dhe ziliçarët, dhe Xhemal Berisha me iniciativën e tij, ndonëse i zhgënjyer, e braktis atë detyrë, në mes të qytetit të bukur të Peshkopisë dhe, përgjithmonshëm, i drejtohet fshatit.

Ai shkon si drejtor shkolle në një nga zonat më të vështira, por, njëherësh, më kulturëdashëse dhe më prestigjoze, në Fushë-Çidhën, ku ishte edhe dhëndërr. Pastaj e shohim si drejtor shkolle në Vakuf, në trevën e Kastriotit, më pas sërish si drejtor i shkollës së parë të mesme në vendlindjen e tij, në Fushë-Muhurr dhe më pastaj, megjithëse në prag të moshës së

pensionit, ai, çuditërisht, me dëshirën e tij, ngjitet dhe punon si drejtor i shkollës në zonën më malore, në Hurdhë-Muhurr, ku dhe e mbyll karrierën e tij të gjatë 45-vjeçare në arsim, duke dalë në pension faqebardhë e suksesiv si rrallëkush më parë!

PERSONALITETI I TIJ, KUDO DHE NË ÇDO RRETHANË REFLEKTONTE VLERA

Intelektualë më në zë, jo vetëm të Dibrës por nga i gjithë vendi e vlerësojnë Xhemal Berishën si një dishepull të dijes dhe simbol të filozofisë dibrane. “ ...Për Xhemal Berishën jemi krenarë edhe ne që nuk patëm fatin të punojmë me të”, -shprehet Gezim Alpion, pedagog ne Universitetin e Bermingamit, Angli. Ndërsa publicisti i njohur Abdurrahim Ashiku vlerëson se “Xhemal Berisha ishte dhe një studiues i zoti. Sa e sa herë ka kumtuar në sesione shkencore ...! Motra e tij, Sania, ishte njëra nga pesë vajzat e para, që theu akullin e zi shekullor për gratë dhe vajzat dhe mbaroi pedagogjiken e Peshkopisë ne vitin 1959. Xhemali ishte një njeri shumë më i përparuar se koha që jetoi.”. Murat Koltraka thotë se “ Prej tij mësonin shumë të gjithë, jo vetem nxënësit dhe ne, kolegët e tij, që patëm fatin të punonim me të! Burra të tillë kanë pse me lindur. Vepra e tyre nuk vdes kurrë.”. Për Z.Fadil Meha, një tjetër publicist i njohur dibran “Xhemal Berisha ka qenë burrë burrash. Ai ka shfaqur gjithmonë vlera të mëdha intelektuale...”. Vlerësime vijnë dhe nga ish nxënësit e tij. Kështu Shemsi Prençi shprehet se “...



Mësuesi ynë i dashur, do mbetet për të gjithë brezat model i ndershmerisë dhe përkushtimit ...” Ndërsa Agim Deva vlerëson se “Xhemal Berisha, ky kolos i arsimit në Dibër, ishte i pambërritshëm si për nivelin kulturor edhe për mirësjelljen dhe dhimbjen për njerëzit ...“ Ai ka qenë mësuesi ynë i madh i të gjithë neve që vijmë nga ajo anë ...”

Njëri nga bashkëkohësit e Xhemalit, Ramadan Ndreka thotë se fëmijët, nipat dhe mbesat e tij, me punën e tyre duhet të lartësojnë këtë burrë të lartë dibran ...”. Në vlerësimet e Haki Përnezhës “ Xhemal Berisha do mbahet mend për mprehtësinë e mendimit dhe forcën e argumentit. Ai erdhi ne Çidhën me vrull dhe iku plot lavdi dhe respekt ...”

Kujtimet më të mira për atë burrë të mençur, bujar, patriot dhe edukator shembullor ruan edhe personaliteti i shquar dibran Demir Osmani.

Ndërsa për Xhelil Cibakun “...Profesori ka qenë shembull i mësuesit, intelektualit dibran, njeri i thjeshtë, i ndershëm dhe shumë punëtor e i respektueshëm ...”. Dhe siç do të shprehej

Idriz Zogu, “njerëzit e mëdhenj si profesori ynë, ndërrojnë jetë në kohë dhe evenimente të jashtëzakonshme për t’u mbajtur mend gjatë në memorien e popullit ...”.

Xhemal Berisha, pishtar i rëndësishem i arsimit dhe kulturës dibrane dhe shqiptare, vlerësohet si tillë edhe nga Liri Beqja.

NJERI I VEÇANTË, ENERGJIK, NË SJELLJE E QËNDRIME

Ne, si gjithë brezat e rinj që ai mësoi dhe edukoi, ndihemi krenarë për të! Sepse në gjithë jetën tonë (si nxënës, studentë, mësues, e tjere) nuk kemi njohur një mësimdhënës kaq të talentuar si ai, një intelektual kaq të formuar si ai, një njeri si ai, me një vullnet dhe një sistematikë shembullore në studime dhe lexime librash të ndryshëm dhe, sidomos, artistikë! Ai në gjithë jetën e tij të gjatë, ishte një njeri mjaft serioz, shumë i dashur dhe me një humor, gjithmonë të shëndetshem. Ishte një njeri i veçantë, energjik, në sjellje e qëndrime, me një mënyrë të foluri karakteristike, që të mbushte mendjen për çdo gjë që mund të fliste. Aq e admiruar gjuha dhe mënyra e tij e gjestikulacioneve, nga miqtë, kolegët, madje dhe nxënësit e tij, sa të gjithë rrekeshin ta imitonin, të merrnin sa më shumë prej tij, për të përmirësuar stilin e tyre të të folurit, të punës dhe sjelljes në jetë. Për me tej, Xhemal Berisha asnjehere nuk qe egoist, karrist dhe autokrat, por një njeri tepër bujar, i thjeshtë si buka

që ndante përnatë e përditë me miq nga më të ndryshmit në tryezën e vatrës së tij familjare. Që një ndihmëtar i pakursyer për të përcjellë nëpër shkolla dhe universitete të vendit, dhjetra e dhjetra djem dhe vajza të popullit, kudo ku ai punoi dhe drejtoi. Ngado, ai i kish dyert e shtëpive të njerëzve të thjeshtë të hapura, sepse kishte të hapura zemrat e tyre. Ngado që të hedhësh këmbën nëpër viset ku punoi, ti do të shikosh se njerëzit që e njohën, qesin vetëm mjaltë nga goja për Xhemal Berishën! Dhe, më në fund, gjatë gjithë jetës së tij, Xhemal Berisha ishte armiku më i egër i servilizmit dhe hipokrizisë. Askush nuk mund të përballej me të, sepse ai “të rrëzonte” menjëhere me gjuhën e gjakftohtësisë dhe argumentit të pakundërshtueshëm.

Duke ndarë dhimbjen për humbjen e këtij korifeu të vërtetë të arsimit dhe kulturës kombëtare në Dibër dhe më gjerë, me të gjithë ju, miqtë tanë të mirë, jemi të sigurt se jo vetëm Muhurri, por gjithë treva e Dibrës, me humbjen e Xhemal Berishës, ka humbur njërin nga njerëzit më të ditur dhe me të zotë dhe se fisi i Berishve të Dibrës, për shumë e shumë kohë, ndoshta, do të ndihet i paplotë!


Ju falemnderit, mësuesi ynë i paharrueshëm, Xhemal Berisha, për gjithçka që bëre për arsimin dhe kulturën, për brezin e ri në Muhurr, në Diber e më gjerë!

U prehte në paqe shpirti yt bujar!



**GANGRENA E TEKSTEVE
SHKOLLORE DHE INJORIMI I
PALËS GREKE**





Funksioni i arsimit dhe roli i shkollave në Greqi ishte me rëndësi të dorës së parë në helenizimin e rajoneve që flisnin ndryshe. Nga hulumtimet që janë kryer në arkivat greke nga studiues të huaj ka rënë në sy një nga preokupimet më të mëdha të shtetit grek: sistemi arsimor ka synuar t'i shërbejë një qëllimi nacionalist, ka qenë institucioni lokal i konvertimit në homogjenë helenë.

NDËRHYRJE ABSURDE

Dy deputetë të parlamentit grek kërkuan interpelancë me ministrat vendas të Arsimit dhe të Punëve të Jashtme, lidhur me tekstet shkollore shqiptare, që sipas tyre, “përmbajnë pretendime irredentiste dhe të pavërteta për gjoja treva shqiptare që gjenden në Greqi”. Kërksat për interpelancë u depozituan veçmas nga deputetja e Demokracisë së Re të kryeministrit Samaras, Tania Lakovidou dhe nga deputeti opozitar i Grekëve të Pavarur (ANEL), Terens Kuik. Të dy deputetët kërkuan që ministrat t'i informojnë nëse do të ndërmarrin “veprime konkrete dhe eficiente”, me qëllim që Shqipëria të heqë gjithë referimet irredentiste, direkte dhe indirekte nga tekstet

shkollore. Duket qartë se pala greke po ushtron presion duke ndërhyrë në punët e brendshme të shtetit shqiptar. Nuk është rasti i parë që pala greke injoron Traktatin e Bashkëpunimit dhe Fqinjësisë së Mirë dhe kërkon të injorojë pavarësinë e shtetit shqiptar. Por të habit gatishmëria e palës shqiptare dhe zelli i titullares sonë të arsimit për t’iu përgjigjur pretendimeve absurde greke.

PSE HESHT AKADEMIJA?

Ministrja e Arsimit, Lindita Nikolla ka bërë të ditur se çdo rishikim i teksteve do të bëhet për të respektuar fqinjësinë mes dy kombeve. Nikolla ka konfirmuar ngritjen e një komisioni për rishikimin e teksteve me Greqinë dhe takimet dypalëshe për këtë qëllim. “Grupet e punës do punojnë për të bërë të mundur që tekstet e shkollave të respektojnë fqinjësinë e mirë”, – tha ajo ndërsa shtoi se pritet të zhvillohen edhe takime mes palës shqiptare dhe autoriteteve greke, lidhur me këto tekste shkollore.

Disa muaj më parë, (2014) ministrja Nikolla ishte në Athinë me ftesë të ministrit grek të Arsimit, Kostantinos Arvanitopoulos, ku diskutuan mbi rritjen dhe konsolidimin e marrëdhënieve dypalëshe në fushën e arsimit dhe kërkimit shkencor të dy vendeve. Pikërisht në këtë takim Nikolla bëri të ditur vendimin për ngritjen e grupeve të përbashkëta të ekspertëve për rishikimin e teksteve. Nënshkrimin e marrëveshjes për këtë çështje, ministrja shqiptare e cilësoi të rëndësishme për

hapjen e rrugës për mundësitë e mëtejshme të bashkëpunimit për ekspertizë profesionale edhe për gjithë reformën e arsimit të lartë dhe shkencës në Shqipëri. Ndërsa homologu i saj grek në atë kohë e cilësoi këtë marrëveshje dhe rinisjen e punës për çështjen e hartimit të teksteve si “një vizion i përbashkët drejt së ardhmes”.

Pra sinjalet janë të qarta: tekstet shkollore të gjeografisë dhe historisë që kanë të bëjnë me Greqinë, pritet të pësojnë ndryshime në përdorimin e terminologjisë dhe komenteve, kryesisht për çështjen e Çamërisë, por edhe të krahinave të tjera shqiptare. Ku është Akademia e Shkencave? Përse duhet heshtur për një skandal të tillë?

S’KA FQINJËSI TË MIRË PA RECIPROCITET

Ministria e Arsimit të Republikës së Shqipërisë, përballë presionit të disa deputetve grek antishqipëtar, duhet të respektojë Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe të mbrojë interesat e shqiptarëve. Me gjithë respektin ndaj gjithë fqinjëve, ashtu edhe ndaj grekëve, të cilët dikur ishin shembull i shkencës, kulturës e letërsisë njerëzore, në marrëdhëniet ndërqeveritare dhe ato diplomatike respektohet në radhë të parë parimi i reciprocitetit, që buron nga e vërteta historike dhe jo fqinjësia e mirë. Fqinjësia e mirë, pa respektim të reciprocitetit, është thjesht propagandë boshe që e përdorte dikur edhe qeveria diktatoriale. Pala greke ka treguar në shumë raste fytyrën e

vërtetë të urrejtjes mesjetare ndaj shqiptarëve dhe historisë së tyre. Në tekstet tona respektohet e vërteta historike, të drejtat e patjetërsueshme të shqiptarëve si komb i ndarë padrejtësisht dhe copëtuar nga urrejtja e pakuptimtë. Hartuesit tanë të teksteve, që janë historianë të njohur dhe me integritet profesional e kombëtar janë kujdesur që fëmijët tanë kurrë nuk duhet të mësojnë urrejtjen, por të edukohen me të vërtetën dhe respektin për çdo popull, pra edhe popullin grek. Por ata duhet të dijnë kush ishte Çamëria, cila është historia e saj, cili ishte kontributi i prijësve dhe luftëtarëve të saj në luftën për pavarësi të Greqisë, pse u përzu me dhunë popullsia shqiptare e Çamërisë nga trojet e saj stërgjyshore dhe cila e drejtë ndërkombëtare pengon rikthimin në trojet autoktone, ku janë gjithë pasuritë dhe varret e të parëve së kësaj popullsie martire. Historia duhet të jetë e vërteta reale e pa ndryshuar dhe e pa tjetërsuar e së kaluarës njerëzore. Ndryshe nuk mund të kemi as marrëdhënie korrekte dhe as fqinjësi të mirë.

PSE INJOROHEN KONVENTAT?

Në kohën e sotme Greqia është shteti i vetëm në Evropë, që shkel në mënyrë flagrante disa nga konventat kryesore, mbi të cilat mbështetet rendi i ri ndërkombëtar. Këtë shkelje të përbindshme më shumë e ndien popullsia mbi 200.000-she shqiptare, e dëbuar me dhunë e genocid nga trojet e veta etnike në Çamëri. Greqia, përse u takon minoriteteve, asnjëherë nuk

ka zbatuar detyrimet që rrjedhin nga kartat, konventat, traktatet ndërkombëtare që ka firmosur e ratifikuar vetë në mardhëniet dy ose shumëpalëshe. Ajo është i vetmi vend i BE-së që nuk ka përafuar legjislacionin e vetë kombëtar me atë europian, deri tani nuk ka ratifikuar Konventën Kuadër për Mbrojtjen e Minoriteteve Kombëtare dhe as e ka firmosur Kartën për Gjuhët Rajonale ose të Minoriteteve. Karakterizimin më të saktë të sistemit ligjor grek e ka bërë gazeta “The Daily Telegraph” në dhjetor të vitit 2001: “Greqia është një partnere e jona brenda Komunitetit Europian, por sistemi i saj ligjor arkaik, i padrejtë, është si i Botës së Tretë. Është gjithashtu mizor”.

SHQIPËRIA SHTET MODERN EVROPIAN

Është detyrë e shtetit shqiptar, krahas punës me fqinjën jugore, të vërë në dijeni OKB-në dhe gjithë organizmat e interesuara evropiane dhe amerikanë, se si i zbaton Greqia konventat dhe kartat ndërkombëtare. A mund të quhet irredentizëm t’u shpjegosh nxënësve shqiptarë se shqiptarët autoktonë popullonin Konicën, Follorinën, Janinën, Gumenicën, Filatin e Paramithinë, ndërkohë që shteti grek dhe propaganda e shfrenuar vorioepirote në faqen e parë të abetares greke e kanë të shkruar me gërma të mëdha shprehjen “kam një vëlla në Vorioepir”! Shqipëria është shtet evropian që ka identitetin e saj, që aspiron të anëtarësohet së shpejti në Bashkimin Evropian! Shqipëria, me të drejtën e saj historike dhe njerëzore, me të drejtën

e saj kushtetuese, ka arsye që t'u kërkojë përmirësimin e teksteve shkollore, atyre shteteve ku kanë jetuar dhe banojnë ende shqiptarë, ku gjallon ende kontributi i shqiptarëve që nga periudhat më të lashta por edhe në kohët më të reja historike dhe kurresesi të bëhet e dëgjueshme ndaj kërkesave të njëanshme dhe absurde të shteteve që kanë okupuar ose ende mbajnë të okupuara territore shqiptare. Të pranosh kërkesat greke, maqedonase, serbe, malazeze apo turke për tekstet shkollore, do të thotë të arsyetosh dhe përligjësh çoptimin e trojeve shqiptare, okupimin pesëshekullor osman, të heqësh dorë nga një e drejtë ndërkombëtare.

Një popull që nuk mëson nga e kaluara e tij historike është i destinuar të humbasë shansin e historisë. Historia shkruhet në bazë fakteve, të ngjarjeve e datave historike dhe pikë.



**MOMENTE KTHESE DHE
REFLEKTIMI PËR ZHVILLIMIN
E ARSIMIT NË RAJONIN E
DIBRËS**



NGA HISTORIKU I SHKOLLËS SHQIPE TË MUHURRIT

Mësimi i gjuhës shqipe në zonën e Muhurrit filloi në vitin 1925 me hapjen e shkollës së parë, në shtëpinë e Destan Sinës, shtëpi e cila ekziston edhe sot e banueshme. Mësuesi i parë i kësaj shkolle ishte Edip Cami nga Dibra e Madhe. Nxënës kishte fare pak dhe vetem djem. Kjo ishte shkollë katër klasëshe verore dhe asnjë nuk mori dëftesë lirimi deri në vitin 1933. Pasi iku në vitin 1933 mësuesi Edip Cami, vjen mësuesi Selim Çishku nga Kruja, e më pas zëvendësohet nga mësuesi Asllan Zeneli nga Ternovai, i cili qëndroi deri në vitin 1937 e më pas u zëvendësua nga mësuesi Abaz Shehu nga Brezhdani.

Me 1936 shkolla u bë pese klasëshe.

Me 1938 morën dëftesë lirimi pesëklasëshe 14 nxënës, prej tyre edhe Imer Pira, Abaz Voka e Ram Poliçi.

Në fund të vitit 1938 vijnë arsimtarët Gafur Rada nga Golloborda e Tofik Balla nga Okshtuni, normalistë të zotë, ku mjerisht Tofiku është pushkatuar në vitin 1946 kur ishte

ispektor arsimi në Zerqan (arsyet nuk dihen). Tani shkolla ishte larguar nga shtëpia e Destan Sinës dhe ishte vendosur në kullën e Llan Farrukut. Por më 1936 u caktua Rrafshja e Thanxës mbi Berishe e Lale për ndërtime publike si qendër e komunës. Më parë u bë ndërtimi i lokalit të komunës bashkë me postën e xhandarmërisë, ndërsa në fundin perëndimor të Rrafshes së Thanxes filluan punimet për të ngritur një shkollë. Meqë shkolla nuk përfundoi në kohë, nxënësit u shpërngulën nga kulla e Llan Farrukut dhe bënë mësim një vit në një dhomë të komunës.

Me 1939 në shkollë regjistrohen edhe vajza dhe veçanërisht nga fisi Hoxhe. Numri i nxënësve sa vinte e shtohet dhe prandaj u shtua edhe numri i mësuesve, si Myslim Shehu nga Qaf Murra, Hysen Hoxha nga Elbasani dhe Sami Gangja familjarisht nga Dibra e Madhe. Në këtë kohë transferohet për në Kastriot mësuesi Hysen Hoxha dhe diku tjetër edhe mësuesi Gafurr Rada.

Në vitin 1941 vjen mësues edhe Ismail Lufta nga Elbasani që bashkë me Tofik Ballën ishin normalistë shumë të zotë.

Me 1938 u hap shkolla fillore edhe në Hurdh-Muhurr me kontributin e prijësit dhe filozofit të shquar popullor të kësaj treve, Dine Hoxha.

Me 1945 u hap shkolla në Fushë-Muhurr, me mësues Kurt Hoxha, ish-nxënës i gjimnazit të Gjirokastrës. Në vitin 1947 Kurt Hoxha u transferua në shkollën e Tërbaqit, Gollobordë dhe në Muhurr vjen mësuesi me moshë mbi pesëdhjetë vjeç, i lavdërueshmi Gani Keta, me të bijën 17-18-vjeçare, Lirijen e

lavdërueshme si i ati. Ishte nga Tirana.

Deri në vitin 1946 ka qenë sistemi i vleresimit me 4 nota, ku 1 ishte “shumë mirë”, 2-shi ishte “mirë”, 3 “mjaftueshëm” dhe 4 “pamjaftueshëm”.

Pas 1946 u zbatua sistemi i vlerësimit me 5 nota, ku 5 = “shumë mirë”, 4 = “mirë”, 3 = “mjaftueshëm”, 2 = “keq” dhe 1 = “shumë keq”.

Gjatë vitit shkollor 1950-1951 shkolla kaloi në lokalin e ri të ndërtuar me fondet e shtetit dhe kontributin e popullit në vendin ekzistues (pjesa e vjetër). Numri inxënësve në katër klasat arrinte deri në 60 vetë.

Në vitin shkollor 1954-1955 u hap klasa e pestë e shkollës 7-vjeçare me mësues Emin Jasharin.

Në vitin 1956 u ndërtua lokali i shkollës 7-vjeçare ngjitur me lokalin e vjetër në vendin ekzistues.

Drejtori i parë i shkollës 7-vjeçare në Muhurr ka qenë Aqif Doku nga Luznia dhe më vonë kanë qenë drejtues: Lutfi Manjani, Muhamet Xhembulla, Abdulla Hakorja, Shyqyri Zebi, Xhemal Berisha, Veli Rama, Baftjar Gazidede.

Me 20 nëntor 1975 në Muhurr u hap për herë të parë Shkolla e Mesme Bujqësore pa shkëputje nga puna dhe në vitin e parë filluan mësimin 84 nxënës, dhe drejtor ishte Xhemal Berisha. Në vitin shkollor 1981-’82, krahas shkollës së mesme bujqësore pa shkëputje nga puna, u hap po kjo shkollë me shkëputje nga puna, dhe në vitin e parë filluan mësimin 26 nxënës, ndër të cilët përmendim: Afrim Deva, Afrim Mikli, Avni Sina, Enver Lleshi, Fidaie Hoxha, Kumrie Hoxha,

Munire Farruku, Xhil Kulla, etj.

Në vitin 1985-1986 doli matura e parë e Shkollës së Mesme Bujqësore me shkeputje nga puna. Rritje pati numri i nxënësve, klasave dhe mësuesve, si në ciklin e ulët, të lartë dhe të mesme bujqësore me dhe pa shkeputje nga puna.

Në vitin 1978-1979 shkollës iu dha një ha tokë për bazë prodhuese, e cila shërbente për konkretizimin e mësimit dhe zhvillimin e punës prodhuese e praktikave profesionale.

Në vitin shkollor 1987-1988 u hap ne Muhurr edhe shkolla e mesme e përgjithshme me shkeputje nga puna, ku në vitin e parë filluan mësimin 40 nxënës dhe numri i përgjithshëm i nxënësve në arsimin e mesëm të përgjithshëm + bujqësor, me dhe pa shkeputje nga puna ishte 252.

...Gjithsesi, muhurrakët nuk kanë nguruar të ngrenë zërin për gjendjen e mjeruar të infrastrukturës arsimore në komunën e tyre. Kjo për faktin se në godinën e shkollës së mesme, si dhe me godinën e shkollës fillore e arsimin parashkollor që kanë dalë jashtë funksionit normal janë të detyruar të bëjnë mësim me turne dhe me orë të shkurtuara për mungesë energjie.

“Është e pa falshme për ne dhe brezat që do vijnë në qoftëse nuk do të ruajmë me krenari të gjithë punën e bërë në vite dhe punën që bëhet, për t’u lënë brezave atë ç’ka populli shqiptar dhe ne si zonë e kemi vuajtur, pra, “Historinë”, shprehet ish kryetari i Komunës së Muhurrit, Shkëlzen Qoka. Pasi ngre me kurajo shqetësimin e ligjshëm për mungesën e investimeve në shkolla ai pohon se, duke ditur se nga vjen dhe kush je është tepër e lehtë që të ecësh e përparosh në drejtimin e duhur.


“Mungesën, unë do ta konsideroja si një shtëpi e mbaruar deri në katin e parë, e ne të çoroditur, kërkojmë shesh për ndërtimin e shtëpisë, shprehet ish kreu i komunës. Gjithsesi ai u përcjell një përshëndetje të veçantë të gjithë fëmijëve të atyre mësuesve e mësueseve, të cilët në vite dhanë kontributin e tyre për arsimin në Muhurr dhe sot nuk jetojnë më, urimet më të sinqerta e lumturi për familjet e tyre.





MASIVIZIMI I SPORTIT, SI PRIORITET I MAS DHE KOKSH





Në çelje të Takimit të 11-të Mbarëkombëtar të Xhudos, me ekipe nga Kosova, Maqedonia e Mali i Zi, Ministrija e Arsimit dhe Sportit, Lindita Nikolli premtoi mbështetje maksimale për sportistët e të gjitha disiplinave. Një mirënjohje të veçantë ajo i adresoi kampiones së botës Majlinda Kelmendi, prania e së cilës ia shtoi përmasat këtij eventi kaq të rëndësishëm.

Këtë angazhim, ministrija Nikolli e ka shprehur paraprakisht kur sapo kishte marrë drejtimin e dikasterit shumë të rëndësishëm siç është MAS, gjatë ceremonisë të firmosjes të Statusit të Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar, ku u finalizua edhe një marrëveshje bashkëpunimi midis MAS-it dhe KOKSH-it, që shtrihet edhe më gjerë, në një bashkëpunim dypalësh afatgjatë.

Gjithsesi, vetë prezenca e kreut të MAS mes garuesve të Takimit të 11-të Mbarëkombëtar të Xhudos ishte sinjali më i mirë i përcaktimit të sportit në prioritetet e saj. Ndër të tjera Znj. Nikolli premtoi ngritjen e një strukture të sportit, që do të funksionojë sipas ligjeve dhe rregullave, siç edhe sporti funksionon sipas rregullave. Në kuadrin e projekteve të përbashkëta me KOKSH dhe federata të tjera sportive, Ministrija e Arsimit dhe Sportit i jep rëndësinë e duhur masivizimit të sportit

si domosdoshmëri e kohës. Nëse në sektorë të arsimit ajo ka iniciuar një reformë bazuar në kriterin e konkurrencës së nder-shme të vlerave, ka ardhur koha që në këtë mënyrë të puno-het edhe për reformimin e federatave sportive, për të realizuar një reformë ligjore pa ndërhyrë në rregullat e tyre statuuore. Kjo në funksion të rritjes së cilësisë, të vlerave por dhe të ma-sivizimit të sporteve. Në këtë kontekst, jashtë nostalgjisë për sistemin arsimor të së shkuarës moniste, do të ishte me vend të rishikohej futja e gjimnastikës së mëngjezit të programin e shkollave 9-vjeçare.

Parë nga një këndvështrim i përgjithshëm, ky angazhim i drejtpërdrejtë i ministres Nikolli në mbështetje të projekteve të federatave sportive është garanci se situata do të ndryshojë .

Dhe kjo mund të arrihet vetëm pasi të jetë bërë një radiografi e saktë për të përcaktuar se ku çalon sporti, çfarë është bërë dhe se çfarë duhet bërë në të ardhmen, duke nisur nga financimi, ligji për sportin, terrenet sportive, kohështrirja më e madhe e sportit në shkolla, afrimi i rinisë me sportin e mjaft të tjera.

Gjithsesi, marrëveshja midis MAS-it dhe KOKSH-it hapi një horizont të ri bashkëpunimi reciprok në fusha me interes kombëtar për zhvillimin e sportit dhe Lëvizjes Olimpikë në Shqipëri. Kjo është një marrëveshje që ka në thelb edukimin e fëmijëve dhe rinisë me edukatën sportive, për t'i afruar ata më shumë me terrenet sportive dhe për t'i pasur më të shëndetshëm.

Vendosja e sportit pranë arsimit është një mundësi e mirë,

madje e shkëlqyer për të rilindur, për të edukuar brezin e ri me frymën e respektit dhe bashkëpunimit.

Po në këtë optikë duhet parë edhe bashkëpunimi me Komitetin Olimpik të Kosovës, bashkëpunim ky që në rastin konkret mundësoi pjesëmarrjen e dhjetra ekponentëve nga e gjithë Kosova (madje dhe me gjerë nga hapësira mbarëshqiptare) e konkurentëve në garat që u zhvilluan në Pallatin e Sportit “Farie Hoti” në Tiranë, në kuadrin e Takimit të 11-të Mbarëkombëtar të Xhudos.

KOKSH ka finalizuar gjithashtu edhe një marrëveshje bashkëpunimi me Komitetin Olimpik të Kosovës, e cila edhe në këtë rast dëshmoi për shtimin e urave të bashkëpunimit mes dy anëve të kufirit. Treguesi më sinjifikativ për këtë ishte prania e kampiones së botës, Majlinda Këlmendi, në çelje të takimit të 11-të Mbarëkombëtar të Xhudos.


Kësisoj, bashkëpunimi institucional midis dy Komiteteve Olimpikë po shërben në krijimin e kushteve dhe ngritjen e kapaciteteve njerëzore përgjatë rrugës së procesit të njohjes së Kosovës nga Komiteti Olimpik Ndërkombëtar.

Gjithsesi, vetë rezultatet e kampiones, Këlmendi, duke pasur në konsideratë vështirësitë nëpër të cilat kalon shoqëria jonë, si dhe vetë aktiviteti sportiv i femrave dikton domosdoshmërinë e hartimit të politikave programore, me synim që të përkrahët dhe mbështetet zhvillimi i sportit të femrave. Kjo edhe për faktin se përvoja e deritanishme, veç të tjerash evidenton klube sportive dhe federata të sportit të cilat zhvillojnë aktivitete sportive, por vazhdimisht ballafaqohen me vështirësi

të natyrës materiale, edhe në rastet kur kemi të bëjmë me klube të suksesshme. Synimi i kësaj politike është sensibilizimi i opinionit për sportin, masivizimi, përkrahja dhe inkurajimi për përfshirjen e femrave në nivelin profesionist të menaxhimit, punë të drejtpërdrejta organizative dhe udhëheqëse në klube, federata, KOK dhe administrim të sportit.

Intensifikimi i bashkëpunimit mes MAS e KOKSH do të çojë në fuqizimin e kësaj politike, duke e inkorporuar në politikat tjera programore, sipas projekteve dhe prioriteteve. Prezenca në këtë takim mbarëkombëtar të Xhudos, por dhe rikonfirmimi i mbështetjes maksimale për sportisët nga krerët e MASH e KOKSH është parasëgjithash dëshmi e rëndësisë që ata i kushtojnë promovimit të sportit dhe vlerave të jashtëzakonshme që sporti ka për moralin dhe për shëndetin e shoqërisë.

Ndërkohë, në kuadrin e integritit europian e më gjerë, ekziston një lidhje e fortë ndërmjet sportit dhe agjendës së prioriteteve të qeverisë shqiptare. Kjo për faktin se Sporti mbledh së bashku përfaqësues të shteteve, besimeve, etnive e komuniteteve të ndryshme, nga ata më profesionistët tek njerëzit e thjeshtë. Angazhimi i qytetarëve në sporte, veçanërisht i brezit të ri, masivizimi i tij, krijimi i kushteve për sportin elitare konkurrues vjen veçanërisht nga niveli vendor, nga forcimi i partneritetit publik me atë privat për ngritjen e infrastrukturës sportive, vazhdon tek strukturat qeveritare, për të kaluar më pas në vendosjen e standardeve ndërkombëtare dhe krijimin e një platforme mbarëevropiane të bashkëpunimit.



Në kohën kur shkroi romanin me titullin sinjifikativ “Të gjithë lumenjtë rrjedhin”, shkrimtari i mirënjohur Teodor Laço as që e kishte çuar ndërmend tentativën e ndokujt për të ndryshuar dhunshëm rrjedhën e lumit Radika. Sot, ashtu si edhe pjesa më elitare e shoqërisë shqiptare, Laço i bashkohet protestës së banorëve të dy Dibrave dhe të shoqatave mjedisore kundër devijimit të Radikës në lumin Vardar.

Gjatë gjithë vitit 2014, protestues të shumtë, në Tiranë, në Dibër të Madhe, por edhe në Peshkopi, i kërkuan qeverisë shqiptare të mos pranojë projektin e qeverisë maqedonase për të ndryshuar rrjedhën e lumit Radika, pasi kjo ndërhyrje do të ishte me pasoja katastrofike për ekosistemin dhe burimet ujore të zonës. Protestuesit, në vijimësi i kanë bërë thirrje qeverisë të bëjë transparente marrveshjen për devijimin e lumit. Ata paralajmëruan se do ta përshkallëzojnë protestën e tyre në rast se dy qeveritë nuk do të marrin parasysh shqetësimin e banorëve të Peshkopisë dhe Dibrës së Madhe.

Në Tiranë, protestuesve iu bashkua edhe deputetja Mesila Doda. Dhe nëse ky zë i spikatur i politikës dhe publicistikë shqiptare iu është kundërvënë me kurajo qytetare si askush tjetër segmenteve të errëta matanë e brenda kufirit tonë



shtetëror, duke konfirmuar financimin nga Banka Botërore të studimit të fizibilitetit për projektin makabër të devijimit të Radikës, qeveritarë (shqiptarë, të Shkupit e Tiranës) vazhduan të spekulojnë e të manipulojnë opinionin, sikur s’po ndodh asgjë.

Edhe deputeti i Bulqizës dhe Dibrës Roland Keta e ka konsideruar të dënueshme heshtjen e qeverisë shqiptare për këtë shqetësim që është bërë tashmë shqetësim kombëtar sepse devijimi sjell dëme të pallogaritshme për territorin dhe jetën e më shumë se 20 mijë banorëve të Dibrës së Madhe. Gjithashtu, deputetja Jorida Tabaku ka publikuar detaje të projektit të Bankës Botërore, duke vënë në dukje se me një kërkim të thjeshtë mund të gesh që ekzistojnë dy projekte të tilla dhe për njërin prej tyre, Lukovo, kanë nisur dhe procedurat e tenderimit.

Duke iu bashkuar pjesës së elitës intelektuale shqiptare që ka reaguar kundër vendimit të pritshëm të qeverisë për devijimin e lumenjve në favor të projekteve energjetike të Maqedonisë, *profesori i mirënjohur Artan Fuga* ka protestuar përmes një komenti në profilin e tij në rrjetin social Facebook ku ka theksuar se: *“Për ujërat e lumenjve kombet hidhen në zjarr”*. Ai ka argumentuar se *“Nuk duhet të lejojë as Kuvendi, as qeveria, as shteti, as shoqatat joqeveritare, as bashkitë e pushtetit lokal, as qytetarët shqiptarë, as shqiptarët në zonat kufitare kudo janë, as diplomacia në shtetet fqinje, për çfarëdo nevojash a pretendimesh që të kenë të prekin ujra lumenjsh që në shtratin natyror e kanë kalimin ose derdhjen në territorin shqiptar”*.

Edhe grupet parlamentare të LSI e PDIU kërkuan me urgjencë interpelancë me Ministrin e Jashtëm, Ditmir Bushati.

Këtë reagim të ashpër e diktoi mospasja e asnjë sinjali të ndryshimit të qëndrimit nga autoritetet maqedonase lidhur me këtë çështje, si edhe mungesa e shpjegimeve dhe informacioneve nga qeveria shqiptare lidhur me ndjekjen që ajo i ka bërë problemit apo me planin që ajo ka për ta ndjekur çështjen deri në fund.

Nën tryshninë e peshës së revoltës qytetare, por dhe të zërave kritikë brenda legjislativit shqiptar, erdhi më në fund edhe reagimi i kreut të ekzekutivit shqiptar, si garanci se nuk do të lejohet që të preket interesi i Shqipërisë. Lidhur me mundësinë e devijimit të lumit Radika, projekt i cili nxiti edhe protesta qytetare në Tiranë dhe në Dibër, kryeministri Edi Rama u shpreh në një reagim në *Twitter*, se nuk ka projekt,



dhe s'ka gjasë që të ketë një fillim të këtij procesi në mënyrë të njëanshme.

Por, nëse për kryeministrin shqiptar lumi Radika është “shumë zhurmë për asgjë”, revolta qytetare për këtë çështje nuk ka gjasa të venitet, sa kohë nuk ka transparencë të plotë nga pala maqedonase. Tashmë që për opinionin e gjerë publik është zbardhur raporti sekret dhe janë bërë të ditura pasojat e realizimit të këtij projekti, dy qeveritë respektive, ajo shqiptare dhe ajo maqedonase duhet të dëgjojnë zërin e banorëve të Dibrës së Madhe dhe Dibrës së Vogël, të mbarë trevës historike shqiptare, që kërkon të ndalohet loja mbi devijimin e lumit Radika. Kjo për faktin se devijimi i këtij lumi do të sillte dëme të mëdha në ekosistem, do të dëmtonte rëndë ekonominë e shqiptarëve të krahinës historike të Dibrës dhe do të dobësonte edhe buri­met energjetike të Shqipërisë. Në asnjë këndvështrim, një akt

i tillë nuk është në dobi as të Shqipërisë, e as të shqiptarëve në trojet tona kombëtare. Për këtë opinioni publik është sensibilizuar më së miri nga gazeta rajonale “Rruga e Arbërit”, e cila në vijimësi ka dhënë një panoramë të çështjes dhe skenat dhe prapaskenat mes qeverisë së Maqedonisë dhe Shqipërisë.

Që nga mesi i vitit 2013 e në vazhdim, disa organizata joqeveritare në Dibër të Madhe kërkuan reagimin publik në lidhje me devijimin e ujërave. Qeveria maqedonase nuk jepte informacion lidhur me çështjen dhe po ashtu as kompania energjetike ELEM. Gjithashtu, edhe zyrtarët lokalë nuk kishin informacione mbi projektin. Këshilli i Komunës në Dibër të Madhe, në një mbledhje të saj gjatë muajit Gusht 2013 mori në analizë problemin dhe vendosi të marrë përgjegjësi lidhur me atë që po ndodhte. Duke parë se projekti nuk sjell të mira për Dibrën, pushteti vendor vendosi ti shfrytëzojë të gjitha mekanizmat ligjorë në mënyrë që qeveria maqedonase të heqë dorë nga grabitja e paligjshme e ujërave të Radikës. Për ndryshe dibranët do të jenë të detyruar ti drejtohen Gjykatës Ndërkombëtare në Strasburg. Kryetari i Komunës së Dibrës së Madhe, Rruzhdin Lata, ka bërë të ditur se në takimin me një grup prej 20 personash nga ELEM, Banka Botërore dhe një shoqatë ndërkombëtare ekologjike, mes të cilëve asnjë shqiptar, ka argumentuar se kjo sasi e ujit që do të devijohet për Vardar për prodhimin e energjisë elektrike, po përdoret edhe tani për prodhimin e energjisë elektrike duke u derdhur në Liqenin e HC të Spiles. Qytetari i parë i Dibrës së Madhe u ka shprehur atyre qëndrimin zyrtar se *“historikisht Radika është e Dibrës dhe*



duhet të derdhet në Drinin e Zi dhe të vazhdojë rrugën e mëtejshme për në Detin Adriatik”. Po ashtu, Bashkim Mashkulli, kryetar i Këshillit Komunal në Dibër të Madhe, ka kërkuar ndërhyrjen e qeverisë shqiptare në lidhje me këtë problem. “Ne shpresojmë se Qeveria e Shqipërisë do të ndalojë realizimin e këtij projekti, sepse edhe me konventat ndërkombëtare rrjedhjet natyrore të lumenjve nuk mund të ndryshohen... Shpresojmë se edhe Bashkia e Peshkopisë do të ndikojë te qeveria e Shqipërisë që ky projekt i dëmshëm i Maqedonisë të mos realizohet”, është shprehur kryetari i Këshillit Komunal në Dibër të Madhe. Gjatë muajit nëntor 2013 disa shoqata në qytetin e Dibrës së Madhe bënë thirrje për një protestë publike në sheshin kryesor të qytetit dhe me këtë rast iniciuan një peticion drejtuar qeverisë maqedonase. Shumë shpejt u mbledhën rreth 7 mijë firma dhe disa media në Shkup dhe Tiranë e përcollën lajmin. Po ashtu, protesta


janë zhvilluar në mjedise publike, shkolla etj. Ndërsa dibranët e Amerikës organizuan një protestë përpara OKB më 20 Dhjetor 2013 dhe kërkuan ndihmën e organizatës për të mbrojtur ujërat e Radikës. Një faqe në **Web** është ndërtuar me këtë rast dhe informacioni për mbrojtjen e Radikës duket se po kryen fuqishëm ndikimin e vet. Kjo për faktin se Projekti ogurrzi “Fusha e Llukovës” parasheh devijim të një sasive të ujit që shkon përmes Lumit Radikë dhe Pellgut të Detit të Zi në Detin Adriatik dhe kthimin e tyre drejt Lumit Vardar dhe Detit Egje. *Meqë sipas ligjit për ujëra edhe në bazë të konventave të ndryshme ndërkombëtare, devijimi i rrjedhave lumore ndalohet në rastet kur ka ndikim në rrjedhën ndërkufitare të lumenjve, qeveria maqedonase, kurrësesi nuk duhet të marrë vendime pa konsultimin e vendeve që tangohen nga ky projekt.* Dhe nëse protestave mbarëqytetare u prijnë emra të zëshëm, si avokat Altin Goxhaj e Zirkon Disha në Tiranë dhe magjistër Rrushdi Lata, Dritan Lleshi e disa të tjerë në Dibër të Madhe, tashmë intensiteti i tyre sa vjen e rritet si rrjedhojë e mungesës së transparencës. Njësoj si edhe në rastin e mungesës së transparencës për vendimin për çështjen e armëve kimike të Sirise në Shqipëri, kur i gjithë vendi u mbërthye nga protestat masive.

Këtë karakter kanë edhe këto protesta kundër devijimit të rrjedhës së lumenjve. Dhe *ashtu si rrjedha natyrore e tyre, si fryrjet e shtretërve nga prurjet e reshjeve që rrisin intensitetin e vërshimeve, edhe protestat qytetare marrin këto dimensione, kur nuk konsiderohet zëri i tyre. Një referencë nga historiku i tyre na çon te protestat e Shoqërisë Civile të viteve '98-99, kundër genocidit*

serb në Kosovë, të cilat shumë shpejt morën karakterin e lëvizjes mbarëkombëtare “Një komb–një qëndrim”. Të mirëkoordinuara asokohe nga kreu i OBVL, gjeneral–lejtnant Rrahman Parllaku, këto protesta rezultuan si treguesi më sinjikativ që inspiroi dhe mbështeti UÇK, duke ndikuar në ndërkombëtarizimin e çështjes sonë kombëtare dhe në ndërhyrjen e NATO–s kundër diktatorit serb Millosheviç.


Nëse nuk konsiderohen, këtë karakter mund të marrin edhe protestat kundër devijimit të rrjedhjes së lumenjve.

Me të drejtë zëdhësi i PDIU ngre shqetësimi edhe për propozime të njëjta që vijnë nga Greqia në lidhje me devijim të burimeve të Vjosës çka do të sillte një katastrofë të paparishikueshme në vendin tonë. Ai argumenton se Shqipëria ka të drejtën absolute, të padiskutueshme dhe të patjetërsueshme, sipas konventave ndërkombëtare që t’i thotë jo një akti të tillë. Në këtë aspekt është gjithashtu evident roli i gazetës rajonale “Rruga e Arbërit” në nxitjen e reagimeve mbi ujërat e Radikës, duke i bërë njerëzit aktiv në rrjetet sociale, pse jo dhe nostalgjikë. Siç shkruhet në një nga nr. e saj, protestuesit e vërtetë, dibranët në dy anët e kufirit, përpara thirrjeve patriotike dhe dumdumeve nacionaliste, kërkojnë zgjidhjen e çështjes, me urti dhe maturi.



**“20 VJET OBVL”, NJË
ENCIKOPEDI ME VLERA
PËR HISTORIOGRAFINË
SHQIPTARE**





Organizata e Bashkuar e Veteranëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar (OBVL) më 18 korrik 2014 festoi 20 vjetorin e krijimit të saj. Në një takim festiv jubilar në sallën e Akademisë së Shkencave, qindra veteranë e veterane, anëtarë të kësaj organizate, akademikë e profesorë të njohur nga Tirana e Prishtina, ndoqën me vëmendje përshëndetjen e kreut të OBVL-së, gjeneral Rrahman Parllaku, të nënkryetarit të Shoqatës të Veteranëve të LANÇ të Kosovës, akademik Pajazit Nushi si dhe disa peranolitete të tjera.

Heroi i Popullit dhe Nderi i Kombit, Rr.Parllaku tha ndër të tjera se “në dy dekada aktivitet intensiv, OBVL u dëshmuua para shqiptarëve si Organizata që vlerëson lart kontributin e shquar të popullit shqiptar në Luftën e Dytë Botërore, që dënon krimet e komunizmit, që mbështeti fort Luftën e drejtë të UÇK dhe në tërësi çështjen mbarëkombëtare shqiptare.

Me këtë rast u promovua edhe libri “20 VJET OBVL”, botim i redaksisë së gazetës “Veterani”. “Pikërisht ky libër që botohet në 20 vjetorin e OBVL pasqyron gjërësisht ndonjëherë edhe në detaje, pa pretenduar se ka thënë gjithçka, punën e madhe të mbi 15 mijë veteranëve që milituan deri në vdekje dhe militojnë aktualisht në të mirë të demokracisë shqiptare

dhe të së ardhmes së brezave duke pasqyruar sa më drejt këtë luftë vigane që e renditi Shqipërinë në krahun e fitimtarëve të Luftës së II Botërore”.-tha ndër të tjera gjeneral Parllaku. Sipas tij, “në 70 vjetorin e çlirimit të atdheut dhe në 20 vjetorin e OBVL, ky libër modest është një kontribut për të njohur të kaluarën e lavdishme, për të vlerësuar të sotmen dhe për të projektuar të ardhmen. Për përgatitjen e këtij libri kanë kontribuar dhjetra veteranë me shkrimet e tyre të cilët dëshiroj ti falenderoj”. Kreu i OBVL shprehu një falenderim të veçantë për drejtuesit e gazetës peroidike “Veterani”, kryeredaktorin Halil Rama si dhe për gazetarin ushtarak Sakip Cami, që kanë përgatitur dhe redaktuar këtë libër për të cilin është punuar shumë dhe për një kohë të gjatë.

Ndërsa Prof. Dr. Ana Lalaj, duke folur më konkretisht për librin “20 vjet OBVL - Organizatë e Bashkuar e Veteranëve të Luftës Antifashiste të Popullit Shqiptar” përmbledhtazi tha se se ai bën fjalë: “-Për orientimin e drejtë të Organizatës, ---Për veprimtarinë e gjallë të saj, ---Për përshkrime të disa jetëve njerëzore, --Për vetëdijen dhe besimin e veteranëve të Organizatës jo vetëm në Luftë por edhe në Demokraci”. Historiana e mirënjohur Lalaj u shpreh se ky libër në vetvete dëshmon faktin se organizatat dhe shoqatat politike, shoqërore, atdhetare kulturore etj janë asete të rëndësishme, janë pasuri e kësaj shoqërie. Pjesë e kësaj pasurie është edhe OBVL si organizatë shoqërore atdhetare. Të shkruash një libër në ditët e sotme, për profesoreshë Anën nuk është ndonjë çudi. Por në këtë libër, sipas saj “çuditë” ose të papriturat janë të vetë organizatës. Në

këtë libër tanimë OBVL ka të dokumentuar punën e vet, ka të dokumentuar shpirtin e vet, ka të dokumentuar ambicjen e vet. Parë nga ky këndvështrim, ish drejtoresha e Institutit të Historisë, shpreh shqetësimin e ligjshëm për faktin se në Shqipëri ka një numër të madh shoqatash, për të drejtat e njeriut, për biznesin, për barazinë gjinore, për të drejtat e fëmijëve, për mjedisin e të tjera e të tjera, por asnjëra nuk ka ndonjë përmbledhje, jo platformë, jo qëllim, jo Statut, se ato janë depozitime të domosdoshme juridike; por se çfarë kanë bërë që nga krijimi deri më sot. Nëqoftëse do t'i kishim këto, ne do të kishim në fakt të dokumentuar 24 vjet lëvizje në demokraci. Prandaj ky botim shumë serioz, sipas Znj.Lalaj, është ndoshta shembulli i vetëm që na e plotëson këtë nevojë. Kjo për faktin se lexuesi ka tashmë në dorë këtë libër për të njohur punën e organizatës, njerëzit që e përbëjnë, kontributet që ata kanë dhënë e japin dhe gjithë kjo na entuziazmon.

Si një enciklopedi me vlera për historiografinë shqiptare e konsideroi këtë libër edhe historiani Xhemal Meçi, “Mjeshtër i Madh”, duke e konsideruar një enciklopedi me portrete e profile të më shumë se 100 personaliteteve të shquara, ish komandantë e drejtues të LANÇ, të ekzekutuar, burgosur e internuar nga sistemi i diktaturës hoxhiste, të shkundur tashmë nga pluhuri i harresës dhe të evidentuar me tërë aktivitetin e tyre patriotik në dobi të atdheut të tyre. Po në këtë linjë u shprehën edhe nënkryetari i OBVL, Ing.Myfit Guxholli, publicisti e poeti i njohur Çobo Skënderi, kreu i Shoqatës “Labëria”, Prof.Dr.Ago Nezha si dhe kryetari i OUPLSH, z.Dhimitër Ndrenika.



Ky takim festiv qe mjaftë mbrësëlënës për qindra pjesëmarërsit e pranishëm në sallën e madhe të Akademisë së Shkencave.

Organizata e Bashkuar e Veteranëve të Luftës së Popullit Shqiptar (OBVL) u krijua më 18 korrik 1994 me nismën e një grupi pre 64 personalitetesh, gjeneralësh dhe luftëtarësh, figura politike të respektuara, por fatkeqësisht të dënuar nga regjimi komunist. Në këtë grup bënin pjesë figura politike të respektuara që kishin qenë drejtues të reparteve partizane e ministra, siç ishin: Rrahman Parllaku, Kiço Ngjela, Manol Konomi, Fadil Paçrami, Maqo Çomo, Sadik Bekteshi (gjeneral lejtant-Hero i Popullit), Muhamet Prodani (gjeneral lejtant-Hero i Popullit), gjeneral-majorët: Nexhip Vinçani, Skënder Malindi dhe Ernest Jakova; luftëtares e shquara, drejtuese në luftë e aktiviste të OBVL: Selfixhe Broja(Ciu), Zenepe Golemi (Ashiku),

Liri Belishova, Vera Ngjela (Pojani) e disa të tjera, por fatkeqësisht të dënuara nga regjimi diktatorial i Enver Hoxhës.


Kuvendi i parë themelues i Organizatës të Bashkuar të Veteranëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare (OBVL) në krye të saj zgjodhi personalitetin e shquar Dr. Ymer Dishnica.

Organizata e Bashkuar e Veteranëve të LANÇ të popullit shqiptar është anëtare e Federatës Europiane e Botërore të veteranëve. Me pjesëmarrjen dhe aktivitetet e këtyre federatave, jo vetëm në Europë, por edhe në Maljazi, në Johanenburg, Marok etj, OBVL ka bërë të njohur kontributin e popullit shqiptar në Luftën e II Botërore dhe të lufrave për liri të popullit tonë në Kosovë, Maqedoni e deri dhe kontributin që jep sot në mbrojtje të paqes në kuadrin e NATO-s.



**EUROSIG, JO VETËM
PROMOTOR I SIGURISË,
POR EDHE PROMOTOR I
ZHVILLIMIT TË KULTURËS
DHE ARTIT**





Në 10-vjetorin e themelimit, kompania prestigjioze “EUROSIG”, krahas modernizimit të punës në shërbim të qytetarit, vjen edhe si promotore e zhvillimit dhe e promovimit të kulturës dhe artitshqiptar në botë. Kjo kompani me shtrirje në gjithë vendin zhvilloi një sërë veprimtarish turistiko-kulturore me moton: “Të njohim atdheun dhe botën”. Drejtues të kompanisë me president biznesmenin e njohur, Kadri Morina, që njihet jo vetëm si dashamirës, por dhe si mbështetës i fuqishëm i kulturës dhe artit, ndërmorën edhe një udhëtim për në Rusi. 120 punonjës të kompanisë, bashkë me ta edhe shkrimtari i mirënjohur Visar Zhiti si dhe aktori Ndriçim Xhepa ishin në një tur 5 ditor në Moskë dhe San Petërburg. Për ta do të mbetet i paharruar fluturimi mbresëlënës me charter, ashtu si dhe udhëtimet e këndshme me dy autobuzë luksozë. Gjithshka ishte ideaur e mirëorganizuar nga zoti Morina, që nga guida profesioniste në gjuhën angleze dhe shqipe.

Ky tur turistiko-kulturor startoi në Sheshin e Kuq, ku mblidhen turistë nga e gjithë bota dhe ku i dëgjon të gjitha gjuhët. Pikërisht këtu kumboi mjaftë këndshëm edhe shqipja jonë e bukur. Të paharruara, shlodhësë dhe argëtuese vizitat në “Balshoj Teatër”, e në Parkun “Gorki”. Më pas në Universitetin

“Lomonosov” me 40 mijë studentë (mes të cilëve edhe qindra shqiptarë), ku u shkëmbyen frytshëm edhe përvojat e eksperiencat pozitive të punës.

Në axhendën e turit turistiko-kulturor në Moskë s’kish si të mos përfshiheshin vizitat në Parkun e madh të Fitores, te Harku i Triumfit, në rrugën e re dhe të vjetër Arabat; vizitat në kisha e katedrale si dhe shëtitjet ndanë lumit të madh Moskva-degë e Vollgës. Qindra pjesëmarrësit e këtij udhëtimi të rrallë do të qëndronin për të bërë fotografi ndanë statujave e pllakave memoriale, në përkujtim të poetëve aq të njohur edhe në Shqipëri, si Pushkini e Esenini. Ndërkohë, syrit të mprehtë të udhërrëfyesit, Morina, nuk kishte si t’i shpëtonte muzeu i disidentit nobelist Aleksandër Sollzhenicin, nga ku bashkëpunëtorët e tij të ngushtë të gjigandit “Eurosig” dolën të ngazëllyer.

Pjesë e nismës së kësaj kompanie “Sa më shumë kulturë nëpërmjet udhëtimeve turistike” ishte edhe rrugëtimi me tren për në qytetin e njohur të San Petërburgut në natën e parë të fillimit të Netëve të Bardha, kur edhe pas mesnate përshkëndiste drita e ditës.

Mbresa të veçanta la tek ekipi “Morina” i “EUROSIG” vizita në anijen “Aurora” buzë lumit Neva, nga ku Lenini goditi me top Pallatin e Dimrit, pikërisht në kohën kur nisi revolucioni që ndryshoi botën, duke sjellë perandorinë komuniste dhe diktaturat e saj. Pallati i Dimrit, Hermitazhi i famshëm, sot është një nga muzeumet më të mëdha të pikturës dhe artit botëror. Eurosigu shqiptar befasohet kësisoj nga vizita e pavioneve luksoze që fillonin me veshjet e carëve dhe careshave e

deri te kryeveprat pikturabe, si Rubens e Rembrand, Da Vinci, Mikelanxhelo, artit egjyptian, por dhe modernet si Pikasso, etj.

Gjatë këtij ky turi turistik të mirëorganizuar nga numri një i “Eurosig”, qenë mahnitëse vizitat në Versajën Ruse, në Pallatin përrallor të Petërhofit plot me lulishte e shatërvanë, në gjirin e Finlandës, buzë detit balltik, etj.


Llozhat e katit të dytë të Teatrit Marinskij u mbushën me përfaqësuesit e gjigandit shqiptar të sigurimeve, të cilët ndoqën me interes të jashtëzakonshëm operan e Korsakovit, sipas subjektit të prozes të Pushkinit “Rrëfim për Car Sulltanin”, kurse në shtatoren e Pushkinit në qytetin që mban emrin e tij, ku hidheshin lule dhe letra për të nga vizitorë të shumtë, ndaluan dhe bënë homazhe edhe turistët shqiptarë të Eurosigut. Më pas do vijonte vizita në Pallatin Përrallor të Katerinës dhe kthimi përsëri në Moskë.

Në mbrëmjen e fundit ishte i ftuar në Hotel Vega dhe ambasadori i Shqipërisë në Moskë, Z.Sokol Gjoka, i cili përshëndeti Eurosigun për këtë nismë të bukur, që i mundëson stafit të kësaj kompanie...dhe pse jo edhe personaliteteve të shquara të letrave shqipe e të teatrit shqiptar, si Visar Zhiti e Ndrëçim Xhepa, vizita të tilla turistike nëpër botë, duke përcjellë një tjetër imazh për shqiptarët dhe Shqipërinë, atë të rritjes së mirëqënies dhe hapjes gjithnjë e më shumë, në mënyrë të kulturuar.

Promotori i këtij aktiviteti mbresëlënës, padyshim që është zoti Kadri Morina, i cili njihet tashmë edhe si një ndër themeluesit e çmimit prestigjioz “Pjetër Bogdani”.


Kadri Morina e ka provuar vetveten si biznesmen qysh në kohën që punonte në vendlindjen e tij, me menaxhimin e prodhimit e tregtimit të esencës të rrëshirës së pishës. Këso-kohe, edhe pasi kërkoi të drejta të mohuara të babës së tij, Tahir Morinës, për qëndrimet e zgjuara e të prera në kohëprishjen e marrëdhënieve me Bashkimin Sovjetik, ndodhi ajo që (s)pritej: djaloshit Kadri Morina iu vërsulën njerëz të vegjël në karrige të mëdha për ta implikuar në gjyqin e jehonshëm të Kukësit për esencën e rrëshirës së pishës, prej nga doli me pafajësi. Në vitin 1990, ai fillon biznesin: I bleu katër fabrika buke nga Turqia. Nis edhe transportin e çimentos. Fillon të merret me ndërtimtari. Më 1998, ngre një zdrukdhitari për mobilje për firma ndërtuese.

Para disa vitesh, kreu dy blerje të mëdha: bleu Shoqërinë e Sigurimeve “EUROSIG” në Tiranë e me filiale në disa rrethe, bleu edhe bar-restorant “Piazza” në qender të Tiranës. Merret edhe me ndërtime deri në Sarandë. Pra, Kadri Morina, nuk është nga ata “biznesmenët e klonuar” apo “biznesmenët në inkubator” që punojnë me “lekët e tepërta” apo “të fshehta” të të tjerëve e për të tjerët, që i kemi jo të pakët në këtë kohë tranzicioni postkomunist. Nuk është as nga ata biznesmenë, që u bënë të fuqishëm me forcë apo mbi lotë. Kadri Morina është biznesmen i themeltë, i suksesshëm, i pathyeshëm, i pakthyeshëm, biznesmen i të djeshmes, i të sotmes dhe i së nesërmes.



**SA SHUMË NJERËZ
NË LAMTUMIRËN E
LIK BERISHËS!**





Rrallë herë ndodh që në ceremoninë e lamutimirës të një intelektualit të ketë aq shumë njerëz sa ç’pati në përcjelljen e mësuesit të mirënjohur Lik Berisha. Kortezi i gjatë në 10 km rrugë nga Bregu i Lumit (ish Uzina “Dinamo e Re”) për në Tufinë përmbante dhjetra autobuzë e furgonë me mijëra qytetarë kryeqytetas, dibranë, matjanë, kukësiyanë, tropojanë, etj. Një përcjellje siç e meritonte një nga njerëzit e shquar të arsimit e kulturës.

Zakonisht në të tilla ceremoni, gjithkush për të ndjerin flet fjalë të mira, por rrallë ndodh që gjithkush të përfjelljë vlera dhe mirësi nga vetë ceremonia. Natyrisht, është vlerë numri aq i madh i njerëzve që erdhën për ngushëllim, shumicë që nuk u pakësua as në varrimin e tij. Kësisoj, mijëra qytetarë nga Peshkopia, Tirana, Durrësi dhe nga e gjithë Shqipëria i dhanë lamtumirën e fundit mësuesit të mirënjohur Lik Berisha.

Ai, ndërroi jetë, krejt papritur, nga një trompozë, më 9 janar 2014. Kjo ikje e papritur, e bëri më të thekshme dhimbjen e madhe për të, jo vetëm për familjen dhe të afërmit e tij të dashur, por për të gjithë ata breza nxënësish që ai kish mësuar në Peshkopi, Muhurr, Luzni, Gjoricë, Tiranë etj., për të gjithë kolegët, pedagogët, intelektualët, me të cilët ai kish punuar..,

për të gjithë të njohurit e tij të shumtë si në Dibër, në Tiranë e kudo.

Ai lindi në Fushë-Muhurr me 1945, në një familje me tradita të njohura patriotike. Si arsimin bazë në vendlindje, ashtu dhe të mesmen pedagogjike në Peshkopi dhe Institutin e Lartë për matematikë në Shkodër, i përfundoi me rezultate shumë të mira. Qysh në moshën e rinisë, me gjithë vështirësitë e panumërta ekonomike të familjes, tek ai spikati zelli dhe vullneti i madh për shkollën, për librat dhe dituritë.

U formua si intelektual dhe shërbeu si i tillë me devotshmeri në sektorë të rëndësishëm. Si një nga intelektualët e shquar dibranë, Lik Berisha edukoi dhe përgatiti breza të shumtë nxënësish. Në profilin e mësimdhënësit punoi me devotshmëri, përkushtim e pasion të rrallë. Ky pasion e bëri fatlum në jetë duke përjetuar gjatë karrierës pedagogjike kënaqësinë dhe lumturinë magjepsëse të orëve të mësimi.

Një klasë e tërë përhumbej në sytë dhe fjalën e mësuesit të tyre. Mësuesi që nuk u shpjegonte nxënësve mësimin e ditës, por i pasuronte me dije për të përballuar vështirësitë e jetës. Dije që do i bënin më të mençur, më të duruar, më të besuar... Ai besoi dhe dëshmoi se njeriun në jetë e mban vetëm dija. Një miqësi me dijen nuk ka moshë, por mbetet e përjetshme.

Fare të ri, Lik Berishën e shohim drejtor shkollë në zonën e Luznisë, ku ra shpejt në sy për një punë drejtuese sistematike dhe serioze!

Po ashtu, Lik Berisha njihet si ish instruktor e sekretar në Komitetin e Rinisë së rrethit Dibër, ku spikati puna e tij e

palodhur dhe e frytshme me rininë e gjithë rrethit.

Mirëpo, apartçikët e Partisë së Punës në Peshkopi i trembte atëhere morali i të riut të guximshëm, Lik Berisha, ndaj ia prenë hovin duke mos e pranuar në “vallen” e tyre. Kështu ai spostohet në detyrën e drejtorit të librit dhe të filmit për rrethin e Dibrës, detyrë që e kreu gjithnjë me devocion. I qetë, i pjekur, shumë i kulturuar nuk pajtohej me asnjë devijim nga parimet e virtytshme dhe njerëzore, por mbante qëndrim. Shpërthyes dhe autoritar në ndëshkimin e tij individual, sepse përherë qëndronte në vendin e nderit, sinqeritetit dhe dinjitetit.

Në përditshmërinë e jetës ai mbetet një nga figurat më interesante si përfaqësues i elitës intelektuale dibrane. Personaliteti dhe karakteri i tij në asnjë rast nuk devijoi, por u shpalos kurdoherë dinjitoz. Si përfaqësues i së resë, diti të orientohej mirë në jetë dhe t’i përgjigjet jetës me dinjitet, me burrëri dhe fisnikëri.

Në vitet pas 90-ës, ai punon në Drejtorinë Arsimore të rrethit Dibër. Më pas, transferohet në Tiranë, ku punon deri në kufirin e moshës së pensionit si mësues në shkolla të ndryshme të kryeqytetit. Ai u shqua si përkrahës i flaktë i proceseve e shndrrimeve demokratike në vitet e pluralizmit, duke e konsideruar demokracinë sfidë ndaj sistemit që u shemb, sfidë në dinjitet, në vlerë, në përpjekje, në arritje. Thelbi i mendimit dhe veprimt të tij ishte vetëm konkurenca në vlera.

Në harkun kohor të katër dekadave, me një performancë të shkëlqyer, Lik Berisha krijoi profilin e intelektualit erudit, të mësuesit të talentuar e brilant që s’rreshti së aplikuari metodat

e reja shkencore në mësimdhënie, si dhe të bashkëshortit e prindit shembullor. Së bashku me bashkëshorten e nderuar, Nazmijen, krijuan një familje dinjitoze, një vatër të ngrohtë respekti e mikpritjeje. Ai ishte sinteza e cilësive fisnike.


Lik Berisha ka qenë shembull i mësuesit, intelektualit dibran, njeri i thjeshtë, i ndershëm dhe shumë punëtor e i respektueshëm; pishtar i rëndësishëm i arsimit dhe kulturës dibrane dhe shqiptare. Kujtimet më të mira për atë burrë të mençur, bujar, patriot dhe edukator shembullor ruajnë ish koleget e tij të nderuar Sabri e Lutfi Pira, Zylfi Spata, Sefedin Xharri etj, por dhe ish nxënësit e shumtë që e mbajnë mend për mprehtësinë e mendimit dhe forcën e argumentit.

Pikërisht, si i tillë ai u përcoll për në banesën e fundit , me të gjitha nderimet që meritonte, nga familjarët, të afërmit, miqtë e shokët e shumtë, nga Dibra, Tirana, Kruja, Tropoja, Durrësi, Elbasani, e nga e gjithë Shqipëria.



PYLLTARIA SHQIPTARE NË LËNGATË





Nga 36 drejtorë të ndërmarrjeve të shërbimit pyjor, vetëm 4 prej tyre janë inxhinierë pyjesh. Të tjerët janë simpatizantë të partive në pushtet, ndërsa nga 592 specialistë mbeten në punë 70 prej tyre, të tjerët janë të profesioneve të ndryshme, veçse specialistë pyjesh jo. Këto statistika të zymta që Dr.Selman Mëziu i jep në mënyrë të përsëritur në librin e tij “Revolucioni i gjelbërt” janë treguesi më sinjifikativ që nulifikon efektivitetin e reformës së qeverisë në sektorin e pyjeve.

Kjo situatë e trishtë menaxhimi dëshmon se pylltaria shqiptare, si asnjëherë tjetër është në lëngatë. Qindra inxhinierët e specialistët e pyjeve, nga i gjithë vendi që u mbledhën për të iniciuar dhe organizuar “Revolucionin e gjelbërt” (në promovimin e librit me të njejtin titull) mbështetën kolegun e tyre, Mëziu , nisur nga drejtimi i decentralizuar i pyjeve, nga politika të gabuara organizimi, reformash pronësie, moszbatim ligjesh, korrupsioni në vjeljen e prodhimeve pyjore etj.

Këto politika të mbrapshta kanë sjellë pasoja katastrofale. Kanë varrosur një pasuri të tillë materiale, që duhet të paktën 100 vjet të zëvendësohet. Kanë shkaktuar varfërimin ekonomik të banorëve përreth, duke bërë të pamundur vazhdimin e jetesës.

Kanë çarmatosur moralisht personelin shërbyes pyjor nga baza në qendër, kanë shkatërruar një ekuilibër biologjik, klimatik, ekonomik e ujqor, që kërkohen shekuj të rikthehen, ose kërkohen investime me miliona dollarë, për çdo njëmijë metro katrore, kanë dëbuar me dhunë nga pyjet kafshët e shpendët, banorët e përhershëm të tyre, një kryqëzatë ekologjike e paparë në mbarë globin. Memorandumi 3 vjeçar për ndalimin e gjuetisë nuk mjafton.

Duke u shprehur për këtë kasaphanë në pylltarinë shqiptare, shkencitari që prej 19 vitesh ka emigruar në Itali, me të drejtë shtron pyetjen: Kush e mban përgjegjësinë për “Hiroshimën shqiptare”?!. Dhe përgjigja është e thjeshtë, po të ndjekim këtë kronologji argumentesh që jep autori i studimit “Revolucioni i gjelbërt”.

Sipas axhensisë Green Haus, në vitin 2005 Shqipëria kishte një sipërfaqe të mbuluar me pyje prej 1.5 milion hektar, tanimë kanë mbetur 400 mijë hektar. (Ekolëvizja, Mars 2014 f. 1).

Nuk është e vështirë të nxjerrim përfundimin me një zbritje të thjeshtë, se janë shfarosur plotësisht një milion e njëqindë mijë hektar pyje. Si u zhduk kjo sipërfaqe kaq e madhe?

Duke vijuar më tej me të dhëna statistikore: Nga rreth 100.000 mijë mst. që nxjerr në ankand Ministria e Mjedisit (ku varen pyjet), në pyje priten faktikisht 2 milion 500.000 mst, pothuajse pjesa e më e madhe e destinuar për eksport. Dhe më tej: Në të gjithë këtë tregti të kriminalizuar, 100 mijë mst. dru zjarri, janë të planifikuar për popullatën.

Nga të trembëdhjetë parqet kombëtare, vetëm Bredhi i Hotovës, Përmet, nuk ka pësuar dëmtime, të tjerët kush më shumë e kush më pak, disa të zhdukura plotësisht, me anë të, prerjeve abuzive, djegie etj.

Korrupsioni ka zhdukur, pa lënë asnjë gjurmë në pyjet e shkatërruara shqiptare, 40 milionë dollarë, dhënë nga Banka Botërore e investues të tjerë. Gjatë këtyre dekadave, nga 3000 hektarë pyllëzime në ekonomi të ndryshme në gjithë vendin, nuk gjendet as edhe një fidan drurësh pyjor.

Çdo vit, nga brezi bregdetar zhduken 15 deri 20 hektar, pyje, ndësa deti Adriatik e Jon “ushqehen” çdo vit me 20 milionë ton materiale inerte, tregues i erozionit më të lartë në botë.

Vetëm gjatë dhjetë vjetëve të fundit, çdo vit shkatërrohen nga zjarret 45 mijë hektarë pyje. Përgjatë brigjeve të lumit Shkumbin, nga Elbasani në Peqin, janë zhdukur plotësisht 800 hektarë plepishte, me prerje, djegie, vershime ujrash etj.

Parku Kombëtar i Lurës në rrethin e Dibrës, është zhdukur e liqenet e saja janë kthyer në moçale. Po kështu, Bredhi i Drenovës në rrethin e Korçës, me sipërfaqe 1380 hektarë, është prerë rrafsh me tokën. Të dy këto janë shpallur parqe kombëtare në vitin 1966. Fatkeqësisht tani i mbetur vetëm në letra.

Pothuajse janë duke u zhdukur disa lloje kafshësh e shpendësh, ndër të cilat po shënojmë vetëm disa prej tyre: Shqiponja e malit (A. Chrysetos); Kaprolli (C. Capreolus); Lundërza (L. Lutra) etj.

E gjithë kjo masakër kriminale i hoqi tokës shajakun e saj, mbulesën biologjike e ushqyese, që e ndihmonte të rregullonte

rrjedhjen e ujrave, që toka të mos grryhej, e që ripërtërtja të sigurohesh nën ‘kujdesin’ e vetë drurëve mëm. Por “Kur sheh këto pamje që janë të kudo ndodhura në Shqipëri.... ku fytyra e katastrofës erodive ka nxjerrë brinjët e të sëmurës “TOKE”, që lëngon e zhveshur lakuriq nga mbulesa që quhet PYLL. Kështu shkatërrohet toka (në Shqipëri) në rreth 20 deri në 70 hektarë sipërfaqe në vit, më e larta kjo shkallë shkatërrimi në Europë e në botë...” e kupton më së miri shqetësimin e ligjshëm të Dr. Selman Mëziut.


Dhe shkallëzimi i sulmit barbar për shkatërrimin e natyrës shqiptare kaloi nga njëra qeveri në tjetrën si dhe në Qeverinë Rama ku u realizua reforma institucionale me Urdhër n.49 dt.30.01.2014, me largimin nga puna të inxhinierëve dhe teknikëve të pyjeve. Nga përllogaritjet e përafërta, punësimi i teknikëve e inxhinierëve të pyjeve nga totali 592 punonjës, mund të punësohen 70 ose 80....,Dhe më e qartë del veprimi diskriminues i inxhinierëve të pyjeve kur: “... Nga 36 DShP (Drejtoria e Sherbimit Pyjor), vetëm në 4 prej tyre drejtojnë inxhinierë. Në të njejtën linjë me z.Mëziu edhe Ing Admir Seci shprehet se “Ata që kanë firmosur për të gjitha këto, janë aty në Ministrinë e “Mjedisit”.... dhe se vazhdojnë të bëjnë më të keqen, që mund të bëhet. Kjo për faktin se politika e sotme e qeverisë shqiptare, ka urdhëruar shkrirjen e ndërmarrjeve të pyjeve. Sapo ka hedhur në rrugë të madhe mijëra pylltarë shqiptarë, specialistë të mesëm e të lartë. Kjo e revoltonte autorin e këtij studimi dinjitoz i cili me keqardhje konstaton se “Për herë

të parë në historinë botërore, pylltarët e mbulesa vegjetale, vihet në tehun e shpatës për zhdukjen e specialistëve e mbulesës së dobishme të tokës shqiptare. Një krim monstruoz dhe me pasoja shkatërrimtare për ekonominë dhe popullin e vuajtur shqiptar, të malësive, kodrinave etj”. Pikërisht, nisur nga këto statistika të frikshme, për domosdoshmërinë e revolucionit të gjelbërt shprehen me kurajo: Prof. Kristo Qendro, Prof. Llambi Stefanllari, Dr. Ylli Kortoci, Dr. Gazmend Zeneli, Dr. Hajri Mandri; Gjenerali 95-vjeçar Rrahman Parllaku (Hero i Popullit dhe Nderi i Kombit), inxhinerët: Kleanthi Mandi, Gjon Fierza, Kole Malaj, Janaq Malaj, Ahmet Mehmetaj, Ilmi Gjana, Selim Dini, Abdulla Diku, Rexhep Ndreu, Ferdin Liçaj e Preng Bardhi, por dhe gazetarët e mirënjohur të RTSH Defrim Methasani e Jaho Margjekaj. Të përfshirë në një komunikim bashkëkohor ata evidentojnë tek libri “Revolucioni i gjelbërt” vlerën e bashkëkohësisë, të përqëndruara në një problem: Ruajtjen e pasurisë së gjelbërt, veçanërisht të pyjeve të shqiptarëve. Libri ka materiale bisedimore. Aty ndjen dhimbjen e prerjes së një druri, si qenie e gjallë. Aty ndjen dhimbjen e ‘reformave’ ndër pylltarët, tashmë si njerëz që kanë shërbyer në këto pyje e që ‘reformat’ përzgjedhëse i nxorën në rrugë. Dhimbje njerëzore ndjen për cilindo nga këta.

Gjithsesi autori kërkon rrugët demokratike të përmirësimit të administratës së pyjeve, të mënyrës së menaxhimit të kësaj pasurie, që Zoti u ka dhënë shqiptarëve e që, në realitet, po e sakaton politika e politikanët.

Duke konkluduar se një vullkan i madh shkatërrues kërkon

të mbulojë me llavën e saj punën gati njëqindvjeçare në pylltarinë shqiptare; kërkon të shkatërrojë shkencën pyjore, gjithë bioekosistemin pyjor e bimor të natyrës shqiptare; të varrosë të sotmen e të mbyt shpresën për të jetuar në të ardhmen, inxhinierët dhe specialistët e pyjeve, të vënë në rolin e “gjeneralëve” që do të drejtojnë këtë revolucion të gjelbërt, i bëjnë thirrje opinionit publik të ngrihet për t’i thënë ndal këtij revanshi fashist kundër pyjeve, kësaj pasurie të madhe mbarëkombëtare. Ata janë të vendosur që këtë revansh të pashoq në gjithë historinë e natyrës botërore të pyjeve, t’ua bëjnë të ditur nëpërmjet protestave, peticioneve etj, institucioneve, si FAO, OKB, Bashkimit Evropian e të gjithë shoqërive të natyrës e pylltarëve në mbarë botën.



“Gropas 67”, është titulli i romanit të XI, të shkrimtarit Teodor Laço, një titull sinjifikativ që shpreh dhe nënkupton gropën e madhe që u krijua në shoqërinë shqiptare në vitet 60 të shekullit XX dhe veçanërisht në vitin 1967, pas Letrës së Hapur të KQPPSH dhe fjalimit të 6 shkurtit të Enver Hoxhës në imitim dhe në thellim të revolucionit kulturor kinez.

Cilido që e ka jetuar atë periudhë kohore, e përjeton edhe një herë tjetër me emocione të fuqishme nëpërmjet romanit të ri të shkrimtarit Teodor Laco. Është pikërisht ai brez lexuesish që këtë roman e lexon me një frymë dhe me emocione që herë herë i dyzojnë vetë qënien e tij, nëse vërtet e ka jetuar këtë jetë të vështirë dhe tjetërsuese për njeriun. Nuk marr përsipër të shpreh se çfarë ndjejnë lexuesit e tjerë të brezave më të rinj dhe as të atyre që e shkaktuan këtë përçudnim të njeriut, por që në krye të herës do të thonim se ky roman është një skaner politik, shoqëror dhe letrar i Shqipërisë së viteve 60 dhe veçanërisht e pas vitit 1967. Si dëshmitar okular i disa prej situatave të ndodhura në roman dhe të përjetuar prej nesh, apo prej njerëzve tanë më duhet të them se romane të tilla janë skenarë filmash artistike dhe dokumentarësh, janë memorie dhe thirrje për të mos harruar. Thonë shpesh disa, se ne jemi një komb që

harrojmë shpejt. Këtë nuk dua ta besojmë sepse një popull që harron edhe gabon më shpesh dhe çdo gabim të tij e paguan shtrenjtë.

Laço skalit me mjeshtri personazhe të vitit '67 që ka qenë nga vitet më të errëta të historisë komuniste. “Në '67-ën nisi lufta ndaj besimit fetar. Nisi si një iniciativë e rinisë se një shkollë të Durrësit, që më pas u përhap në gjithë Shqipërinë. Kjo “çmenduri” solli shkatërrimin e kishave dhe xhamive, e veprave të artit bizantin, dënimin e klerikëve... me një fjalë erdhi ajo që u quajt me mburrje nga Enver Hoxha si shteti i parë atëist. Për mua gjithçka ndodhi ishte reminishencë e revolucionit kulturor kinez. Nuk mund të thuhet se revolucioni kulturor kinez ishte një nga tablotë më të zeza dhe më absurde që u zbatua pikë për pikë në Shqipëria, por disa karakteristika të tij u infektuan edhe në shoqërinë shqiptare”, -shprehet vetë autori në një intervistë për mediat.

Romani i Laços na bën thirrje që të kujtojmë dhe të mos harrojmë, që të reflektojmë dhe të nxjerrim mësimë për të sotmen dhe për të ardhmen. Ja pra, që ndodhka, që shqiptarët ndonëse popull i vogël, spiunojnë njëri tjetrin aq shumë dhe padrejtësisht dhe kënaqen kur e shohin vëllain apo bashkëqytetarin në burg, në internim, që kënaqen kur i marrin shtëpinë apo katandinë, që i shkatrojnë jetën dhe familjen dhe për të shkuar edhe më tej vrasin apo vjedhin sikur të ishin jo në një territor me 28 mijë kilometër katrore, por si të ishin në Sahara apo Siberi, në Kinë apo në Indi. Ndaj në vend që të rritemi si shtet apo si komb rrudhemi edhe më shumë edhe sot sepse

atavizma të sistemit komunist na rëndojnë kaq shumë edhe sot.

Gropas, kënetë, ligatë, djerrinë etj janë shprehjet dhe emrat e zonave dhe fshatrave tona në atë kohë, që trashëguam dhe që i transmetuam më pas sikur të ishin mrekulli të natyrës dhe të njerëzimit. Gropa e madhe që pësoi Shqipëria pas vitit 1967 ishte e jashtëzakonshme. Si asnjë shtet dhe asnji komb tjetër mohuam Përcënimin dhe deshëm të bindnim popullin se Përcënimin ishte ai, diktatori dhe ajo, partia. Feja thoshte mos vidh. Ne e mohuam fenë dhe kështu vidhëm më lehtë se nuk do të na binte mbi krye mallkimi i Zotit, por në fakt mallkimi i tij na shoqëroi gjithë vitet më pas. Shkatrruam kishat dhe xhamijat dhe i bëmë magazina për grurë, por gruri nuk u bë asnjëherë për t'i mbushur ato. Ushtarakëve u thamë hidhni poshtë spal-etat dhe bëhuni njësh me popullin se gradat ju largojnë nga populli dhe ndodhi ajo që ushtria u bë çikë çikë. U bëmë të gjithë njëllor me një dhomë e një guzhinë, me dy divane dhe një bufë, një televizor bardhë e zi dhe gatuanim me furnelë gazi në banjo.

Prandaj ndoshta do të ishte mirë që edhe brezi i ri ta lexonte këtë roman që të reflektonte se Shqipëria nuk ka qenë kështu, se prindërit u rropatën nëpër të tilla gropa për të arritur mbijetesën.

Në qendër të romanit janë tre personazhë kryesorë, poeti Miron Konjari, inxhinjeri Vllasi Vishnja dhe ish ushtaraku Zigur.

Mironi është një poet i talentuar, por që nuk shkruan dot brenda kornizave të realizmit socialist, që shkruan më shumë

për dashurinë se sa për partinë që drejtonte vendin. Ai gjatë periudhës së redaktimit dhe botimit të vëllimit të tij poetik bie pre e ndjenjave dashurore me redaktoren Ana. Dhe ja, që ka shkëlur në dërrasë të kalbur, ka prekur në telat e huaja sepse Ana është e fejuara e një diplomati karriere që mezi prët të celebrohet dhe të martohet me të dhe të shkojë jashtë shtetit. Ana e dashuron Mironin, por nuk mund të kundërshtojë martesën me të fejuarin e saj dhe të përballojë opinionin dhe syrin “vigjilent”, ku në çdo dy veta, njëri është bashkëpunëtor i sigurimit të shtetit, apo i Frontit Demokratik. Libri i Mironit botohet, por shumë shpejt ai kthehet në karton sepse ai nuk përmabn poezi për partinë dhe udhëheqësin, sepse ai determinohet nga dashuriçka. Dhe për të mos u mjaftuar me kaq, Mironi dëbohet nga Tirana dhe internohet në Gropas.

Po këtë fat ka edhe inxhinjer Vllasi, vetëm për faktin se ai ishte martuar me një ruse dhe nuk pranonte ta ndante atë. Nuk mbaron me kaq sepse edhe të shoqen, Marian apo Mashën siç i pëlqente ta thërriste Vllasi, e burgosin për agitacion dhe propogandë kundër partisë dhe pushtetit popullor.

Në një dhomë me këta të dy në Gropas dërgohet edhe Ziguri, një ish ushtarak, edhe ky i internuar, por ky i fundit, me një status special, të spiunonte dy të internuarit e rrezikshëm, Vllasin dhe Mironin.

Në Gropas ata gjejnë një mjedis të vështirë, por gjithësesi miqësor nga banorët dhe jo miqësor nga bashkëpunëtorët e partisë dhe të sigurimit të shtetit. Dhe vuajtjet e tyre nuk mbarojnë me kaq. Ata suverjohen çdo ditë dhe çdo natë. Përpiqen ta

ruajnë vehten, të kyçin gojën, por prapë se prapë bëhen pre e prapaskenave të punonjësve të sigurimit. Kështu duke u mos u mjaftuar me internimin e Vllasit, atij i kurdisin një kurth, i fusin nën dyshek kryqin e kishës, sikur ta kishte vjedhur apo fshehur ai. Vllasin e arrestojnë dhe e burgosin.

Rradha për t'u burgosur i vjen Mironit. Por ngjarjet rrokullisen rrëmbimthi jo vetëm me personazhet e romanit, por edhe në tërë Shqipërinë. Prishja dhe shkatërrimi i kishave dhe xhamijave, fletë e rrufetë e famshme për të goditur këdo me force, që nuk ecën me hapin e partisë, lufta ndaj zakoneve prapanike etj.

Mironi mbyllet në guaskën e tij, nuk shkruan dot, megjithëse subjekte ka për romane të tëra. Provokimet e Ziguirit, të guzhinjerit Kristo e të të tjerëve nuk kanë të sosur.

Ja si shprehet autori për këtë gjëndje emocionale dhe shpirtërore të personazhit të tij: “Si mund të jetë bota ime kjo skutë ku më detyrojnë t’i shtyj ditët? Në këtë jetë ku të gjithë jemi udhëtarë, kam dashur të ec drejt një ëndrre. Këtu s’mund të bëj dot asgjë, përveçse të largohem nga ëndrra. Tani le të vdesë, ta varros. A nuk i varrosi kështu miku im i paharruar? Në këtë gropë bien edhe kujtimet. Dhe drita e tyre po humbet, po shuhet, po ndyhet nga balta. Ja, kjo vërtet është e çuditëshme. E pakuptueshme. A nuk i thërresim kujtimet e bukura të së shkuarës për të larguar zymtësinë dhe trishtimin e së sotmes? Këtu në Gropas, edhe kjo pritje e dëshiruar e kujtimeve është nxirë prej përditësisë, prej asaj që je i detyruar të bësh, të durosh, të pranosh dhe prej pritjes së të nesërme, që do të jetë njëlloj. Ishte një përçartje kllapie.”

Dhe kulmi arrin kur edhe shokun e Mironit, Arturin, operator në Kinostudio e akuzojnë për bashkëpunim me armikun e klasës sepse ka pirë kafe me Mironin, sepse ka shok Mironin dhe e dëbojnë edhe atë.

Kështu, në këto kushte Mironi e gjen vehten buzë detit, jo për t'u arratisur siç ndiqej në çdo çast, por për të vrarë vehten. Qau edhe deti për këtë poet, për këtë njeri me botë të madhe.

Por kush është Mironi? Ndër mend na vijnë sa e sa poetë të burgosur sepse shprehën fjalën e lirë poetike, shprehën dashurinë.

Po inxhinjer Vllasi? Vllasi personifikon dhjetra intelektualë që studiuuan në Rusi, Ceki, Poloni dhe në vendet e tjera lindore e përendimore që u panë si armiq, megjithëse me dijet e tyre vendosën themelet e gjeologjisë, minierave dhe industrisë shqiptare. Po kështu mund të sjellësh ndërmend sa e sa ushtarakë që studiuuan në Bashkimin Sovjetik dhe që u martuan me ruse dhe për këtë “krim” u burgosën, u shkarkuan dhe u syrgjynosën.

Romani mbyllet jashtë skemave, por ashtu siç ndodh në të vërtetë. Trishtimi i vdekjes së një njeriu. Deti u përmbys, e mbyll rrëfimin autori.

Tanimë është përmbysur edhe një kohë, një regjim, por a është përmbysur me të vërtetë ai? Herë pas herë rishfaqen fantazmat e tij. Kanë kaluar 30 vjet nga vdekja e diktatorit dhe me të merren të gjithë, historianë, politikanë, analistë, publicistë, 22 vjet nga triumfi i demokracisë dhe ndryshimi në ekonomi lë për të dëshiruar. Brezi i “Gropasit 67” tashmë është në pension

pleqërie dhe merr më pak se dyqind dollar në muaj.

Nuk është bërë asnjë analizë, nuk është nxjerrë asnjë konkluzion i plotë as për peridhën e Mbretit Zog, as për Luftën Antifashiste të Popullit Shqiptar, as për dosjet, gabimet, fajet dhe krimet e periudhës së komunizmit dhe as për luftën e sotme kundër krimit të organizuar dhe korrupsionin që po e bren vendin cdo ditë e më tepër.

Në romanin që lexohet me një frymë ka përjetime emocionale të ngjarjeve të cilat i ke dëgjuar, njohur ose ke qenë afër. Personazhet janë të qëmtuar nga realiteti i asaj kohe. Personazhi i Tomë Gjëvarfi është person real. Kur e ka “skalitur” atë si personazh Laço ka patur parasysh një njeri real që e ka takuar në “Turizmin’ e Fierit, qytet në të cilin vetë ai ishte “qarkulluar”. “Kam pirë një kafe me të. M’u afrua vetë se ishim nga fshatra fqinj. Ishte guximtar i madh. Zbriste në qytet në të rrallë kur i jepnin leje. Ishte natyrë rebele. Historia e Tomës është historia e atij njeriu”, -rrëfen vetë Laço. Ndërsa tek personazhi i poetit Miron Konjari është historia e shumë shkrimtarëve, çdonjëri mund ta gjejë nga pak veten tek ai, po ashtu dhe ajo e inxhinierit Vllas Vishnja. Kësioj, autori i romanit “Gropas ‘67” rrëfen mjeshhtërisht persekutimin e elitës shqiptare

“Romani “Gropas 67” na bën thirrje për të vepruar dhe për të mos harruar.

(Botuar me bashkeautor Sakip Camin)

Romane nga Teodor Laço:

Tokë e ashpër, 1971

Përballimi, 1975, çmimi i Republikës

Lëndina e lotëve, 1978

Korbat mbi mermer, 1981

Të gjithë lumenjtë rrjedhin, 1987, çmimi Migjeni

Pushimet e kolonelit, 1990

Një vit i hidhur, 1996

Ishulli i mëkatarëve, 2004

Vrasja e buzëqeshjes, 2007


Mjegull, 2009

Gropas 67, 2014



**SHEFKI KARADAKU,
NJË SHKRIMTAR I
HARRUAR DHE JO I
VETMI**






Pas afro dy dekadash u ribotua romani “Puthja e ngrirë” i Shefqet Karadaku. Teksa lexon këtë roman shumë tërheqës vetëtimthi të kujtohet krijimtaria letrare mjaft cilesore e këtij poeti dhe prozatori që shkruan prej pesë dekadash, si romanet “Njëmijë vjet dashuri”, “Argonautët”, “Vila e magjepsur”, “Salamandrat”, “Filantropi”, “Panegjericus”, “Gjergj Elez Alia”, “Sagë mbretërore” si dhe disa novela e vëllime me poezi. Shefki Karadaku është 70 vjeç dhe askush nuk është kujtuar të bëjë bilancin e këtij shkrimtari shumë prodhimtar. Këtu bën përjashtim autori Bardhyl Ajazi që ka shkruar monografinë: “Elbasan i bukur, Elbasan” me syrin e poetit Shefki Karadaku, por përsëri askush nuk është ndalur të bëjë një kritikë të plotë letrare për këtë poet dhe prozator tanimë me 30 libra me poezi dhe prozë.

Duke mos qenë kritik profesionistë nuk marrim përsipër të bëjmë një kritikë të plotë letrare për veprat e Shefki Karadaku, të këtij shkrimtari të palodhur që krijon çdo ditë pa u mburrur, ndërkohë që krijues të tjerë mediokër paguajnë për shkrime dhe kritika plot lavdërime dhe të pamerituara.

Shkrimtarët dhe artistët e Shqipërisë si të gjithë njerzit e kësaj bote nuk janë të përjetshëm. Dhe si të tillë ata duhet të



vlerësohen dhe të rivlerësohen vazhdimisht. Nuk u kujtuam t'i nderonim në të gjallë të tyre Lazgushin, Kutelin, Shvarcin, Kadri Roshin, Violeta Manushin dhe viganë të tjerë të artit dhe të letërsisë shqipe. Tani që nuk i kemi midis nesh themi me njëri tjetrin : “Po si ikën kështu pa na thënë, pa marrë leje, pa i intervistuar, pa shkruar biografinë e tyre, pa i nderuar dhe vënë atje ku u takon, atje në piedestalin e nderit, nder që e merituan me veprat e tyre?!”

Sigurisht ka shumë zëra të rinj dhe të vjetër që duhen rivlerësuar. Por kritika letrare nuk funksionon. Ajo është shëndrruar në fragmentare dhe sektare ashtu si edhe politika.

Thirrja jonë do të ishte që në shkollat e mesme dhe në universitete të mund të organizoheshin debate letrare, mbrëmje poetike me veprat letrare të Karadakut dhe të autorëve të tjerë

të letërsisë shqipe. Atëhere çdo kush do të bindej se atdheu, vendlindja, kënga, gëzimi, hareja, dashuria, mirësia, janë aty në brendësi të librave të këtij autori të talentuar.

Para vitit 1990 kur trokisnim në dyert e redaksisë së revistës letrare “Ylli”, ato na hapeshin me dashmirësi nga poeti dhe redaktori Shefki Karadaku. Tani ndoshta është një borxh i vjetër për të kthyer, është një detyrim njerëzor për të shlyer, për të bërë një analizë të thjeshtë letrare të veprës së tij kaq të gjërë.

Që në librin e tij të parë poetik, në baladën “Shkronjat e shqipes” poeti elbasanas shkruan për mësuesin e nderuar elbasanas Dhaskal Todri:

*‘Ai në gjumë ra edhe në ëndër
Pa’ Elbasanin dhe të madhen botë
Fëmijët nëpër udhë duke rendur
Me libra shtypur si në Europë’*

Mjaftojnë këto katër vargje për të nxjerrë konkluzionin e poezisë së Karadakut. Në këtë poezi do të gjesh vendlindjen e tij Elbasanin, do të gjesh Europën, dhe dëshirën e shqiptarëve ndër shekuj për të ndjekur dhe për tu bërë si Europa, do të gjesh rilindasin Dhaskal Todri dhe nderimin që bën autori për të, do të gjesh fëmijët shqiptarë dhe dashurinë e tyre për dituri. Pa dyshim në këto vargje të shkëputura nga mijëra vargje të librave të tij do të dallosh qartë origjinalitetin artistik, ritmin, vargun e skalitur, mendimin e thellë, mesazhin patriotik dhe qytetar.



Po kështu vargje brilante dhe mahnitëse do të gjesh në baladën tjetër kushtuar përsëri një tjetër bashkëqytetareje el-basanase, Haxhire Myzyrit:

“Në shtrat të saj të virgjër/Nga dritaret/Aromë e portokajve hidhej lehtë/Edhe mbi kaçurelat/Si alabaster/Veriu fësh-fërinte qetë-qetë

Përtej deriçkës/Elbasani priste/Agimin e lirisë në çdo prag”.


Dashurinë për vendlindjen dhe mallin për çdo gur të tij autori e ka shprehur në dy libra, në librin poetik “Meloditë e Shkumbinit” lumit më të dashur që e ka lidhur jetën ky qytet dhe në librin “Elbasan, dashuria ime”, pa përfshirë edhe poezitë e çdo vëllimi tjetër.

Thjeshtësia, bukuria deri në modernitet, fjala e gdhendur në çdo rresht si në poezi dhe në prozë, mesazhi qytetar dhe patriotik që transmeton është dallimi që e bën Karadakun të qëndrojë denjësisht si një gur i madh në murin e lartë të letërsisë shqipe.

Karadaku shkroi kaq shumë për Elbasanin, po Elbasani ç' bëri për Karadakun. Karadaku shkroi kaq shumë dhe me kaq talent duke kontribuar për letrat shqipe, po Instituti i Letrave Shqipe kur do të kujtohet për të ?


Ai shkruan, shkruan dhe vetëm shkruan gjëra të bukura dhe me vlerë për brezat që janë sot dhe për ata që do të vijnë. Të shkruash 12 vëllime me poezi dhe 10 romane e 8 libra me novela, që të gjithë me subjekt të zgjedhur e të arrirë nuk janë pak. Ato janë një kontribut i çmuar për të sotmen dhe për të nesërmen që të mos ketë “Puthje të ngrirë”, që fjala e lirë të rrjedhë si “Ujvarë”, që “Gjergj Elez Alia” tu transmetohet brezave si njeri trim dhe i besës, si njeri i zgjuar dhe i ditur, që respekton njerëzit e tij, por edhe vizitorët e huaj të rajonit e të botës, që “Shkumbini” të mos shkatrojnë tokat, por të përmirësojë ekologjinë tonë, që “Elbasani i bukur” të çlirohet nga ndotja dhe të shëndrrohet në turizmin tradicional shekullor.

(botuar me bashkëautor Sakip Cami)



**FILOZOFIA POPULLORE
DIBRANE NË RRËFIMET
E SAKIP CAMIT**





Brenda pesë viteve, poeti dhe publicisti i njohur Sakip Cami ka botuar dy libra të të njëjtit profil, në të cilët rrëfëhet mjeshtërisht filozofia popullore dibrane. “Rrëfime popullore dibrane” (2006) dhe “Dibra nëpërmjet këngëve dhe tregimeve të popullit” (2010) janë dy libra të vyer që përcjellin tek lexuesi visare të Dibrës. Në këto dy libra gjen mishërim sentenca “Atdheu nis nga familja”. Mjafton për këtë qoftë dhe kushtimi i dy vëllimeve prindërve të tij, Ukë A.Cami dhe Razie Cami (Hasa), nga goja e të cilëve (siç shprehet vetë autori) ka dëgjuar shumicën e këtyre rrëfimeve. Në këto rrëfime, ndonëse përçohen nga alegoria therëse, s’është e vështirë të dallosh mirëbërësinë e bujarinë e dibranëve, autoritetin moral e shpirtëror, traditën e mikpritjes, por dhe zgjuarsinë, inteligjencën dhe mençurinë e dibranëve nëpër shekuj. Këto, cilësi, më mirë se askush tjetër i ka mbledhur, perceptuar dhe pasqyruar realisht në këto dy libra, dibrani i mirë dhe i talentuar Sakip Cami, autor i disa librave me poezi, monografi, publicistikë, fabula e satira. E ka bërë këtë, duke qëmtuar e hulumtuar nëpër dasma e morte, në kuvende, në ceremoni fejesash e lindjesh, ku shpaloset mençuria e famshme, po dhe ajo që quhet “alegoria dibrane”. Dallohen fare qartë këto, qoftë dhe vetëm në rrëfimin me titull

“Gjëmon Korabi or babë”, ku përçohet ideja se mali më i lartë i atdheut tonë gjëmon vetëm kur ka luftë të madhe me shumë kraja?! Më tej, rrëfimi me titull: “O Muharrem Aga, shyqyr që të vdiq baba”, në pak rreshta sintetizon ligjin e jetës, barazinë e gjallesave para Zotit, si në fragmentin: “...jetën e ka në dorë Zoti, por po të kishte shpëtue baba i bajraktarit, na të tjerët nuk kishim ma vend prej baballarëve tanë”. “E patë, Muharrem Aga e shnoshi babën në Austri, ndërsa ju na leni me vdekë”, do na thoshin...”

Gjejmë në këto rrëfime gjithashtu ballafaqimin me vështirësitë e jetës, por dhe guximin e trimërinë për përballimin e tyre. Kjo më së miri konstatohet në rrëfimet me titull: “Me këto para që punoj e fitoj unë ushqehem, laj borxhet e jap pare me fajde”; “Asgjë nuk vjen nga oxhaku”, “Kush ka kohë” etj.

Një vend të veçantë në këto dy vëllime zë filozofia popullore e përçuar nga goja e burrave të mençur e të urtë dibranë, siç mund të veçojmë filozofin popullor Dine Hoxha nga Muhurri i Dibrës, të cilin e kanë quajtur Dekan i “Universitetit të Dibrës”, “Sokrati i Dibrës”, “Profesori i alegorisë dibrane”, sepse atë e njihje mbarë Shqipëria. Vetë mbreti Zog e kishte këshilltarin e vet.

Filozofia e këtij mëndje kandarfloriri jepet qoftë dhe në rrëfimin me titull “Dine Hoxha dhe latifondisti francez”. Është koha kur një pronar i madh tokash nga Franca vjen në Shqipëri për të takuar Dine Hoxhën që ta pyeste për mend lidhur me shqetësimin e tij që konsistonte në sekuestrimin e qindra hektarëve tokë pronë e tij, nga qeveria franceze. Dhe përgjigja e Dine Hoxhës ishte: “Dëgjo or

mik, mos u ngatërro me qeverinë për punën e tokës. As me qeverinë dhe me asnjë njeri. Sakllam, sakllam, çdo njeri ka të vetat vetëm dy metra katror tokë, ndërsa ti ai i ke, apo s'i ke nuk e di!"

Fjala dhe kuvendi i dibranit shquhet për mendjemprehtësi e lakonizëm, për peshë mendimi, për sinqeritet e dashamirësi, por dhe për këmbëngulje e qëndresë imponuese, bindëse. Më mirë se kudo tjetër këtë e ndeshim tek libri i S.Camit “Dibra nëpërmjet këngëve dhe tregimeve të popullit”. Aty gjejmë “Mesele dibrane”, “Histori”, “Rite, zakone dhe traditë”, “Tregime brenda dhomës dibrane”...gjejmë historinë e Dibrës nëpërmjet këngëve të vjetra popullore, por dhe nëpërmjet dokumentave.

I kompozuar kështu “Dibra nëpërmjet këngëve dhe tregimeve të popullit” është një sintezë e mençurisë, urtësisë dhe filozofisë dibrane. Ai është i mbushur plot me visare të çmuara. Me mjeshtri të rrallë, Sakip Cami ka ngritur në art odën dibrane që është quajtur “Universiteti i Dibrës”, atëhere kur në Shqipëri nuk kishte as shkolla fillore.

Madje siç shprehet recensenti, Hajri Mandri në parathënjën e këtij libri : “Mendimi filozofik dhe mendimi estetik, në odat e Dibrës, transmetonin që nga e kaluara e herëshme, mesazhet përmes një forme origjinale. Këto janë rrëfenjat (tregime), ose siç u thotë populli “meselet”, të cilat, për nga gjuha, kompozicioni, simboli dhe alegoria, humori dhe ironia, hiperbolat dhe litotat, u shndërruan në një platformë komunikimi për dibranët ose në një “shkollë” ku shpaloseshin idealet socialestetike, qëndrimet moralizuese e didaktike, rreth jetës e vdekjes,

rreth familjes e integritetit të saj”.

Pikërisht mbi këtë shtrat ndërtohen dhe librat e S.Camit “Rrëfime popullore dibrane” dhe “Dibra nëpërmjet këngëve dhe tregimeve të popullit”, ku brenda një tematike shumë të gjerë dhe të larmishme rrëfëhet tradita, historia dhe heronjtë e Dibrës, por dhe ngjarje të ditës, të lidhura ngushtë me politikën, ekonominë e sjelljen e njerëzve në rrethana të caktuara.


Në këto rrëfenja gjejmë fjalën dhe kuvendin e dibranit të shquara për mendjemprehtësi e lakonizëm, për peshë mendimi, për sinqeritet e dashamirësi, por dhe për këmbëngulje e qëndresë imponuese, bindëse.

Si askush tjetër, Sakip Cami në këto dy libra reflekton zgjuarsinë dibrane, maturinë e burrave të mençur te Dibrës, dashurinë për njerëzit, sakrificat, patriotizmin e shumë veti të tjera të çmuara.



**NAIM BERISHA, NË 20 VITE,
20 BOTIME DINJITOZE NË
POEZI DHE PROZË**





Në harkun kohor të dy dekadave të fundit, Naim Berisha ka hyrë me dinjitet në historinë e letrave shqipe si poet dhe prozator. Dëshmia më e qartë për këtë janë botimi i më shumë se 20 librave me poezi e prozë në 20 vite. Dhe pas kësaj krijimtarie tejet produktive e cilësore, të gjerë e të larmishme, të mirëpritura nga lexuesi dhe kritika letrare, ai paraqitet me gjashtë botime të reja: katër libra me poezi, një me fabula dhe një me tregime të titulluar: “Pengu i nëndheshëm”, “Kur grindeshin skeletet”, “Shpirt i heshtur”, “Gjindja kishte ngrënë egjër”, “Vdekja e deles” dhe “Luleçelur në degë të mollës”.

Kam patur privilegjin të jem redaktor i katër prej këtre botimeve, por më konkretisht do të ndalem tek vëllimi me poezi dhe poema “Pengu i nëndheshëm”.

Ky libër, i ndarë në gjashtë kapituj, ka një ndërtim interesant e disi të veçantë, duke ndërthurur dy linja që ecin paralel me njëra-tjetrën: atë të traditës dhe atë të dashurisë njerëzore. Nga faqja në faqe, nga kapitulli në kapitull, në 99 poezitë dhe poemat e librit, ata zbulohen më të plotë e më bindës.

Duke lexuar këtë libër, ndodhesh në një botë krejt të veçantë, ku ndeshesh me krijimin e situatave të reja. Në të dalin në pah perceptimet e autorit për mënyrën e të dashuruarit, duke

pasur si pikë referimi autorë të njohur të kohërave moderne.

Poezia e këtij libri lë përshtypjen se është shkruar me shpirt; është një poezi spontane, e kulluar me një kujdes fin. E shprehur kjo, më së miri qoftë dhe vetëm tek vargu: “Dashuria është i vetmi fat, që njohim e dot s’e shmangim...!”

Naimi është lakonik, ai shkruan shkurt, por poezia e tij ka domethënie, ajo flet gjatë. Vargu i saj është i ngjyrosur bukur, është kuptimplot. Poezia e këtij libri sidomos, s’është e përmbytur nga abstrakti, nga pakuptimshmëria, siç shohim jo rrallë nëpër poezitë e sotme. Pra, s’janë hermetike, por të hapura dhe që të bëjnë për vete që në kontaktin e parë. Kësisoj, kemi të bëjmë me një hop jo vetëm sasior, por edhe cilësor të Naim Berishës. Dëshmi e këtij hopi janë edhe vetë titujt tepër domethënës të kapitujve të këtij libri si: “*Flladi i bjeshkës*”, “*Ngjyrat e një jete*”, “*Drurët e ullirit*” (Një poemë filozofike kjo, sidomos në ciklin “*Në fillim dogjëm ullinjtë*”); “*Me ca miq më pak*” dhe “*Metafore*”.

Karakterin e brezit të tij, si frymën më të re që Zoti mbi këtë truall të lashtë fali (poema “*Brezi im*”, kushtuar brezit të viteve ’90-të, që çliroi atdheun nga kthetrat e diktaturës më të egër në botë) Naim Berisha e shtjellon në gjithë shtratin e tij poetik, në mënyrë perfekte. Këtu dallohen përpjekjet e autorit për të gjetur me saktësi zanafillën e dhembjes dhe cakun e ndarjes me sistemin monstër. Mendimi filozofik i Naim Berishës kuptohet fare qartë qoftë dhe në vargjet: “*Lebetitej dhjetori i atij viti/Nga dridhjet, lëkundjet e tërmetit/Bëheshin er e iknin/Bëheshin borë e shkriheshin/ Njerëzit...*”. Në këtë poemë ai percepton gjer në

thellësi dhimbjen njerëzore, të cilën në mënyrë sinjifikative e shpreh në vargjet:

“Në një qoshkë të vetmuar/ Nofullat së përtypuri/ Me kreshpëroheshin në kohë të shkuar/ Shtati im i gjori/ Mështeknë degëtharë/ Qe përmbytur i gjithi në drojë e në mall/ Në vorbull ngjarjesh të pazakonta/ Vërtitesha si një top llastiku/ Në konture siluetash të nesërme skicobesha/ Përmes një lidhje gjaku/ Nyje gordiane e trishtme/ Dilja dhe shihesha, qartësisht/ Në pasqyrat e pakënaqësisë së përgjithshme /..Tani, së paku, jam i lirë të bëj si të dua...”

“Ngjyrat e një jete”, kjo temë, ndër më të spikaturat, trajtohen me detaje poetike shumë të gjetura dhe shprehëse, në poezitë me titujt respektivë: E gjelbra; E verdha, E kuqja; E bardha dhe E kaltra...

Ndërsa në kapitullin “*Me ca miq më pak*” dallohet fare qartë fryma polemizuese që përshkon thujtë të gjitha poezitë. Mjafton për këtë t’iu referohesh poezive “*Të pacipë*”, “*Do vras heshtjen*”, “*Varri i gjallë*”, “*Ngujimi i jetës*” apo qoftë dhe vetëm vargjeve “*E unë stërnip i Kastriotit/ S’i duroj fyerjet e “kurvës së motit*”.

Në këtë libër me nivel estetik poeti sjell zërin, tonin e tij frymëzues me ndjeshmërinë dhe gjetjen e figurave të spikatura letrare si tek poezitë: “*Ëndrra e fundit e Gjorg Berishës*”, “*Tregim i zanës për Halil Agën*”, “*Si kalë i kuq, e kam një huq*”, “*Kishte pjellë mushka*”, “*Sa zgjat pendimi*” etj.

Në poezitë e Naim Berishës, e veçanërisht tek ato të titulluara “*Pengu i nëndheshëm*”, “*Halli*”, “*Njerëzit që më kanë*



vdekur,” *Ngujimi i dritës*,” *Koha dhe perënditë*” ndihet transfuzioni i gjakut. Vargjet e këtyre poezive kanë brenda peshën e mendimit të tij filozofik, më e spikatur kjo tek *“Halli”*: (*Ç’më zuri një hall/ S’e desha veten gjallë/ Në ç’hall rashë/Me hasmin të hash/Me hasmin të pish/Me gjakun në këmishë/ Dreqi, i biri i dreqit/ në lojë/ Ta vras, thashë, me bukë në gojë*). Këto vargje dëshmojnë perceptione të poetit në momente të trishta. Gjetjet apo përgjithësimet poetike këtu vijnë natyrshëm, sepse ai ka arritur të derdhë shqetësimin e vetë të ligjshëm për udhëkryqin ku ndodhet shoqëria jonë. Kësisoj ai është një zë origjinal, që inkurajon vetveten dhe të tjerët.

Gati në gjithë vëllimin trajtohen motive të larmishme, ku mbizotërojnë ato të atdhedashurisë së ndezur, veçse në variane shumëngjyrëshe. Këto vjersha janë si një buqetë me lule të freskëta erëmira, të rritura në kopshtin e pasur të poezisë lirike, të cilat të kënaqin me aromën autoktone shqiptare.

Poetët më të mirë të botës, gjithmonë e kanë gjetur



frymëzimin në mbështetjen të poezia popullore dhe e traditës, në gurrën e baladave dhe legjendave, mbi bazën e të cilave kanë shkruar vepra me vlera universale. Kështu bën edhe Naimi Berisha. Me lakonicizmin e tij ai duket sikur thotë se poezia është mbretëresha e artit, ndaj ta themi të vërtetën, shkurt dhe bukur. Në këtë libër të ri, autori dëshmon së s'është një letërnxirës, përkundrazi, si një poet i vërtetë, ai e drejtpeshon fjalën, e njeh gjakimin e saj, e ndjen muzikën e padëgjuar të mendimit poetik si dhe e dallon ngjyrën e pashfaqur të ndjenjës. Këtë e tregon mirëfilli të shkruarit qartë, shkurt, lehtë dhe me kuptim të thellë.

Duke lexuar dorëshkrimin e Naim Berishës *“Pengu i nëndheshëm”*, pata ndjesinë se dhe unë jam duke vrapuar mbi një “peng të nëndheshëm” përmes resh ende të turbullta, që rreken paprajshëm të më verbojnë shikimin e hapësirës sonë autoktone. Dhe bindem se çdo poezi e tij është si një pikë uji e gjithë

deteve dhe oqeanëve të kësaj bote, përmbi të cilët Naimi ka fluturuar ose më saktë, si një pikë vese mbi lulet e kësaj toke të lashtë e të përgjakur. Mos më zini besë mua, po merreni librin, shfletojeni me kujdes dhe atëherë do të më jepni të drejtë. Do të shihni se vjershat e Naimit janë si vetëtimat në qiell, prej të cilave kap ç'të kapësh. Po brenda shkretimave të poezive të tij është flaka, metafizika e tij, drita e mendjes dhe freskia e zemrës dhe shpirtit të tij poetik. Ku ka më bukur se të lexosh vjersha që vërtet janë art, vjersha si copëza që vijnë prej flakërimi-meve qiellore.

DY FJALË DHE PËR HAIKU-N E NAIM BERISHËS

Njëzet librave shumë të suksesshëm në poezi e prozë të botuar këto njëzet vitet e fundit, Naim Berisha iu shton edhe librin e tij me haiku “Gjindja kishte ngrënë egjër”. E lexon me një frymë dhe mrekullohesh me haikun e N. Berishës që është një poezi përqëndrimesh dhe me karakteristika shumë të sakta, përsa i përket formos dhe kompozicionit. Ai e vëzhgon botën me një sy të kujdesshëm, tepër të fiksuar pas ngjarjes në momentin e kryqëzimit të vëmendjes me faktin. Ndaj dhe konkludon se “*Kohën e kanë mbuluar vemjet/Ajo qëndron në këmbë si një grua e fortë/Që kurrë s’i shfaq dhembjet*”.

Për më tepër, titulli i këtij libri me haikun “Gjindja kishte ngrënë egjër” është shumë intrigues dhe të ben për vehte që në

krye të herës, për ta përrpirë pastaj gjithë librin.

Mendimin e thellë filozofik të N.Berishes e dallon qoftë dhe vetëm tek vargjet: *Sa larg shkove / O shpirt, sa larg ...! Shpova gishtin t'shkrova një kartë*".

Pasi e lexon me interes të veçantë këtë libër duket qartë se përmbajtja e tij rrok hapësira të gjera dhe përfshin gjithçka që ka të bëjë me jetën tonë. Parë nga ky këndvështrim, në poezinë e Naim Berishës që i djeg gjithë maskat me dashurinë e tij *"Alkimia e shpirtit/shpërfaqet, gjithkund/ Si një asteroid i paparë drite...."*

Kësisoj *"Gjindja kishte ngrënë egjër"* është një haik gjigant që përbëhet nga tre vargje, ku secili prej tyre ka një identitet përcaktues. Naim Berisha, autor tashmë i shumë librave në poezi e prozë, sjell me mjeshtri të rrallë edhe haikun që të mrekullon në tërësinë e tij. Nga ky kontekst poezite tre vargueshe, të kompozuar, dy në çdo faqe të këtij libri, do të ngjallin interes të veçantë tek lexuesi. Tregues më sinjifikativ për këtë janë vargjet: *"Toka kish harruar/Me diellin të bënte flirt/",* ku vërehet një ngarkesë emocionale e mbushur me lirizëm dhe spontanitet, me një gjuhë të figurshme dhe me një korpus të gjerë botëvështrimi estetik.

Në këtë libër të Naim Berishës që *"e lindi dhe e rriti fshati bujar, i Muburrit"*, ku *"Asnjëherë s'iu hof hiseve të Heremecit / Dhe fiquve të egër të Lëkursit"* përshfaqet me mjeshtri të rrallë gjithë bagazhi i tij i thellë njerëzor.

Padyshim që librat me haiku sot janë ndër më të pëlqyeshmit, por Naim Berisha prezantohet si i veçantë ndër poetë

të rrallë të këtij rrangu. Kjo për faktin e haikui i tij është një shkollë e madhe jete dhe reflektimi për njeriun, që nëse do ta shprehim me terma të tjerë, do të ishte filozofia imediate e ngjarjes së ditës, e një njeriu të cilit nuk i ndodh shpesh të bëjë spekulime të mendjes si në rastin imagjinar kur “*Uluritën zemrat/Zjarre të ndezura pishë/Zemrat morën zemër nga një bishë.*”

Në tërësinë e tij, libri me haiku “*Gjindja kishte ngrënë egjër*” shpalos profilin poetik të një krijuesi me një ndjeshmëri të lartë, me teknika vjershërimi midis tradicionales dhe modernes e postmodernes, me një pasuri të begatë mjetesh dhe teknikash poetike, me struktura vargjesh e strofash të zhdërvjellëta, që e kthejnë formën në një procedim të mesazhit estetik.

.....Në vitet ‘80-të Naimit s’iu botua libri se vjershat e tij quheshin hermetike, të errëta, etj.

Që nga libri i tij i parë i suksesshëm, “*Ngado sytë e vajzës*” (‘93), e deri më sot, poezia e tij, nga libri në libër, ka ardhë gjithmonë e më e mirë ...

Librat e tij, si në prozë dhe në poezi janë vlerësuar gjithkohshëm nga penat më të arta të letërsisë shqipe, si nga shkrimtarë e poetë të letërsisë për të rritur, ashtu dhe nga ata të asaj për fëmijë, si: Drittëro Agolli, Teodor Laço, Bardhyl Xhama, Odise Grillo, Bedri Dedja, Fatos Arapi, Xhevahir Spahiu, Ramadan Mysliu, Nasho Jorgaqi, Mehmet Kraja, si dhe nga kritikë e studiues të artit dhe letërsisë: Behar Gjoka, Miho Gjini, Hajri Mandri, Fatmir Terziu e shumë të tjerë.

Pas kualifikimeve pasuniversitare në Londër për letërsi angleze, kritikë letrare dhe muzikë, poezia e Naimit na duket më

e pjekur, më e përmallshme për atdheun dhe vendlindjen ...

Ky promovim i gjashtë botimeve të reja të Naimit përkon me njëzet vjetorin e botimit të librit të tij të pare, dhe në këto njëzet vite ai numëron mbi njëzet libra artistikë. E veçantë për këtë shkrimtar është se të gjithë librat i ka botuar në kohë të demokracisë dhe nuk ka asnjë libër socrealist.


Gjithsesi, në tërësinë e tyre ndeshim këndvështrime të freskëta e origjinale, në të cilat shoqëria e realiteti i sotëm jepen në unitet e vazhdimësi. Kjo pohohet artistikisht përmes tablove e detajeve të zgjedhura me kujdes, për të pasqyruar sa më realisht këtë shoqëri në evoluim e progres të pandërprerë...

Duke përfunduar, i uroj suksese të mëtejshme Naim Berishës në krijimtarinë e tij, me bindjen se do të na sjellë libra të tjerë që do të pasurojnë letërsinë shqipe.



**ATDHEU FILLON
TEK FAMILJA**





Kur sapo kam përfunduar së lexuari romanin e ri të Naim Berishës “Zëri i malit të Shënmërisë”, e gjej me vend ta perifrazoj prozatorin e mirënjohur, pikërisht aty ku... “atij, befasi i kujtua një thënie e njohur: Atdheu fillon te familja!”.

Në faqet e para të këtij romani kur enigma për fatin e dy të rinjve të dashuruar, sa vjen e shtohet, as që mund ta mendosh atdashedashurinë si linjë tërësore të këtij produkti të ri krijues të shokut tim të fëmijërisë, njëherësh dhe nip i babait tim. Por duke iu përbajtur sentencës së moçme sa vetë shoqëria njëzore “Atdheu fillon nga familja”, pasi shtron pyetjen retorike “Po ku është familja ime”, N.Berisha e shtjellon atë sipas filozofisë së tij të një intelektualit mendjendritur, i cili në mërgim është bërë më produktiv. Dhe ndërsa Naimi e gjen qetësinë shpirtërore teksa i falet Malit të Shënmërisë, ndërmend më vjen madhështia e këtij mali në prehërin e një mali tjetër edhe më të lartë të vendlindjes time, Runjës hijerëndë e kreshnike. Pikërisht Muhurri, vendlindja ime e shtrentë, që shtrihet në të dyja anët e Drinit, vetëm 10 km poshtë qytetit të Peshkopisë, Korabin dhe Runjën ka për lindje dhe perëndim të diellit të gjithësisë.

Vendlindja! Gjëja më e shtrenjtë! Vendi ku u lindëm e u rritëm, ku morëm mësimet e fëmijërisë, ku jetuam gëzimet dhe



hidhërimet tona. Aty u formuam, hodhëm hapat e parë dhe nisëm rrugën e jetës... Vendlindja është kjo tokë, këta gurë e drurë që në çdo moment na kujtojnë origjinën e familjes.

Lavdia e të parëve është dritë për pasardhësit! Është thirrja e kohës për të njohur vendlindjen dhe kushtrimi i të parëve për të dashur atdheun.

Po kush është familja ime?

Gjithkush do dëshironte ta niste që në gjenezë përgjigjen e kësaj pyetje, ndërsa mua si epilog të librit tim “*Testamenti i atdhedashurisë*” më mjafton t’i përmbahem familjes time biologjike.

Gjyshja, Hane Rama (Kaziu), është një memorie e udhërrëfyes për mua, dy vëllezërit, Selmanin e Selimin, dhe sidomos për motrën, Bajden. Nga ajo trashëguam virtytin më të

shtrenjtë njerëzor, pastërtinë fizike dhe shpirtërore. Se në të vërtetë, nuk ia gjeje shoqen në tërë krahinë tonë të Muhurrit, Luznisë e Katër Grykëve, si pastërtore e rrallë. I ndrisnin xhupa e pushterka si dhe këmisha e bardhë si bora, edhe kur gatuante petën me hithra, edhe kur thurte për në triko e çorapet me spikë.....edhe kur na merrte për dore për tek dajë Ibrahim (Kaziu) në Arap të Poshtëm, ku kalonim shumë këndshëm pushimet dimërore dhe një pjesë të pushimeve të verës.

Edhe babai ynë, Hidri i ngjante të jëmës, pra gjyshe Hanes, të paktën për nga dashuria njerëzore, besnikëria e ndershmëria, veti këto që i demostroi me devotshmëri gjatë gjithë jetës së tij. I ruajti këto si veti të karakterit të tij, dhe nuk i shfrytëzoi për lavde e poste, ndonëse gjatë viteve të Luftës Nacionalçlirimtare shpëtoi nga një atentat Dylbere Bylykbashin, kur ai ishte me shërbim në Tiranë. As kartën e saj dhe as atë të Haxhi Lleshit, që ia kish shkruar pasi e kishte shoqëruar për në Hurdhë Muhurr në një situatë të vështirë, dhe e kishte porositur që ta përdorte në vitet e mëvonshme të pushtetit, babai nuk i nxorri kurrë....Na rriti me vështirësi të shumta, duke punuar me orë të zgjatura, si rojtar pylli në Kamëz (në vitet e para të pasçlirimit), në Ndërmarrjen Tregtare si teknik i pijeve alkolike, në ish fermën e Zdojanit e në ish kooperativën bujqësore të Muhurrit. U rropat vetë, që ne fëmijët e tij ta kishim të hapur rrugën e dritës dhe diturisë.

Ndërsa nëna ime, Mide Rama (Hoxha), mbesa e klerikëve të shquar të Reçit, Sheh Ymeri e Sheh Velija, si dhe motra e imamit të shquar të Zall Dardhës, Selman Hoxha, e

mendjendriturit Nuredin Hoxha dhe e Riza, Zenel e Haxhi Hoxhës (po nga Zall Dardha), do të qe modeli ynë në punë dhe në jetë... Një shtëpiake e denjë për një familje tradicionale si e jona, që asnjëherë nuk u gjunjzua, as nga sëmundja e rëndë që e shoqëroi thujse gjithë jetën e saj dhe as nga hallet e shumta. Në harmoni të plotë me babë Hidrin ajo bëri gjithshka që ne fëmijët e tyre të shkolloheshim e të bëheshim të denjë për vehten, familjen e shoqërinë.

Vlerat e familjes tonë kanë qenë gjithnjë ato që na kanë mbajtur të qëndrojmë në këmbë me krenari e dinjitet. Ky ka qenë sekreti i qëndresës sonë në përballimin e vështirësive që s'na i kurseu fati dhe kështu ka për të qenë në jetë të jetëve. Familja është vlerë e shenjtë, e paprekshme!

Dhe këtë shenjtëri e rriti ndjeshëm më i madhi i fëmijëve të familjes tonë, Selmani. Ai është ndër të parët intelektualë të zonës së Muhurrit që mbaroi arsimin e lartë ushtarak. Falë dhuntive të tij, i zellshëm për të mësuar, korrekt në shoqëri e në familje, Selmani u bë nderi dhe krenaria e familjes tonë.

Njohës i mirë i historisë dhe bartës i modestisë intelektuale që karakterizon të diturit, zotërues i thellë i fushës jo vetëm nga librat, por edhe nga rrugëtimi i një kariere të gjatë, nisur si fëmijë i një familje të varfër nga Veriu në derën e shkollës së mesme ushtarake “Skënderbej” për të vazhduar e mbaruar më pas studimet në Shkollën e Lartë të Marinës në Vlorë, Selmani, që nga rinia e tij e deri sa doli në pension, do të shquhej për kontributin e tij maksimal si oficer i Marinës.

Dhe jo vetëm kaq, por duke e konsideruar familjen si

embrionin e çdo shoqërie dhe të çdo qytetërimi, ai ishte sh-embull dhe burim frymëzimi edhe për motrën, Bajden, vëllain Selimin (që edhe sot ruan me nder e krenari traditën e familjes tonë në Muhurr, vendlindjen tonë të shtrenjtë) dhe për mua më të voglin. Si rrallë kush, vëllai ynë i madh Selmani, vuri “veton” për shkollimin e motrës, Bajdes, duke e dërguar në Shkollën e Mesme Mjekësore “Jani Minga” të Vlorës, duke ia paguar vetë paratë e “gjysmës së bursës”, dhe duke ndikuar po vetë ai në punësimin e saj në Maternitetin e Durrësit, ku “hallë Bajdja”, siç e thërrasin të gjithë, punoi me devotshmëri e përkushtim në shërbim të qytetarëve durrsakë, për katër dekada, deri sa doli në pension. Të njejtën përkujdesje tregoi vëllai ynë i madh Semani edhe për mua e Selimin, duke ndarë për çdo muaj pjesë nga rroga e tij, që të na mundësonte ecuri të mbarë në mësim.

Familja është shoqëria në miniaturë. Familja fillon me fëmijët. Familja është mjedisi i parë, ku njeriu duhet të mësohet të krijojë mirësi. Kështu ka ndodhur edhe me mua e bashkëshorten time, Kimete Rama (Berisha). Për tre dekada jetë intensive bashkëshortore ia dolëm të sfidojmë vështirësi të shumta, sa në Muhurr, në Bulqizë dhe Tiranë për të krijuar një familje solide, me dy djemtë tanë, Bledarin e Arlindin, nusen e Bledit, Zanën dhe dy mbesat e bukura si dy yje, Keida dhe Alesia. Dhe padyshim, në ndërtimim dhe konsolidimin e familjes time, bashkëshortja, Kimetja ka luajtur rol parësor. Në këtë rrugëtim të gjatë prej më shumë se tre dekada ajo ka mbajtur në konsideratë kërkesat e kohës duke konfirmuar marrëdhëniet e saja ndaj vlerave shpirtërore të njeriut. Si e tillë ajo nderohet e



respektohet edhe nga shoqe e shokë të ish kolektivave të saj të punës në Bulqizë e Tiranë, ku ka sendërtuar vlerat shpirtërore, duke qenë gjithnjë, ashtu si dhe në familje afër ngadhnjimit të së mirës ndaj të keqes, dritës ndaj ërrësisërës, të vërtetës ndaj të pavërtetës.

Si përfundim, kjo përvojë familjare dëshmon para së gjithash paprekshmërinë e familjes si garanci për sigurinë e shoqërisë së madhe njerëzore. Çdo doktrinë sociale, që përpiqet të rrënojë familjen është e papranueshme dhe përveç kësaj, e pazbatueshme. Të formosh, rritësh dhe konsolidosh një familje vërtet të shëndetshme – ky është suksesi i sukseseve.


Familja është baza e një shoqërie. Atdheu fillon tek familja. Pa familje të shëndoshë nuk ka atdhe. Nuk mjafton ta duash atdheun me deklarata dhe fjalime. Atdheun e mbajnë familjet e shëndosha shqiptare kudo që janë, në Shqipëri dhe në botë, edhe pse janë larg...

Në vend të pashënies



**ATDHEDASHURIA,
LAJTMOTIVI KRYESOR
NË KRIJIMTARINË E
HALIL RAMËS**





Vjen një kohë që krijuesit, veçanërisht ata të fushës së publicistikës, kërkojnë të mbledhin frytet e shpërndara ndër kohëra dhe ndër fusha të ndryshme. Kështu po ndodh edhe me gazetarin Halil Rama, i cili në një fazë pjekurie të plotë artistike dhe profesionale po na paraqet njëri pas tjetrit librat e tij publicistikë që qëndrojnë bukur në gjerdanin e publicistikës shqiptare.

Jo rastësisht në krijimtarinë e tij gjen edhe tre monografi historiko-letrare, njëra me e arrirë se tjetra. E para për filozofin popullor të vendlindjes se tij dhe të Dibrës, Dine Hoxha, e dyta për kompozitorin e tangos shqiptare, kompozitorin e harruar, krijuesin e muzikës së lehtë shqiptare me origjinë dibrane, Muharrem Xhediku dhe e treta për një hero të popullit shqiptar, për gjeneralin e Luftës së II Botërore dhe të kohës sonë, për Nderin e Kombit, Rrahman Parllaku. Në të tre këto monografi shkëlqen si një fill i kuq gjaku, atdhedashuria, dashuria për vendlindjen, për Shqipërinë, për shqiptarët kudo që janë.

Dhe së fundi del me librin e tij të pestë me publicistikë me titullin: “*Testamenti i atdhedashurisë*”. Duket paksa deklarative, por në gazetari titulli shoqërohet me nëntituj e okelio

që lexuesi të mos lodhet, por ta marrë informacionin sa më konçiz dhe Halil Rama shquhet për këtë stil konçiz dhe për vërtetësinë e shkrimeve të tij.

Në librin e tij të fundit do të gjesh shkrime edhe për luftën e shqiptarëve të Maqedonisë dhe për gjeneralin e tyre Gëzim Ostreni, shkrimin protestë për Lumin e Radikës që kërkojnë t'ja ndalin rrjedhën, për Luftën Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar, Konferencën e Bujanit dhe të Pezës, për ushtarin trim në provokacionet e gushtit 1949, për gardistin shëmbullor që ra në krye të detyrës etj.

Në libër dhe në shtypin e kohës do të gjesh shkrimet e gazetarit H. Rama për sensibilizim për vajzën e re 17 vjeçare Ambra Meda, që kërkon të jetojë dhe që dergjet në spital, sensibilizim që e gjen në Dibër të Madhe, në Bulqizë tek sportistët e famshëm vëllezërit Keta dhe kudo në Shqipëri, por që për ironi të fatit nuk e gjen tek organet shtetërore shqiptare.

Duke ju kthyer vendlindjes së tij ai shkruan për shkollën e Muhurrit të Dibrës dhe për mësuesit e dëgjuar Xhemal dhe Lik Berisha, për shkrimtarin dhe poetin Naim Berisha, pasues të fisit të dëgjuar Berisha të Muhurrit të Dibrës ku dolën dy gjeneralë të Skënderbeut, Dhimitër e Nikollë Berisha.

Në këtë libër do të lexosh edhe disa recensionet e kritika për libra dhe shkrimtarë të ndryshëm, mbledhës të folklorit, ku bie në sy shqetësimi i autorit që këta krijues ndër vite të mos harrohen, por të rivlerësohen në kohë. Në këto shkrime gjen analizën dhe komentimin, gjen kritikën dhe fjalën e lirë, gjen fjalën e bukur shqipe.

Shqetësimi i autorit, si pjesë e shqetësimit të një grupi aktiv të shoqërisë shqiptare që ngre zërin kur punët nuk shkojnë mirë në këtë vend ku ne jetojmë dhe që do të jetojnë edhe fëmijët tanë, edhe brezat që do të vijnë, përshkon këtë libër me publicistikë që lexohet me dëshirë, sepse në të gjen personazhet dhe shqetësimet e kohës që jetojmë.

Sakip Cami

PASQYRA E LËNDËS

Jo vetëm testament.....	1
Në Bujan, ku u projektua “vetëvendosja”.....	5
Një legjendë në kufirin e dy kohëve.....	15
Gjeneral Gëzim Ostreni, heroi i dy luftërave në Kosovë dhe Maqedoni, libër për luftën dhe paqen në Shkup.....	25
Testamenti i atdhedashurisë.....	37
Në Pezë, pa protagonistët e Konferencës së Pezës.....	43
Pesha e dhimbjes për Azemin.....	49
Historia e centralistit që urdhëroi hapjen e zjarrit ndaj monarkofashistëve grekë më 2 gusht 1949.....	55
Rekuiem për ish gardistin shembullor Arben Zhuzhi.....	67
Prof. Dr. Petrit Bara, nderi dhe krenaria e Dibrës dhe Tetovës.....	73
Ambra do (n) të jetojë.....	81
Kimioterapia “Ambra”.....	87
Xhemal Berisha, dishepull i dijes, simbol i urtësisë dibrane.....	93
Gangrena e teksteve shkollore dhe injorimi i palës greke.....	101
Momente kthese dhe reflektimi për zhvillimin e arsimit në rajonin e Dibrës.....	109
Masivizimi i sportit, si prioritet i MAS dhe KOKSH.....	115
Të gjithë lumenjtë rrjedhin, po Radika a do ta vazhdojë rrjedhën e saj?.....	121

“20 VJET OBVL”, një encikopedi me vlera për historiografinë shqiptare.....	131
Eurosig, jo vetëm promotor i sigurisë, por edhe promotor i zhvillimit të kulturës dhe artit.....	137
Sa shumë njerëz në lamtumirën e Lik Berishës!.....	143
Pylltaria shqiptare në lëngatë.....	149
“Gropas 67”, i Teodor Laços - skaner politik, shoqëror dhe letrar i shoqërisë shqiptare në vitet ‘60.....	157
Shefki Karadaku, një shkrimtar i harruar dhe jo i vetmi.....	167
Filozofia popullore dibrane në rrëfimet e Sakip Camit.....	173
Naim Berisha, në 20 vite, 20 botime dinjitoze në poezi dhe prozë.....	179
Atdheu fillon tek familja.....	189
Atdhedashuria, lajtmotivi kryesor në krijimtarinë e Halil Ramës.....	197



HALIL RAMA

Ka lindur në Muhurr-Dibër, më 28.10.1960

Nga viti 1977 punon në shtypin e përditshëm, në gazetat “Albania”, “Bulevard”, “Bota Sot” dhe “Rilindja Demokratike”.

Kryeredaktor në gazetat periodike “Bulqiza”(‘92-’96), “Bota SD” (‘97-2003), “Vizioni Liberal” (2005-2009), “Kamza”(2009-2011) dhe “VETERANI” (nga 2003 e në vazhdim).

BOTIME TË TJERA TË AUTORIT

